# TAKVIM
# 1446-1447

# KALENDAR
# 2025

*Boton:*
**KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**
*Prishtinë, rr. "Bajram Kelmendi" nr. 182*
**Tel & fax: 038 / 224-001**
**www.bislame.net**
e-mail: takvimi@hotmail.com

*Për botuesin:*
**Myftiu, Naim ef. Tërnava**

*Kryeredaktor:*
**Ahmet Sadriu**

*Redaksia:*
Resul Rexhepi
Sabri Bajgora
Ramadan Shkodra

*Lektor:*
Bajram Zeqiri

*Redaktor teknik & kopertina:*
Nuhi Simnica

*Shtypi:*
"Europrint" - Prishtinë

**© Copyright:**
Të gjitha të drejtat e botimit, ribotimit, fotokopjimit a përkthimit i përkasin Kryesisë së BI-së të Kosovës.
Ndalohet me ligj riprodhimi i plotë apo i pjesshëm pa lejen e botuesit

# TAKVIM
# 1446-1447

# KALENDAR
# 2025

Prishtinë



*Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!*

# NË VEND TË PARATHËNIES

Falënderojmë Allahun e Madhëruar, Krijuesin, Sunduesin, Mbikëqyrësin, Furnizuesin e gjithësisë, Zotin e qiejve dhe të Tokës, të Plotfuqishmin, të Gjithëmëshirshmin, të Panevojshmin për askënd, Absolutin, të Gjithëdijshmin! E lusim Atë të na e shtojë dijen dhe të na bëjë prej atyre që punojmë me ato që Ai na i ka mësuar dhe të na i kujtojë ato që i kemi harruar! Lusim të Madhëruarin që të jetë i kënaqur me ne dhe familjet tona!

Mëshira dhe bekimi i Allahut qofshin mbi Pejgamberin Muhamed Mustafanë, mbi familjen e tij fisnike, shokët e tij besnikë dhe të sinqertë dhe mbi gjithë ata që e pasuan dhe e pasojnë rrugën e tij deri në Ditën e Gjykimit.

*Të nderuar lexues,*

Revista “Takvimi” këtë vit feston 55-vjetorin e botimit të saj të parë, si një ndër botimet e para në gjuhën shqipe, e cila përkundër sfidave dhe momenteve nëpër të cilat kaloi, asnjëherë nuk pushoi së botuari, andaj me këtë rast falënderojmë së pari Krijuesin e Gjithësisë, Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, stafin përgjegjës, bashkëpunëtorët, e në veçanti lexuesin tonë shumë të respektuar, i cili gjatë gjithë kohës i qëndroi besnik revistës, me kërkesën e tij të vazhdueshme që ta ketë në dorën e tij këtë revistë. Kjo gjë e bën revistën “Takvimi” më jetëgjatën prej botimeve islame në gjuhën

shqipe, dhe përfundimisht, kjo i jep vendin më të meritueshëm në veprimtarinë botuese islame në gjuhën shqipe në Kosovë dhe jo vetëm.

Pa dyshim se dalja e "Takvimit" gjatë gjithë kësaj periudhe kohore 55-vjeçare, gjithsesi se është meritë e botuesit, themeluesve, drejtuesve, e sidomos bashkëpunëtorëve dhe lexuesve besnikë të saj. Të gjithë këta, pa përjashtim meritojnë mirënjohje të veçantë nga ne. Kjo është një garanci e fortë se revista "Takvimi" do të vazhdojë të botohet edhe më shumë vjet e dekada.

Si zakonisht, revista "Takvimi", lexuesit të saj ka bërë përpjekje që t'i sjellë sa më shumë punime nga fusha të ndryshme, të dijes dhe të shkencës, duke ia bashkëngjitur në fund edhe pjesën kalendarike, e cila e veçon nga botime e tjera islame shqipe në vendin tonë.

Edhe "Takvimi" i këtij viti përmbledh tema nga fusha të ndryshme, si: akaidi, tefsiri, fikhu, ahlaku, arsimi, e drejta e Sheriatit dhe fusha të tjera, të cilat përgjatë viteve e kanë karakterizuar "Takvimin". Gjithashtu ky "Takvim" përmban edhe opinione dhe kontribute të dijetarëve eminentë islam, e që në gjuhën tonë vijnë përmes përkthimeve të bashkëpunëtorëve tanë, mirëpo, siç e kemi theksuar edhe herë të tjera, redaksia e "Takvimit", jo domosdoshmërish pajtohet me opinionet e autorëve të shkrimeve që boton, por, ajo mbetet e hapur dhe përkrah mendimin, përpjekjet dhe idetë ndryshe.

Lexues të nderuar, edhe me këtë rast po ua rikujtojmë se "Takvimi" në brendësinë e tij përmban ajete kuranore dhe hadithe të Pejgamberit a.s., andaj luteni që gjatë përdorimit të tij të keni kujdes.

Krejt në fund, e lusim Fuqiplotin që të na ndihmojë ta kryejmë amanetin me përgjegjësinë më të lartë, të na i falë gabimet dhe të jemi nën mbrojtjen e Tij përgjithmonë!

Vetëm me ndihmën e Allahut arrihet qëllimet dhe ia dilet mbanë!

و الحمد لله على نعمته العظيم

Vel hamdulil-lahi ala niametihi el adhijm.

*Prishtinë,*
*dhjetor 2024*

**Ahmet Sadriu**

**Naim ef. TËRNAVA**

# KONCEPTI PËR BESIMIN DHE ROLI I SHPALLJEVE PREJ ZOTIT, XH.SH.

S'ka dyshim se shpallja është mëshirë e dhuruar prej Zotit, xh.sh., te njerëzit e zgjedhur prej Zotit, për njerëzit (popujt) e ndryshëm, nëpër vende të ndryshme, dhe kjo sigurisht se është mëshirë e bekim i Zotit, xh.sh., për njerëzit dhe krijesat në përgjithësi. Zoti, xh.sh., nuk i krijoi njerëzit që ata t'i lërë pa busull orientuese, në mënyrë që ata të bredhin në terrin e injorancës. Zoti, xh.sh., njeriut ia dhuroi të gjitha kushtet dhe mundësitë që ai ta organizojë jetën e tij në Tokë. Kështu, Ai ia mësoi njeriut gjërat apo njohuritë që njeriu nuk i dinte, ia dhuroi udhëzimin (shpalljen), me të cilën e informoi për krijimin e kësaj ekzistence, për kuptimin e jetës së tij në këtë botë dhe përgatitjen për botën tjetër, për adhurimin që i duhet bërë vetëm Zotit, xh.sh., dhe rrugën e drejtë që duhet ndjekur për të arritur në shpërblimin e Zotit, xh.sh., si dhe për synimin që duhet ta ketë si besimtar, e që është shpërblimi me Xhenet.

Shtrohet pyetja se, a mundet mendja e njeriut njëanshmërisht ta shpikë një fe gjithëpërfshirëse, të përgjithshme e të vlefshme për çdo kohë dhe vend, duke vërtetuar dhe ruajtur në vazhdimësi peshën mes shpirtit dhe trupit?

Sepse vetëm ligjet që janë produkt i mendjes njerëzore dhe që dëshmojnë një sërë faktesh nuk mjaftojnë për udhëzim dhe adhurim të drejtë. E, në këtë kontekst do ta veçonim përzgjedhjen e njeriut të parë, Ademit, a.s., që ishte njëherësh edhe pejgamber i parë. Rëndësia e këtij fakti qëndron në dëshminë që ofron për:

- nevojën e njeriut për udhëzim të drejtë fetar, ngase njeriu i vetëm asnjëherë nuk arrin të zgjedhë rrugën e drejtë të udhëzimit dhe mënyrën e drejtë të besimit në Zotin Një, të Vetëm, pra, pa ndihmën e shpalljes.
- vjetërsinë e nevojës së tij për fe, gjegjësisht lindjen e tij me nevojën për fe.

Prandaj, nevoja për fenë është natyrshmëri që gjendet brenda njeriut, diçka me të cilën ai lind dhe të cilën asnjëherë nuk mund ta evitojë. Nga këtu, njeriut nuk i ngelet tjetër vetëm se të merret me përmbushjen e kësaj nevoje, gjithsesi duke iu referuar fesë së vërtetë.

Besimi në shpallje, në librat e shenjtë, në fletët ose *fletushkat* e zbritura, është domosdoshmëri për të qenë besimtar mysliman. Askush nuk mund të konsiderohet mysliman nëse më parë nuk beson në shpallje, gjegjësisht në librat e shpallur. Shpallja prej Allahut, xh.sh., gjithherë kishte qëllimin e udhëzimit të njeriut për besim dhe adhurim të Zotit Një, duke e zhveshur Atë nga mundësia e përngjasimit me diçka të krijuar në këtë univers.

Shpallja në vazhdimësi pati qëllimin e largimit të njeriut nga besimet e kota, për ta udhëzuar për besim në Zotin Një; është shpallja ajo që nuk e la njeriun të udhëhiqet nga egoja, dëshira e rrethanat, por ia tregoi rrugën që duhet ndjekur. Prandaj, ky udhëzim u arrit përmes shpalljes e dërgimit të

pejgamberëve. E gjithë revelata (zbulesa) hyjnore ka qenë e tillë, që e ka mbushur zbrazëtinë tek individi dhe shoqëria. Gjithherë ka pasur mësime e udhëzime me përmbajtje, njohuri e konkluzione të dobishme për shoqërinë njerëzore, pavarësisht se ku është shpallur fjala e Allahut, xh.sh.

Shpallja e zbritur prej Allahut, xh.sh., duke filluar prej pejgamberit të parë Ademit, a.s., përmblidhet në atë që na mëson Kurani. Kurani na mëson se prej Allahut, xh.sh., janë shpallur libra te katër pejgamberë, si dhe janë shpallur edhe fletë (broshura), fletushka, si ato tek Ibrahimi dhe Musai, a.s., e të cilat i përmend Kurani.

Derisa asnjë nga *fletushkat* e zbritura nuk ka arritur deri te ne, ato mbesin të panjohura për ne në aspektin e përmbajtjes. Mirëpo, sigurisht se edhe ato fletë (broshura), apo fletushka, kanë përmbajtur përafërsisht të njëjtën përmbajtje në besim, pra, siç e kanë pasur librat e tjerë të zbritur; secili libër i zbritur ka thirrur për besim në Zotin Një, në Zotin Krijues, Udhëzues e Furnizues në këtë univers.

Shpallja e fundit hyjnore, Kurani, pa pikë dyshimi përmban frymën e tërë asaj që ishte e pranishme te librat dhe fletët (fletushkat) e mëhershme që kishin të bënin me besimin e drejtë në Zotin Një. Ndërsa, legjislacioni te pejgamberët dhe librat e shpallur ka ndryshuar varësisht nga rrethanat që kanë ekzistuar në kohën e shpalljes. Kurani është libër që përfshin tërë nevojën njerëzore për t'u udhëzuar drejt e mirë. Kjo ngase Kurani përmban rregullat dhe parimet e pandryshueshme të fesë sonë.

Gjithashtu, duhet ta kemi parasysh se shpallja është e paarritshme nga tentativat e njerëzve për të bërë diçka të ngjashme me librat e shpallur, e në veçanti me Kuranin, të cilit

edhe iu ruajt origjinaliteti i zbritjes. Kjo ndodhi ngase Kuranin e mori përsipër Ai që edhe e shpalli, Allahu, xh.sh.

Po ashtu duhet ditur se secila fe që në esencën e saj konsiderohet monoteiste, parimet e veta i mbështet në librin që e konsideron të shenjtë (fjala është për fetë para shpalljes së fundit), siç janë, për shembull, judaizmi, që e merr si të shenjtë Biblën hebraike, së cilës më vonë i janë shtuar edhe disa libra shtojcë, e që assesi nuk kanë ekzistuar në librin e shpallur te Musai, a.s., Tevrati; judaizmi nuk pranon asnjë shpallje të mëvonshme, duke e mbrojtur teorinë se me Tevratin dhe Musanë ka marrë fund vargu i gjatë i dërgimit të pejgamberëve dhe i shpalljes së librave të shenjtë, pastaj të krishterët, që morën shumë nga Besëlidhja e Vjetër, nga Tevrati (Tora e sotme) dhe librat e saj shtesë, pra, me disa shtojca, duke mos pranuar edhe të gjitha mësimet e shpallura në Besëlidhjen e Vjetër, kështu që janë larguar shumë nga Besëlidhja e Vjetër; krishterimi në Besëlidhjen e Re ka ruajtur një numër të kufizuar të shkrimeve.

Kështu që edhe të krishterët nuk pranojnë shpallje pas Isait, a.s., sipas tyre Jezu Krishtit. Megjithatë, mësimet e drejta rreth tij janë larguar nga libri i shpallur tek Isai, a.s., Inxhili. Prandaj, edhe Isai, a.s., sipas mësimeve të tyre të devijuara, te të krishterët e merr pozitën apo trajtimin për çka nuk na mëson asnjë nga librat e shpallur prej Zotit, xh.sh., e as edhe Inxhili që iu shpall Isait, a.s. Ngase, dihet se Isai, a.s., pas ndërhyrjeve të shumta në Inxhil nga ana e të krishterëve, në ungjijtë e sotëm te të krishterët shihet herë si Zoti, e herë si bir i Zotit.

S'ka pikë dyshimi se Kurani i thërret besimtarët e besimit islam që të besojnë në tërë atë që është shpallur te pejgambe-

rët e mëparshëm, pra, edhe në atë që është shpallur te Musai, te Davudi, tek Isai, a.s., etj. Dhe, këtë thirrje Kurani e bën pa bërë asnjë dallim, duke e konsideruar dhe duke besuar çdo gjë të shpallur, pra, se janë prej Zotit, xh.sh., kuptohet në origjinalitetin e shpalljes, dhe jo edhe në atë të përmbajtjes që kanë sot librat në fjalë. Kjo sepse është ndryshuar secili nga librat nga versioni origjinal i shpalljes, duke futur njerëzit aty edhe mendimet e tyre[1]. Kurani na e rikujton këtë fakt duke përmendur shumë nga thëniet në Tevrat dhe Inxhil, sidomos mbi të kaluarën dhe obligimet ndaj Krijuesit[2].

Siç shihet nga kjo që thamë gjer këtu, myslimanët besojnë në krejt pejgamberët, pa dallim, në krejt librat e shpallur te pejgamberët e mëhershëm, në vende dhe popuj të ndryshëm, sepse këtë ua obligon besimi i tyre dhe libri i shenjtë Kurani.

## Kuptimet e *Vahjit* - Shpalljes

Vahji ose shpallja (zbulesa) hyjnore është Fjalë e Allahut, xh.sh., e cila arrin me shpejtësi tek i përzgjedhuri i Tij, pejgamberi, ose i flet pas perdes (pengesës), siç i foli Musait, a.s., dhe Muhamedit, a.s., ose ia dërgon të dërguarin prej *melekëve* (engjëjve) si, Xhibrili, engjëll i shpalljes dhe i transmetimit të shpalljes (porosisë) së Allahut, xh.sh.

Fjala *vahj* në Kuran, në të shumtën e rasteve, përdoret në kuptimin e njoftimit apo të lajmërimit prej Allahut, xh.sh.,

[1] Shih: Bekare: 75; Nisa: 46; Maide: 13; 41.

[2] Shih: Ali Imran: 65, 93; Maide: 43-44, 46-47; Arafë: 157; Tevbe: 111; Fet'h: 29; Saf: 6; Xhumuah: 5; Hadid: 27.

për të dërguarit e tij, dhe këtu bëhet me anë të fjalës, simbolikës apo ekspozimit.

Kuptimi leksikor i fjalës *vahj*, *zbulim, zbulues* është informimi në fshehtësi, fjalë e thënë, e zbuluar apo e bërë e ditur fshehtazi. Kurse, si term profesional fjala *vahj* është informim fshehtas prej Allahut, xh.sh., për pejgamberët, për njohuri të çështjeve të ndryshme, në formën e fjalëve apo të kuptimeve, drejtpërdrejt apo me ndërmjetësimin e një engjëlli[3].

I vetmi burim i fesë së drejtë e të vërtetë (Islamit) është shpallja - *vahji,* e që vjen te të zgjedhurit e Zot, xh.sh. Kur dëgjojmë apo lexojmë termin *vahj,* duhet ta kuptojmë se bëhet fjalë për shpalljet e Allahut, xh.sh., dedikuar të zgjedhurve të Tij, pejgamberëve, përmes engjëllit Xhibril, engjëllit të shpalljes, ose përmes ndonjë forme tjetër.

Me këtë duhet kuptojmë se frymëzimi vjen prej Zotit, xh.sh., direkt prej Tij, ose me porosi, përmes engjëllit të dërguar Xhibrilit (Melekut të Shpalljes), për ta sjellë shpalljen te pejgamberi (i dërguari) apo i përzgjedhuri i caktuar i Allahut, xh.sh. Nga kjo mësojmë se kur Allahu, xh.sh., dëshiron ta kumtojë misionin e Tij, ta lajmërojë popullin me porosi dhe obligime të ndryshme, për ta besuar e adhuruar vetëm një Zot, Krijuesin e këtij universi, atë e bën edhe përmes të dërguarve të Tij, duke porositur që ato shpallje apo frymëzime të shpjegohen në masë ashtu siç janë marrë prej Melekut të Shpalljes, pa kurrfarë ndryshimi. Duhet ditur se shpallja

[3] Bekir Topalliogllu, *Bazat e Besimit*, Prishtinë, 2002, f. 126. Si dhe shih edhe: Ebu Dekikah, *El Kavlu Sedid fil Ilmi Tevhid*, pjesa II, f. 165.

është e drejtë absolute që e pranon, e ruan dhe e interpreton apo e kumton në masë vetë pejgamberi i caktuar.

Kurani na mëson se ka pasur edhe inspirime te disa që nuk e kishin gradën e të dërguarit. Pra, duhet ta kemi parasysh termin *vahj*, që është i përmendur në Kuran në kuptime të ndryshme, pra, varësisht se për kë bëhet fjalë dhe shkakun kur e pse përdoret. Gjithashtu, duhet ditur se termi *vahj* - zbulesë apo shpallje është përdorur edhe për ata që nuk janë në gradën e pejgamberëve.

Ky term, *vahj*, në kuptimin e inspirimit apo të frymëzimit është përdorur edhe me rastin e nënës së Musait, a.s., *havarijunëve* - dishepujve apo ndjekësve të Isait, a.s., nënës së Isait, a.s., Merjemes, si dhe është përdorur për bletën, frymëzimin (instinktin) e saj, zjarrin, Tokën dhe qiellin. Ata u inspiruan çfarë të bëjnë, duke mos e ditur se me atë vepër janë të inspiruar apo të frymëzuar prej Allahut, xh.sh., mirëpo, gjithherë duke e falënderuar Allahun, xh.sh., për punën e mirë që vjen pas inspirimit (frymëzimit).

Asnjëri prej tyre nuk e arrin gradën e pejgamberit, ngase këta, përveç Isait, a.s., nuk janë zgjedhur pejgamberë, dhe nuk janë informuar prej Zotit, xh.sh., se janë dërguar prej Tij me mision, dhe të këtillët nuk e dinë se po inspirohen prej Zotit, xh.sh.

## 1) Vahji në kuptimin e inspirimit

Për ta kuptuar këtë më mirë edhe praktikisht, po e përmendim rastin me nënën e Musait, a.s. Në lidhje me këtë rast, duhet ditur se në ditën e lindjes së Musait, nëna e tij dëshironte që foshnja të ishte vajzë, në mënyrë që si e porsalindur

mos të vritej, pasi dihej urdhri që kishte dhënë Faraoni për vrasjen e të gjitha foshnjave meshkuj që do të lindnin atë vit. Dhe, sigurisht se nuk duhet harruar edhe paralajmërimin e Jusufit, a.s., i cili thoshte se do të lindte një djalë që do t'i mposhtte padrejtësitë dhe mizoritë. Padrejtësitë e mizoritë e shumta të Faraonit në raport me njerëzit ishin shumë të pranishme. Ai torturonte, vriste, shfrytëzonte njerëz pa kurrfarë mëshire. Dhe pikërisht në këtë kohë dhe në këto rrethana lindi Musai, a.s. Allahu, xh.sh., në shenjë të nënës së Musait, a.s., thotë:

﴿وَأَوْحَيْنَا إِلَىٰٓ أُمِّ مُوسَىٰٓ أَنْ أَرْضِعِيهِۖ فَإِذَا خِفْتِ عَلَيْهِ فَأَلْقِيهِ فِي الْيَمِّ وَلَا تَخَافِي وَلَا تَحْزَنِيٓۖ إِنَّا رَادُّوهُ إِلَيْكِ وَجَاعِلُوهُ مِنَ الْمُرْسَلِينَ﴾

***"Ne e inspiruam nënën e Musait t'i japë atij gji; e kur të kesh frikë për të, atëherë atë hidhe në lumë, e mos u frikëso e as mos u pikëllo, se Ne do të ta kthejmë atë ty, dhe do ta bëjmë atë prej të dërguarve."*** *(Kasas: 7)*

Sikur mos të ishte inspirimi i Allahut, xh.sh., te nëna e Musait, a.s., pra, në mendjen e saj e jo me fjalë, siç është rasti me pejgamberët, ajo nuk do ta kishte guximin, dijen e as kurajën e fshehjes së foshnjës (djalit) të saj, dhe mospërfilljes së urdhrit të Faraonit, i cili kishte dhënë urdhër për vrasjen e gjithë fëmijëve meshkuj që do të lindnin atë vit. Duke e këshilluar që ta ushqejë Musain e vogël me gjirin e saj, edhe kur asaj i kanosej rreziku prej ushtarëve të Faraonit, të cilët kërkonin se mos kishte mbetur ndonjë fëmijë i fshehur, Allahu, xh.sh., atëherë e inspiroi atë që ta lëshonte djalin në lumin Nil, dhe për këtë mos të frikësohej e as mos të pikëllohej, ngase Musai i vogël do të ishte nën mbrojtjen dhe përkujdesjen e Zotit, xh.sh. Ajo nuk e dinte se të gjitha këto

veprime ishin inspirim për të prej Zotit, xh.sh., për ta shpëtuar Musain e vogël, pejgamberin e ardhshëm. Sepse ai do të rikthehej prapë te nëna e vet, dhe do të bëhej i dërguar i Allahut, xh.sh. Dhe, kështu edhe ndodhi.

Arka ku ishte vendosur Musai, a.s., po lundronte nëpër lumin Nil, dhe shkoi e u ndal pikërisht para pallatit të Faraonit, ku e morën rojet e pallatit dhe gruaja e Faraonit, Asija. Ajo nuk kishte fëmijë, dhe ishte grua e ndershme, nga loza e mbretit të Egjiptit, qysh nga koha e Jusufit, a.s. Ajo, kur e pa foshnjën, i propozoi Faraonit që ta birësojnë. Dhe kështu Musai, a.s., u rrit dhe u edukua në duart e kësaj gruaje besimtare, para syve të Faraonit zullumqar, duke mos e ditur se më vonë do t'i vinte fundosja pikërisht prej këtij fëmije që po rritej në pallatin e tij.

Kështu edhe ndodhi, Faraoni u fundos në det me gjithë ushtrinë e tij. Kur Musai, a.s., me shkopin e vet i ra detit, e ai u hap në dysh, Musai, a.s., me përkrahësit e tij, kaloi përmes Detit të Kuq, ndërsa kur Faraoni hyri, Zoti, xh.sh., e fundosi atë me rikthimin e detit në gjendjen e mëhershme, dhe kështu Faraoni u fundos bashkë me ushtrinë e vet.

## 2) Vahji në kuptimin e urdhrit

Shokët besnikë të Isait, a.s., përkundër ballafaqimit me vështirësi të shumta prapë i qëndruan besnikë Isait, a.s., dhe misionit të tij, pra, besimit në Zotin Një, ngase për këtë i urdhëroi Allahu, xh.sh. E, këtë urdhër e kuptojmë edhe përmes këtij ajeti.

﴿وَإِذْ أَوْحَيْتُ إِلَى الْحَوَارِيِّينَ أَنْ آمِنُوا بِي وَبِرَسُولِي قَالُوا آمَنَّا وَاشْهَدْ بِأَنَّنَا مُسْلِمُونَ﴾

***“Dhe kur i frymëzova havarijunët*** *(i urdhërova):* ***“Të më besoni Mua dhe të dërguarin Tim!”. E ata thanë: “Ne besuam, e ti dëshmo se ne jemi myslimanë.”*** *(Maide: 111)*

Ky rast ka të bëjë me Isain, a.s., pra, kur Zoti, xh.sh., i urdhëroi *havarijunët* - apostujt (shokët e Isait, a.s.), të besojnë në Allahun, xh.sh., të besojnë në pejgamberinë e Isait, a.s., e të cilët besuan dhe vepruan punë të mira, duke shprehur besimin e drejtë e të sinqertë në Allahun, xh.sh., si dhe vërtetimin e dërgimit të Isait, a.s., pejgamber.

### 3) Vahji në kuptimin e instinktit

Shumë herë kemi përmendur se Allahu, xh.sh., asgjë nuk e ka krijuar kot apo pa qëllim. Zoti, xh.sh., edhe krijesave të tjera u ka dhënë mundësi që përmes instinktit ta organizojnë punën e tyre, siç përmendet edhe në Kuran, për shembull, rasti i bletëve. Bletët, përmes instinktit të dhuruar prej Zotit, xh.sh., instinkt të cilin Zoti, xh.sh., kur flet për inspirimin e bletës e përmend me termin *vahj*, pra i ka bërë ta organizojnë jetën e tyre, punën në mbledhjen e nektarit nëpër lule, pemë, livadhe etj., ndërtimin e shtëpive të tyre nëpër kodra e male, pemë e lisa etj. Me këtë rast e shohim se vjen në shprehje instinkti që bletës ia shton vlerën edhe më. E, nëse ajo studiohet edhe për mënyrën se si e organizon punën e saj në bashkësi bletare, po edhe në tubimin e mjaltit, mrekullia do të vërehej edhe më qartë. Allahu, xh.sh., thotë:

﴿وَأَوْحَىٰ رَبُّكَ إِلَى النَّحْلِ أَنِ اتَّخِذِي مِنَ الْجِبَالِ بُيُوتًا وَمِنَ الشَّجَرِ وَمِمَّا يَعْرِشُونَ﴾

***"Zoti yt i dha instinkt bletës: ndërto shtëpi nëpër kodra** (male), **nëpër drurë** (pemë) **dhe nëpër kulmet që ata** (njerëzit) **i ndërtojnë!"** (Nahël: 68)*

Kjo është një thirrje e qartë prej Zotit, xh.sh., për të menduar e për ta studiuar botën e atyre insekteve të bekuara që Zoti, xh.sh., i ka aftësuar me mundësinë e mbledhjes së nektarit nëpër lule, për ta tretur atë dhe për ta shndërruar në një ushqim me ngjyra e aromë të llojllojshme, në të cilin ka shërim për njerëzit. Pra, duhet menduar për atë botë përplot me sekrete dhe argumente që flasin për besim dhe dëshmi se Zoti, xh.sh., është Një.

Kjo është nga shenjat e Zotit, xh.sh., e cila tregon madhështinë e Tij. Kur Ai e krijoi bletën, atë e bëri të jetojë në një shoqëri të bazuar në nivelet më të larta të bashkëpunimit e të integrimit, përmes punës së vazhdueshme, të zellshme e të mrekullueshme, duke e respektuar mbretëreshën e tyre, e që mund ta gjejmë vetëm te një bashkësi bletare.

## 4) Vahji në kuptimin e shenjës

Këtë lloj vahji më së miri mund ta kuptojmë nga rasti me të dërguarin e Zotit, xh.sh., Zekerijanë, a.s., ngase ai u urdhërua prej Allahut, xh.sh., që pas përfundimit të lutjes mos t'i flasë popullit për tri ditë, por të komunikojë vetëm përmes shenjave të duarve, dhe me këtë rast, në shembullin e shenjës Allahu, xh.sh., e përmend vahjin. Allahu, xh.sh., thotë në Kuran:

﴿فَخَرَجَ عَلَىٰ قَوْمِهِ مِنَ الْمِحْرَابِ فَأَوْحَىٰ إِلَيْهِمْ أَن سَبِّحُوا بُكْرَةً وَعَشِيًّا﴾

***“Dhe ai doli nga faltorja para popullit të vet, dhe u dha shenjë: adhurojeni** (Allahun) **mëngjes e mbrëmje!”** (Merjem: 11)*

Zekerijai, a.s., ka dalë para njerëzve nga vendi ku e adhuronte Allahun, xh.sh., vendi ku i erdhi edhe lajmi për lindjen e djalit, dhe u bëri me shenjë njerëzve që ta falënderojnë Allahun, xh.sh., mëngjes e mbrëmje, ta falënderojnë dhe ta adhurojnë Allahun Një.

## Raporti ndërmjet Shpalljes dhe arsyes

Para se të flasim për mënyrat e shpalljes prej Allahut, xh.sh., te të dërguarit e Tij të përzgjedhur në popujt ku u dërguan, do të flasim pak edhe për problematikën e konceptit të shpalljes dhe lidhjen e saj me arsyen dhe mendjen e njeriut.

Kemi përmendur edhe më herët se shpallja iu dedikua njeriut dhe xhindeve, për dallim nga të gjitha krijesat e tjera të kësaj bote. Edhe nga logjika që e posedon njeriu, arsyeja dhe shpallja, edhe pse mund të kuptohen e studiohen ndaras, nuk janë në kundërshtim me njëra-tjetrën. Secila e vlerëson gjendjen e tyre brenda rolit që kanë, duke u munduar që t’i bashkojnë në vazhdimësi pikat e arsyes e të mendjes, e të cilat e kanë edhe synimin e njëjtë në vetë aktin e krijimit të njeriut si krijesa më e përsosur. Nga ana tjetër, shpallja synon perfeksionimin e vetë natyrës që përmban mendja në raport me shpalljen për të dërguarit e Tij.

Derisa shpallja bën pjesë në njohuri dhe fshehtësi të ruajtura prej Allahut, xh.sh., për njeriun, dhe bën pjesë në botën e sekreteve të Zotit, xh.sh., për njeriun, që ia zbulon ato kur Zoti dëshiron, duhet ditur se njeriu njëanshëm, pra vetëm, asnjëherë nuk mund të arrijë në njohuritë që i përmban shpallja e Allahut, xh.sh.

Derisa mendja apo arsyeja te njeriu është e krijuar dhe e kufizuar në kohë, vend, mundësi veprimi dhe dhënie të gjykimit të drejtë e të vazhdueshëm në lidhje me njohuritë, shpallja është ndryshe. Ajo nuk kufizohet me këto gjëra, sepse është jashtë mundësisë sonë njerëzore. Rrjedhimisht, as nuk mund të bëhet krahasim i arsyes me shpalljen. Përmbajtja e shpalljes nuk ka të bëjë me angazhimin apo futjen në sistem apo funksion të mendjes, apo të logjikës së njeriut gjenial, ngase çfarë sjell shpallja nuk është rezultat i angazhimit të mendjes, por shprehje hyjnore e Allahut, xh.sh.

Njohuria që sjell shpallja e zbritur prej Allahut, xh.sh., kryesisht përmes engjëllit Xhibril, nga ana përmbajtjesore, ajo e kuptimit të tërësishëm të domethënies, është e paarritshme për mendjen e njeriut, ngase është dije e pakufishme e Allahut, xh.sh.

Dhe dihet botërisht se njeriun, qysh nga krijimi i tij, krijimi i Ademit, a.s., e tërhoqi dëshira dhe u intrigua për të ditur sa më shumë, për t'i njohur dhe për t'i kuptuar gjërat që e rrethonin. Dhe, në këtë kontekst Shpallja hyjnore, qysh prej Ademit, a.s., është ajo që ia ofroi njeriut mundësinë e konceptimit të drejtë dhe të plotë të së vërtetës për të arritur te njohuritë e vërteta dhe ato që ai ishte i interesuar t'i dinte. Përndryshe, pa shpallje njeriu do të vazhdonte të endej në qorrsokak, pa arritur kurrë tek e vërteta.

Vetë shpallja i ofron arsyes dhe mendjes së njeriut shumë përgjigje rreth pyetjeve nga sferat apo fushat e shumta, si nga metafizika, psikologjia, sociologjia, letërsia, si dhe njohuri nga të gjitha shkencat e tjera. Gjithashtu ajo ofron njohuri për botën e ardhshme, njohuri të cilat njeriu i beson dhe i kupton për aq sa Allahu, xh.sh., na ka mësuar në Kuran dhe Muhamedi, a.s., përmes haditheve të tij, edhe pse nuk është në gjendje t'i konceptojë e shpjegojë tërësisht, ngase kjo pjesë e shpjegimit dhe e kuptimit në tërësi i takon vetëm Allahut, xh.sh.

Derisa shpallja konsiderohet çelës hulumtimi dhe shtytës për hulumtim për njeriun në këto fusha të shumta, ajo ia mëson njeriut njohuritë dhe ngjarjet që duhet t'i besojë dhe t'i njohë njeriu i çdo niveli, e që janë sekrete dhe që nuk arrihen në saje të angazhimit, të mendjes e të ndjenjave.

Çështjet që kanë të bëjnë me angazhimin e mendjes së njeriut edhe duhen kuptuar si të tilla, dhe jo të pretendohet që revelata të konsiderohet si e tillë, ngase do të vinte deri te koncepte jo të qarta e të gabuara në raport me shpalljen prej Allahut, xh.sh.

Duhet ta kuptojmë drejt, duke mos lënë mundësi a hapësirë tjetër dyshimi e diskutimi, se shpallja është edhe kriter i vetëm që arsyeton, flet dhe vërteton mbi institucionin e domosdoshëm të pejgamberëve.

Allahu, xh.sh., për t'ua dhënë shpalljen, apo për t'i folur ndonjë pejgamberi, zgjodhi disa mënyra, duke pasur parasysh se edhe ngarkesa me mision prej Allahut, xh.sh., nuk ishte te të gjithë pejgamberët me peshën e njëjtë. Kështu, pra, disa pejgamberë të Allahut, xh.sh., ishin edhe më të ngarkuar

sesa disa të tjerë. Megjithatë, kjo assesi nuk e zbeh çështjen e besimit në të dërguarit e Allahut, xh.sh.

Të gjithë ne jemi të obliguar të besojmë në pejgamberinë e tyre, përndryshe nuk konsiderohemi besimtarë të besimit islam. E njëjta gjë është edhe me shpalljen, nëse nuk besojmë në atë që e ka zbritur Allahu, xh.sh., por besojmë vetëm në të dërguarit e tij, atëherë nuk konsiderohemi besimtarë.

Edhe më herët e kemi përmendur se pejgamberia është përzgjedhje hyjnore që Zoti, xh.sh., ia dhuron atij që do Ai. Prandaj, edhe shpallja nuk është rezultat i angazhimit, i përkushtimit, i adhurimit, i dëshirës apo i vullnetit të njeriut, dhe as nuk vjen me kërkesën e njeriut, por është thjesht dhunti (përzgjedhje) e Zotit, xh.sh.[4] Thënë me një fjalë, shpallja është në kompetencën e Zotit, xh.sh., dhe nuk ka mundësi që dikush të zgjedhë se a do të jetë pejgamber, apo jo. Zoti, xh.sh., thotë:

﴿يَخْتَصُّ بِرَحْمَتِهِ مَن يَشَاءُ ۗ وَاللَّهُ ذُو الْفَضْلِ الْعَظِيمِ﴾

***“Mëshirën e Vet Ai ia dhuron kujt të dojë. Allahu është Zotërues i mirësisë së pakufishme.”*** *(Ali Imran: 74)*

[4] Muhamed Ali Sabuni, *En nubuvveh vel enbija*, Kajro, 1984, f. 8.

H. Sherif AHMETI

# FEJA KA LINDUR BASHKË ME NJERIUN*

> ***"Përqendroje, sille fytyrën tënde** (Muhamed) **kah feja duke qenë i pastër dhe i thjeshtë, kah ajo fe me të cilën të stolisur në zemër krijoi Zoti njerëzit. Ajo fe e shenjtë e ngjeshur në natyrën e njerëzimit nuk ndryshon kurrë. Vetëm ajo është feja e vërtetë, por shumica e njerëzve atë nuk e kuptojnë."*** *(Rrum, 30).*

Si prej këtij ajeti, ashtu edhe prej shumë të tjerëve dhe prej haditheve të Pejgamberit a.s. kuptojmë se ndjesia fetare është krijim i Zotit me të cilën i krijoi edhe njerëzit, dhe edhe sikur njerëzit të liheshin të lirë në vete, ata do të gjenin këtë ndjesi edhe pa udhëzues. Kjo fe e natyrshme, të cilën e arrin ta kuptojë shpirti i njeriut pa mësues, është feja e drejtë, e vërtetë. Shumë njerëz nuk e dinë këtë dhe mendojnë se feja është çështje, e cila duhet ndërtuar me bindje dhe se ajo ka nevojë për ndërmjetësues mes Zotit dhe njeriut për të udhëzuar në të.

Ajeti i sipërshënuar i drejtohet Muhamedit a.s., e nëpërmjet tij edhe të gjithë njerëzve, duke kërkuar prej tyre që të përqendrojnë fytyrën (veten) e tyre në atë natyrë, në atë përgatitje, në atë prirje, në të cilën edhe janë të krijuar.

---

* Marrë nga "Takvim/Kalendar", 1404-1984, Prishtinë, f. 36-46.

Nga kjo kuptohet se gurra e fesë është vetë natyra e njeriut, është arsyeja e tij, është një natyrë e veshur shpirtit të tij. Është ide origjinale, e cila ka lindur bashkë me njeriun. Nuk është një gjë, e cila njëherë nuk qe e pastaj u lajmërua. Andaj, sipas besimit islam, feja nuk është shpikje e njerëzimit. Për fenë nuk ka nevojë që të kërkohet ndonjë burim nga jashtë, sepse burimi i saj është vetë natyra e njeriut. Kjo është një cilësi shpirtërore e njeriut për të njohur qenien e një fuqie absolute, qenien e një Zoti, të një pushteti të amshueshëm, vullneti i të cilit sundon mbi gjithësinë. Është një nevojë shpirtërore për të kërkuar një Zot, Krijues i gjithësisë, të Cilit mund t'i lutemi, t'i falemi dhe prej të Cilit mund të kërkojmë ndihmë e mëshirë. Me këtë përgatitje njeriu është i krijuar.

Kjo nyje e parimeve islame është pranuar dhe është vërtetuar prej shumë filozofëve, pas shumë studimeve që i kanë bërë ata. Edhe gjurmimet e historisë së feve, e pranojnë fenë si një dogmë të lindur. Henri Branje, shkrimtar i famshëm francez, thotë: "Nëpër kritikë të historisë është provuar kategorikisht se ndjesia fetare është e ngjeshur në natyrën e njeriut dhe se në asnjë periudhë të historisë nuk u shua kjo ndjesi."

Pra, sikur Kurani, i cili na tregon fenë si një nevojë të shpirtit, ashtu të këtij mendimi janë edhe shumë filozofë të botës. Për këtë arsye, njeriu ka ndier nevojën e fesë, si nevojën për të ngrënë e për të pirë edhe përgjatë shekujve kur jetonte në shpella, atëherë madje njeriu ngarendi pas ndjesisë për të gjetur Zotin, për ta njohur këtë fuqi të lartë që sundon mbi botën. Po të lëmë anash ndryshimin e trajtave fetare dhe idenë fisnike me atë të skaliturën, gati nuk kishim për të vërejtur një dallim në mes të një filozofi të dijshëm dhe të një

animisti, fetishisti a totemisti injorantë, sepse të gjithë këta me idetë e tyre bëhen interpretues të asaj ndjesie të lartë e cila struket në zemrën e tyre.

Druri apo ashti, të cilin e adhuron një fetishist, apo Orizisi, Izisi a Horesi i egjiptianëve të vjetër, Hurmuzi e Ahrimeni i persianëve, Ba'ali i kaldejve dhe i asirëve, Jupiteri i grekëve dhe i romakëve, Tijangi kinez, Amenomi i japonezëve e Vishni i hinduséve... - janë që të gjithë "hyjni" të lindur prej nevojës shpirtërore që ka njeriu për të qenë fetar. Ndonëse ide e mangët dhe e gabuar, megjithatë edhe ndër fetë e gabuara duket qëllimi për ta njohur Zotin e vërtetë. Burimi i atyre feve është i njëjtë, por me kalimin e kohës vendin e tyre e zë mitologjia.

Natyrisht qe ka një ndryshim në mes lutjeve që një i egër i bën një copës së drurit dhe në mes të adhurimit që i bën Zotit të vërtetë një fetar i saktë, dhe kjo gjë nuk e cenon pretendimin tonë. Qëllimi është që ta vërtetojmë se feja është një ide origjinale e pandarë prej natyrës së njeriut. Pse? Sepse, sikurse të egrin, ashtu edhe fetarin e vërtetë i shtynë në adhurim e njëjta ndjesi. Vetëm përparimi i fuqisë arsyetuese dhe ndriçimi i ndërgjegjes prej dritës së vërtetë, ia bëri më fisnike ndjesinë e këtij të dytit. Megjithëkëtë, ekzistimi i të njëjtës ndjesi ndër të dy ata, vërteton nevojën që ka natyra e njeriut për një ndjesi të tillë.

Kjo ide e fesë, që është e natyrshme ndër njerëz, kohë pas kohe, është forcuar nëpërmjet porosive të pejgamberëve të dërguar në faqe të dheut prej të madhit Zot.

Sipas këtij konstatimi që u shënua deri këtu, rezulton se feja ka lindur bashkë me njeriun dhe e vazhdoi jetën bashkë me të, dhe edhe së bashku do të vazhdojë edhe në të ardh-

men. Feja është në simbiozë me njeriun dhe jeton me të pa u ndarë asnjëherë. Ideja e fesë është shumë e vjetër dhe këtë askush nuk mund ta mohojë.

Nëse i hedhim një shikim historisë dhe punës së njerëzimit, do të mjaftonte që të bindemi se ideja fetare lindi bashkë me njeriun dhe bashkë e vazhdoi jetën. Gjatë tërë shekujve nuk mund të gjejmë popull që të mos ketë pasur fe. Është e mundur që ketë pasur popull të varfër, të pa shkollë, të pa dije etj., por jo edhe ndonjë trevë në fytyrën e tokës mbi të cilën të mos i jetë ngritur një faltore Zotit. Është provuar se ku ka njerëz aty ka edhe një lloj feje dhe një lloj të të adhuruarit.

Edhe ndër kohërat primitive, njeriu ka kuptuar se ka disa të vërteta përtej kufijve të kësaj bote lëndore dhe kështu ka filluar, sipas aftësisë së tij mendore, të dallojë mes punëve a sendeve të dobishme dhe të dëmshme, mes të mirës e të keqes, mes hairit e sherrit dhe ka ndier nevojën e një ligji moral, i cili ka pushtet mbi sjelljet e veprimet e tija. E kjo nuk është ndjesi tjetër, përveç se ndjesi fetare.

Historia pohon se breznitë e asnjë shekulli nuk qenë të zhveshur prej ndjesisë fetare të lindur e të natyrshme. Popujt, emrin e të cilëve arriti t'i shënojë historia, të gjithë kanë qenë të pajisur me një fe, dhe jo vetëm popujt e tillë, por edhe ata që jetuan në kohët parahistorike. Edhe popujt që jetuan me mijëra vite më parë, si kuptohet prej fosileve të tyre, kanë qenë të ushqyer prej idesë fetare, gjë që kuptohet prej disa veprave e shenjave; prej kujdesit që treguan në varrimin e të vdekurve, prej gurëve të gdhendur e të vendosur mbi varreza, prej rregullimit të shpellave që i kishin caktuar për varreza.

Në bazë të këtij konstatimi mund të themi si një të vërtetë të pamohueshme se jeta e njerëzimit, individualisht apo ko-

lektivisht, gjithnjë ishte e lidhur me idenë fetare. Se ideja e të qenit religjioz lindi bashkë me njerëzim dhe jetoi bashkë me të, vërtetohet se kjo ndjesi e natyrshme që qëndroi e pa degjeneruar që nga kur u krijua njerëzimi dhe jo që u dobësua ndër kohë, por erdhi duke u rritur edhe më tepër, paralelisht me zgjimin dhe lartësimin e mendjes së njeriut. Këtë e kanë vënë re edhe dijetarët e njohur, studiues të ligjeve të natyrës. Filozofi Herbert Spencer, ka thënë: "Duke u thelluar në një anë në studime e kërkime, në anën tjetër në mes mistereve që na shfaqen në këtë përpjesëtim, takojmë një të vërtetë të qartë: në qenie të një fuqie që s'ka fillim dhe as mbarim dhe e cila është sipërnjerëzore dhe burim i çdo sendi. Përparimi i shkencës provon edhe më saktë ekzistencën e një qenie absolute, esencën e së cilës as nuk mund ta kuptojmë dhe as ta kuptojmë fillimin e as mbarimin e saj, sa kohë që gjithçka rrjedhë prej asaj fuqie."

Ky filozof, sipas këtyre fjalëve, thotë: "Duke përparuar shkenca, e njohim më mirë qenien e një Krijuesi, dijenia e të cilit përfshinë gjithçka, kurse mendja jonë nuk është në gjendje që të arrijë të kuptojë veten e tij. Ky pohim nuk është gjë tjetër vetëm se përsëritje e thënies së vërtetë islame: *"Subhaneke ma arefna hakka ma'rifetike ja ma'budu!?"*.

Pra feja, gurra e së cilës është vetë natyra e njeriut, është e përjetshme dhe nuk shuhet. Përkundrazi, nën përshtypjen e mendimeve filozofike dhe të eksperiencës shkencore, burimi i fesë vjen duke u shtuar. Organizmi i brendshëm i fesë është shumë i fortë dhe larg çdo kërcënimi, megjithëqë gjendja e jashtme e saj duket si e shpartalluar. (Mendohet për besëtytnitë të cilat më vonë janë futur në fe). Nëpër rrymat e kohë-

rave asaj nuk iu shter gurra. Jeta njerëzore ka filluar me fe, vazhdoi me fe dhe do të shuhet me fe.

Kjo është teoria e vërtetë islame dhe e shpalljeve të mëparshme mbi burimin e ndjesisë së fesë. Dhe kështu prej shënimeve të larta kujtojmë se njerëzimi nuk ka jetuar kurrë pa fe.

Mirëpo, për shkak të vjetërsisë kaq të madhe të fesë, përveç teorisë së sipërshënuar, të vërtetë e të sigurt, janë shtruar edhe teori të tjera rreth burimit të saj, e këtu do të përmendim edhe dy sosh:

- Mendimi se feja ka për burim frikën dhe shpresën.

Ata, që në trajtë primitive pranojnë dhe vërtetojnë fillimin për një send, thanë se feja në njeriun nuk është një mendim origjinal, por ky mendim i erdhi më vonë dhe se e ka burimin e vet në frikën dhe shpresën.

Sipas këtij mendimi, ideja fetare zhvillohet kështu: njeriu ka dy ndjesi: frikën dhe shpresën. Ngjarjet që i mbesin jashtë sundimit të tij i japin njeriut një frikë e një shpresë. Njeriu që për të parën herë vëren natyrën plot lëvizje, mbetet i shtangur ndaj disa incidenteve që i dalin përpara, e që burimi i vërtetë i tyre është i panjohur prej tij dhe kështu trembët, dridhet, ndien vuajtje në zemrën e vet, ndërsa një pjesë tjetër e këtyre incidenteve i japin fllad, gëzim dhe shpresë atij.

Incidenti i vdekjes, f. v., e lënë të shtrirë për dhe, dhe pa frymë një njeri, me të cilin kemi jetuar bashkë deri në atë moment. Para kësaj ngjarje të tmerrshme, natyrën e së cilës njeriu s'mund ta kuptoj, habitët, dridhet. Gjëma e qiejve, shkrepja e vetëtimës, rrufeja, stuhitë dhe tërmetet që përfshijnë çdo gjë dhe lëkundin globin e dheut si një djep, vërshimet, errësira e natës, të ftohtit e vapa, me një fjalë, lëvizje kësodo-

re me burime të pa njohura, të gjitha këto prodhojnë një lloj droje, një mjerim.

Megjithëkëtë, njeriu pranë këtyre lëvizjeve të frikshme, vëren edhe sish që derdhin në zemrën e tij fllad e shpresë, f.v., yjet që vezullojnë në kupën e qiellit në një natë të qetë, Hënën e ndritshme, e cila endet në hapësirë në mënyrë madhështore. Dielli i cili me shkëlqimin e tij i jep jetë natyrës, shiun i cili derdhet këndshëm mbi sipërfaqen e dheut.

Tash njeriu plotësisht i hutuar ndaj këtyre lëvizjeve të natyrës, të cilat shfaqen në një kundërshtim kaq të madh ndërmjet tyre, bie për dhe, lutet e falet për të qenë i mbrojtur ndaj atyre lëvizjeve të cilat sjellin dëm, dhe për të pasur një dobi a të mirë prej atyre të cilat janë të dobishme. E këto të lutura e të falura përsëritën pa ndërprerë, sakrifikojnë dhurata e flijime, dhe kështu pastaj duke flijuar, lind ideja e fesë dhe ceremonitë fetare. Kjo ide fillon njëherë në këtë trajtë dhe duke u plotësuar dalëngadalë, së fundmi gjen trajtën të cilën e shohim ndër kohërat e sotme.

## Vërejtje mbi pavlefshmërinë e kësaj teorie

Kjo teori nuk na tregon burimin e fesë, por ndoshta na shpjegon faktet e zhvillimit të idesë fetare. Lypset që njeriu ta ketë në natyrën e tij “idenë fetare” më së pari që kështu mandej të mund t’i drejtohet asaj në raste të këtyre lëvizjeve të natyrshme. Të mos ishte në natyrën e shpirtit të njeriut të besuarit ndaj një qenie absolute, e cila sundon mbi të gjitha këto fuqi natyrore, nuk do të kishte ndonjë kuptim as të kër-

kuarit e një mbrojtjeje, dhe as të luturit dhe as të shtruarit e flijimeve kundrejt ndodhive që fiksojnë ose japin shpresë.

Pra, është një veti e ndërlindur në njeriun që të besojë, - ashtu siç na lajmëron Kurani dhe siç e kanë pranuar një shumicë filozofësh bashkëkohorë - në një fuqi të plotë (në Zotin e vërtetë), ndikimi i së cilit vërehet kudo dhe gjithçka nën pushtetin e saj. Njeriu lind me këtë ide, nga e cila rrjedhin në përpjesëtim me fuqinë e tij kuptuese - të gjitha lutjet e tij që ia bënë asaj fuqie.

Të kërkuarit e një foleje shpëtimi kur njeriut i kërcënohet rreziku, tremba kur ngrit kokën lart dhe sheh mbi vete atë hapësirë të tmerrshme e të pambaruar, të urryerit e errësirës që mbulon tokën atëherë kur çdo krijesë është në gjumë, të tremburit para vetëtimës dhe rrufesë së llahtarshme të motit të lig, të dridhurit duke menduar se do të vdes një ditë dhe, më në fund, të kërkuarit e një dore shpëtimtare në atë moment që na vërsulet vdekja me kthetrat e veta, janë të gjithë këta faktorë që sigurojnë zhvillimin e idesë fetare, e cila është e ndërlindur në njeriun. Pra, të besuarit në Zotin është një veti origjinale e njeriut dhe jo një ngjarje e rastit të cilën e ka lindur frika e shpresa.

Po të mendojmë pak me gjakftohtësi, a nuk do të na dukej një naivitet sikur të pranonim se fetë të cilat kanë luajtur një rol të madh në historinë e njerëzimit na qenkëshin pjellë e një iluzioni, e një fantazie? Si mund të pranohej feja si e tillë, kur ka mjaft argumente të forta mbi faktet se prej saj kanë lindur etika, jurisprudenca, sociologjia, e edhe idetë shkencore e filozofike! Të menduarit e fesë si iluzion është mendim shumë i mangët.

Madje, po të mos kishte lindur ideja fetare atëherë kur lindi njerëzimi, e të ishte një ide okazionale e shkaktuar prej ngjarjeve të natyrës, do të duhej zhdukur kjo ide duke përparuar mendja njerëzore dhe duke u zbuluar karakteri-esenca e atyre fuqive të natyrës.

Mirëpo, duke përjashtuar disa dijetarë që shqyrtuan fuqitë e natyrës erdhi duke u zhvilluar edhe më fortë dhe në mënyrë më të themeltë ideja fetare. Shumë dijetarë që janë thelluar në studimin e historisë së feve, pranojnë fenë si një parim doktrinar të natyrshëm, e me këtë, përveç që rrëzojnë çdo hipotezë tjetër, ata i afrohen asaj të vërtete për të cilën bënë fjalë Kurani: **"Fitretull-llahi..."**, ***"Natyrshmëri nga ana e Allahut..."***.

Sikurse është vërtetuar me studimet e fundit, të cilat i bënë dijetarët e historisë së feve, se ndjeshmëria e frikës dhe e shpresës të zgjuara te njeriu ndaj fuqive natyrore, nuk janë burim i fesë, por faktorë të zhvillimit të idesë fetare; një kështu vërtetohet në Kuran se feja është një veti shpirtërore në natyrën e njeriut. Të gjitha qeniet, të gjitha fenomenet e natyrës janë faktorë më të shëndoshë të cilët i shërbejnë zhvillimit të ndjesisë fetare e cila është e ndërlindur në njeriun. Një njeri i cili i vëren të gjitha këto fenomene, kupton ekzistencën e një Zoti, i cili është Krijues dhe Rregullues i atyre fenomeneve. Për këtë arsye Kurani famëlartë urdhëron që ta kërkojmë Zotin dhe për të gjetur Atë. Ai thotë se një faktor i madh në këtë drejtim janë qiejt dhe toka: **"Kul undhuru ma dha fis semavati vel erdi."** ***"Thuaju: Shikoni se ç'ka në qiej e në Tokë..."***

# Mendimi se feja ka për burim gënjeshtrën

Sipas këtij mendimi, feja nuk është e së njëjtës kohë me shoqëritë e para të njerëzimit; është një diçka që i është shartuar trupit shoqëror prej parisë fetare pas shumë kohe të përparimit të tij, e për të mbajtur këtë nën zgjedhë. Të këtij mendimi janë edhe disa filozofë. Mirëpo, edhe pse ata filozofë pranuan ekzistencën e Zotit dhe pavdekshmërinë e shpirtit, duket se ata në një konstatim të tillë disa punë të pakëndshme që i kryenin nën maskën e fesë disa prijës të fesë të cilët ishin bashkëkohës me ata filozofë.

## Vërejtje kundër kësaj hipoteze

Megjithëkëtë, feja nuk është siç kujtojnë këta, dredhia e gënjeshtra e të vjetërve dhe priftërinjve-prijësve fetarë. Një mendim të tillë është një gabim i qartë. Ta kujtosh fenë kështu vjen si ta pranosh njerëzimin si një grumbull të marrësh e të mashtruesish, gjë që kjo do të ishte një mohim i së vërtetave historike. Është për t'u pyetur se si mundi të vazhdoi deri me sot ajo gënjeshtër që thuhet për fenë?

Kjo hipotezë sa është e çuditshme, aq është edhe gabim historik, sepse, sipas kësaj, feja paskësh filluar që të dominojë mbi shoqërinë njerëzore pas ardhjes së shumë priftërinjve e fallxhorëve. Ky konstatim vjen nga mosdija se feja ka lindur bashkë me njerëzimin, dhe t'i japësh kaq rëndësi fallxhorëve është poshtërim për njerëzimin.

Sot edhe filozofët që nuk i përmbahen asnjë feje, nuk i japin kurrfarë rëndësie kësaj hipoteze. Sociologët thonë se "ndjesia fetare" në njeriun është një faktor moral shumë i

fortë dhe i natyrshëm, kurse paaftësia që ndien mendja e njeriut para Fuqisë Hyjnore, ka përtërirë në zemrën e tij ndjesitë e nderimit dhe adhurimit ndaj asaj fuqie. Edhe kjo e vërteton pavlefshmërinë e hipotezës në fjalë.

**Sabri ef. BAJGORA**

# KOMENTIMI I KAPTINËS EL-BELED

لَآ أُقۡسِمُ بِهَٰذَا ٱلۡبَلَدِ ﴿١﴾ وَأَنتَ حِلُّۢ بِهَٰذَا ٱلۡبَلَدِ ﴿٢﴾ وَوَالِدٖ وَمَا وَلَدَ ﴿٣﴾
لَقَدۡ خَلَقۡنَا ٱلۡإِنسَٰنَ فِي كَبَدٍ ﴿٤﴾ أَيَحۡسَبُ أَن لَّن يَقۡدِرَ عَلَيۡهِ أَحَدٞ ﴿٥﴾
يَقُولُ أَهۡلَكۡتُ مَالٗا لُّبَدًا ﴿٦﴾ أَيَحۡسَبُ أَن لَّمۡ يَرَهُۥٓ أَحَدٌ ﴿٧﴾ أَلَمۡ نَجۡعَل
لَّهُۥ عَيۡنَيۡنِ ﴿٨﴾ وَلِسَانٗا وَشَفَتَيۡنِ ﴿٩﴾ وَهَدَيۡنَٰهُ ٱلنَّجۡدَيۡنِ ﴿١٠﴾ فَلَا
ٱقۡتَحَمَ ٱلۡعَقَبَةَ ﴿١١﴾ وَمَآ أَدۡرَىٰكَ مَا ٱلۡعَقَبَةُ ﴿١٢﴾ فَكُّ رَقَبَةٍ ﴿١٣﴾ أَوۡ إِطۡعَٰمٞ
فِي يَوۡمٖ ذِي مَسۡغَبَةٖ ﴿١٤﴾ يَتِيمٗا ذَا مَقۡرَبَةٍ ﴿١٥﴾ أَوۡ مِسۡكِينٗا ذَا مَتۡرَبَةٖ ﴿١٦﴾
ثُمَّ كَانَ مِنَ ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ وَتَوَاصَوۡاْ بِٱلصَّبۡرِ وَتَوَاصَوۡاْ بِٱلۡمَرۡحَمَةِ ﴿١٧﴾
أُوْلَٰٓئِكَ أَصۡحَٰبُ ٱلۡمَيۡمَنَةِ ﴿١٨﴾ وَٱلَّذِينَ كَفَرُواْ بِـَٔايَٰتِنَا هُمۡ أَصۡحَٰبُ
ٱلۡمَشۡـَٔمَةِ ﴿١٩﴾ عَلَيۡهِمۡ نَارٞ مُّؤۡصَدَةُۢ ﴿٢٠﴾

**“Betohem në këtë qytet! në të cilin ti je i lirë** (o Muhamed)! **Betohem në prindin dhe në atë që lind prej tij! Vërtet, Ne e krijuam njeriun për vështirësi të njëpasnjëshme. A mendon ai se askush nuk ka pushtet mbi të? Ai thotë** (me mburrje): **“Unë kam shpenzuar shumë pasuri!” Vallë, a mendon ai se nuk e ka parë askush? A nuk i dhamë Ne atij dy sy, edhe gjuhë, e dy buzë, dhe ia kemi bërë të qarta të dyja rrugët? Atëherë, përse nuk u përpoq ta kapërcente “rrugën e vështi-rë”! E ku e di ti se ç’është “rruga e vështirë”? Ajo është lirimi i një skllavi, ose dhënia e ushqimit në kohën kur mbre-tëron uria: ndonjë jetimi që është i afërt, ose ndonjë të var-**

**fëri të cilin e ka dëshpëruar varfëria. Veç kësaj, të jetë nga ata që besojnë, që e këshillojnë njëri-tjetrin për durim dhe këshillojnë për mëshirë. Këta janë të anës së djathtë. Ndërsa ata që i mohojnë argumentet Tona, janë të së majtës. Mbi ta do të jetë një Zjarr i mbyllur** (përvëlues)" - (El-Beled, 1-20).

***

*Kaptina El-Beled me unanimitetin e dijetarëve është kaptinë mekase. Transmetojnë Ibën Durejsi, Nehasi, Ibën Merduvejhi dhe Bejhekiu nga Ibën Abasi të ketë thënë: "Ka zbritur surja* **"La uksimu bi hadhel beled"** *në Mekë. Po ashtu, të njëjtin transmetim Ibën Merduvejhi e përcjell edhe nga Ibën Zubejri.*[1]

*Kjo sure ka gjithsej 20 ajete, 82 fjalë dhe 351 shkronja.*[2] *Ka zbritur pas sures Kaf dhe para sures Et Tarik. Në radhitjen e Mushafit mban numrin 90, kurse në radhitjen e zbritjes është e 35-ta.*[3]

## Emërtimi i kësaj kaptine

1. Emërtimi kryesor i kësaj sureje, me të cilin është radhitur nëpër Mushafe dhe nëpër librat e Tefsirit është **El-Beled**. Arsyeja e këtij emërtimi është betimi i Allahut në qytetin e shenjtë - Mekën[4], që në ajetin e parë, të cilin qytet Ai e ka

---

[1] Imam Shevkaniu, *Fet'hul Kadiir,* vëll. V, f. 439.

[2] El Fejruzabadi, *Besairu dhevi-t-temjizi,* Kajro, 1996, vëll. I-rë, f. 520.

[3] Ibn Ashur, *Et Tahriru ve-t Tenviru* vëll. XXX f. 345.

[4] *Esmau Suveril Kuranil Kerim*, f. 207.

nderuar me Shtëpinë e shenjtë duke e bërë Kible - drejtim për të gjithë myslimanët, gjatë namazeve të tyre.

2. Emërtimi i dytë i kësaj sureje është *"La uksimu bi hadhe-l-beled"*. Ky emërtim është përcjellë nga Ibën Abasi, ashtu siç pamë më lartë. Këtë emërtim e kanë cekur edhe Sanani dhe Fejruzabadi. Arsyeja e këtij emërtimi është po ashtu ajeti i parë i sures: *"Betohem në këtë qytet!"*[5]
3. Emërtimi i tretë i sures është **"La Uksimu".** Me këtë emërtim e kanë radhitur Buhariu,[6] Alusi, Shevkani e të tjerë, dhe bazë e këtij emërtimi është ajeti i parë i sures.[7]
4. Emërtimi i katërt dhe i fundit i kësaj sureje është **"Suretul Akabe"**. Këtë emërtim ka përmendur Fejruzabadi, ndërkohë që arsyeja e këtij emërtimi është ajeti i 11-të i saj: **"Atëherë, përse nuk u përpoq ta kapërcente "rrugën e vështirë"!"**[8]

## Vlera e kësaj kaptine

- Surja *El-Beled* bën pjesë në grupin e sureve *"El-Mufassal"*, me të cilat Resulullahu s.a.v.s. është nderuar ndaj të dërguarve të tjerë. Në lidhje më këtë, është transmetuar nga Vathilete ibnul Eska'ë el-Lejthi të ketë thënë: "Ka thënë i Dërguari i Allahut s.a.v.s.: *"Më është dhënë në vend të Tevratit, shtatëshja,* (suret prej *El-Bekare* deri tek ato *El-Enfal*

---

[5] *Esmau suveri-l Kuran ve fedailuha*, f. 551.

[6] Sahihul Buhari - *Kitabu-t-Tefsir*, vëll. VI, f. 83.

[7] Dr. Adem Bemba, *Esmau-l Kurani-l Kerim ve esmau suverihi ve ajatihi-mu'xhemun mevsuijjun mujesserun*, Dubai, 2009, f. 64.

[8] *Besairu dhevi-t-temjizi,* vëll. I, f. 520.

ose *Et-Tevbe), më janë dhënë në vend të Zeburit, "El-Mi'ine" - një qindëshet,* (suret që kanë mbi 100 ajete ose afër 100); *më janë dhënë në vend të Inxhilit "El-Methani"* - (suret që kanë më pak se 100 ajete)*, ndërsa jam mbinderuar* (ndaj të dërguarve të tjerë) *me suret "El-Mufassal"* (prej sures *Kaf,* e është thënë prej asaj *El-Huxhurat,* e deri tek *En-Nas).*[9]

## Shkaku i zbritjes së kësaj kaptine

Ndonëse për suren si tërësi nuk ka ndonjë shkak specifik të zbritjes, megjithatë disa dijetarë, por jo edhe kolosët e kësaj shkence Vahidiu dhe Sujutiu, kanë shënuar shkaqet e zbritjes për ajetet 5 dhe 6, e për të cilët do të flasim më detajisht gjatë komentimit.

## Lidhja e kësaj kaptine me atë paraprake El-Fexhr

Kaptina *El-Beled* ka disa lidhje kuptimore me atë paraprake *El-Fexhr*.

- Kaptina paraprake përfundoi me ajetet që flasin për gjendjen e shpirtit të qetë teksa kthehet te Zoti i Gjithëfuqishëm, dhe shpërblimet që i ka përgatitur Ai për njeriun në Xhenet, i cili është vendi më i ndershëm dhe më fisnik që ka krijuar i Gjithëpushtetshmi për besimtarët, kurse kjo sure fillon me betimin në tokën më të ndershme e më të bekuar në fytyrë të Tokës, në Mekën fisnike.

---

[9] Transmetojnë Imam Ahmedi (4/107) dhe Bejhekiu në *Shuabi-l Iman* - (2/465).

- Në kaptinën paraprake, Allahu i qortoi ashpër ata që lakmojnë së tepërmi në pasuri, ata që e hanë trashëgiminë dhe ata që nuk nxisin për të ushqyer të varfrin, ***"Nuk e nxisni njëri-tjetrin për ta ushqyer të varfrin, dhe ju e hani me të madhe trashëgiminë*** *(pa të drejtë),* ***dhe pasurinë e doni së tepërmi."*** - *(El-Fexhr, 18-20),* ndërsa tash në këtë sure, Ai dëfton për cilësitë që kërkohen nga ai që ka pasuri: Lirimin e një robi dhe të ushqyerit e një të varfrit, kur një vend e pllakos uria dhe skamja.[10]
- Allahu xh.sh. e përmbylli suren paraprake me sqarimin e gjendjes shpirtërore të njerëzve të mirë në Ahiret, si të qetë e të kënaqur, kurse në këtë kaptinë cek rrugën që duhet ndjekur për të arritur deri të kjo qetësi shpirtërore, duke tërhequr vërejtjen për largim nga kufri-mosbesimi, i cili vjen si pasojë e mohimit dhe mosrespektimit të urdhrave të Allahut Fuqiplotë.

## Përmbajtje e shkurtër e kësaj kaptine

- *Kaptina El-Beled flet për shenjtërinë e Mekës fisnike, fisnikërimin e Ademit a.s. dhe pasardhësve të tij, duke ia drejtuar ftesën krijesës njerëzore që të kapërcejë vështirësitë, mundimet dhe sprovat e kësaj bote me durim, për ta arritur atë më të shtrenjtën, qetësinë dhe shpërblimin e përjetshëm në Ahiret, gjë e cila arrihet vetëm duke pasuar udhëzimin e*

---

[10] Xhelaluddin es Sujuti, *Tenasuku-d-durreri fi tenasubi-s-suveri*, Bejrut, 1986, f. 137.

*Shpalljes hyjnore që i kishte zbritur Muhamedit a.s., pikërisht në vendin më të shenjtë në Tokë, në Mekën fisnike.*[11]

- *Kaptina fillon me betimin e Allahut në vendin e shenjtë - Mekën, vendlindjen e Pejgamberit të fundit, në shenjë nderimi për këtë të Dërguar dhe pozitën e tij të lartë te Krijuesi Fuqiplotë. Kjo sure së bashku me atë El-Kijame, janë dy suret e vetme në Kuran që fillojnë me betim, me shkronjën "La uksimu", e që nga këndvështrimi gjuhësor nënkupton një betim shumë të fuqishëm, aq më parë kur këtu betimi është bërë në Mekën fisnike, ndërsa në Ditën e Ringjalljes te surja El-Kijame.*
- *Kjo sure, sipas përmbajtjes që shtjellon, kryesisht ua tërheq vërejtjen jobesimtarëve-idhujtarëve mekas se keqtrajtimi i këtij të Dërguari në vendin e shenjtë, është një prej mëkateve më të mëdha, sepse në këtë vend që i Lartmadhërishmi e ka dalluar me shenjtëri prej vendeve të tjera, njeriu duhet të ndjejë siguri dhe qetësi të plotë.* ***(Shih ajetet: 1-4).***
- *Në vazhdim të sures, shohim inatin dhe urrejtjen e idhujtarëve mekas ndaj të vërtetës, të cilët e përgënjeshtruan të Dërguarin e Allahut dhe, pasurinë e tyre e shpenzonin vetëm për t'u mburrur e krenuar para të tjerëve. Ata nga urrejtja e tyre ndaj Dritës hyjnore që tashmë kishte filluar të zhdukte errësirën e kufrit, shpenzonin pasuritë e tyre në gjëra të shëmtuara dhe në luftë kundër Islamit, në përpjekje të pashpresa që të mos humbnin privilegjet e tyre.* ***(Shih ajetet: 5-7).***

---

[11] Dr. Umer Ali Hassan Arefat, *Delaletu esmai-s-suveri-l kuranijjeti ala mehaviriha ve mevduatiha,* Bejrut, 2018, f. 703.

- *Pastaj i Lartmadhërishmi ua rikujton këtyre njerëzve se Ai u ka dhuruar sytë dhe të parët, gjuhën për të folur e komunikuar mes vete dhe ua ka bërë të qartë se ekzistojnë vetëm dy rrugë (alternativa): ose pasimi i rrugës që shpie te kënaqësia e Allahut, ose rruga në të cilën fton shejtani dhe humbëtira e përjetshme.* **(Shih ajetet: 8-10).**
- *Kaptina vazhdon me sqarimin se ai që nuk ndjek rrugën e drejtë, do të ballafaqohet në Ahiret me shumë ndëshkime, e rruga e vetme për të shpëtuar prej kësaj fatkeqësie është imani i pastër, i cili zbukuron moralin e çdo besimtari dhe nxit në punë të mira.* **(Shih ajetet: 11-18).**
- *Kaptina përfundon me përshkrimin e gjendjes së atyre që mohuan argumentet e Fuqiplotit, vendqëndrimi i të cilëve do të jetë zjarri i Xhehenemit.* **(Shih ajetet: 19-20).**

# Jeta - sprovë e vështirë

**“Betohem në këtë qytet!, në të cilin ti je i lirë** (o Muhamed)! **Betohem në prindin dhe në atë që lind prej tij! Vërtet, Ne e krijuam njeriun për vështirësi të njëpasnjëshme” -** (El-Beled, 1-4).

***

**Koment:**

**1. Betohem në këtë qytet!**

Kjo sure mekase, fillon me një betim të veçantë, me betimin në vendin më të pastër e më fisnik në sipërfaqen e Tokës, në Mekën e bekuar.

Me këtë betim synohet Meka e bekuar, i cili vend është i tëri i rrethuar me madhështi, kur vetë Allahu i Madhërishëm e ka veçuar me shenjtëri, që ditën kur krijoi qiejt dhe Tokën.

Meka është vendi ku për herë të parë u hodhën themelet e një faltoreje në të cilën do të adhurohej e madhërohej Allahu i Gjithëfuqishëm, ashtu siç ka ardhur në suren Ali Imran, në ajetin e 96-të: ***“Shtëpia** (xhamia) **e parë e ndërtuar për njerëz, është ajo në Bekë** (Mekë), **e dobishme dhe udhërrëfyese për mbarë njerëzimin.”***

Në këtë truall të bekuar është kibla e krejt myslimanëve të botës: ***“Pra kthehu anës së xhamisë së shenjtë** (Qabesë), **dhe kudo që të jeni** (o besimtarë) **kthehuni kah ajo anë.”** - (El-Bekare 144),* dhe po në këtë tokë, kryhen edhe ritualet e Haxhit: ***“Për hir të Allahut, vizita e shtëpisë** (Qabesë) **është obligim për atë që ka mundësi udhëtimi tek ajo.”** - (Ali Imran 97).*

Allahu e ka cilësuar këtë qytet si vend të sigurt, si për njerëzit ashtu edhe për gjallesat e tjera: ***“dhe kush hyn në te, ai i sigurt,”** - (Ali Imran, 97).*

Shkronja "La" në fillim të kësaj sureje, sipas shumicës së dijetarëve nuk është mohuese, por është përemër lidhor, e disa dijetarë mendojnë se *"lami"* këtu është shkronjë hapëse, sikur parafjala *"Ela" - "prandaj, pra",* e cila në të shumtën e rasteve vjen për të treguar rëndësinë ose vërtetimin e pakontestueshëm për diçka, e në këtë rast rëndësinë dhe peshën e madhe të këtyre gjërave në të cilat është betuar i Madhërishmi, me të cilat betime edhe fillon kjo sure. Fjala *"La uksimu"*, e përdorur në Kuran, është më shumë se betim, dhe është shumë më e fuqishme si shprehje sesa vetëm fjala *"Uksimu"*[12], e cila pikërisht për të tilla arsye nuk ka ardhur askund në Kuran në këtë formë.

**2. në të cilin ti je i lirë** (o Muhamed),

Ky ajet, sipas dijetarëve mund të përfshijë në vete dy mendime, dhe që të dyja janë të pranuara nga mesi i dijetarëve, sepse nuk vijnë në kundërshtim me njëri-tjetrin.

Sipas mendimit të parë, përkthimi i ajetit duhet të jetë kështu: ***"në të cilin ti je i lirë** (o Muhamed)",* dhe si i tillë vjen me një veçanti specifike për të Dërguarin a.s.. Sipas shumicës dërmuese të dijetarëve, në krye me Ibën Abasin, Muxhahidin, Seid ibën Xhubejrin, Kataden, e shumë të tjerë, ky ajet nënkupton se Muhamedit a.s. i është lejuar çdo veprim brenda territorit të Mekës, fjala është për luftën dhe çlirimin e saj nga kthetrat e idhujtarëve dhe të vrasë apo të robërojë ata që i kundërvihen atij në këtë qëllim. Sipas Sheriatit islam, bazuar edhe në fjalët e Pejgamberit tonë, Muhamedit a.s., i

[12] Selman el Aude, *Ishrakat kuranije*, Riad, 1433 h., vëll. I, ff. 428-429.

cili ka thënë: *“Këtë vend (qytet) Allahu e ka shenjtëruar (duke e bërë të ndaluar vrasjen në të), në ditën që Ai krijoi qiejt dhe Tokën, e do të mbetet i shenjtë me shenjtërinë e Allahut deri në Ditën e Gjykimit...”.*[13] Sipas shumicës së dijetarëve, bazuar edhe në këtë hadith të cituar në parë, ky vend është i mbrojtur nga vetë i Madhërishmi dhe në të është e ndaluar vrasja apo dëmtimi i dikujt, qoftë prej njerëzve, gjallesave apo bimësisë, deri në Ditën e Kiametit. Por, në tërë këtë shenjtërim, vetëm të Dërguarit a.s., i është lejuar, varësisht rrethanave, vrasja e atyre që rebelohen ndaj Allahut dhe udhëzimit të Tij, dhe po ashtu, sipas këtij hadithi profetik, në një rivajet tjetër, një gjë e tillë i qe lejuar vetëm për disa orë të caktuara të ditës *(në ditën e çlirimit të Mekës, sqarim yni S.B.).”*[14]

Ndërsa nëse anojmë kah mendimi i grupit të dytë të dijetarëve, të cilët mendojnë se ky vend, pra Meka, është i shenjtë dhe i çmuar, për shkak se pikërisht ti o Muhamed je banor i saj,[15] atëherë ky ajet do të duhej të përkthehej e kuptohej kështu: ***“Sepse ti** (o Muhamed)**, je banor i saj”***. Nëpërmjet këtij ajeti u dërgohet një mesazh i qartë kurejshëve, se ju që po pretendoni se jeni mbrojtës të Shtëpisë së shenjtë, po e mundoni dhe persekutoni pikërisht njeriun më të vlefshëm të njerëzimit, që Allahu ua dërgoi nga mesi juaj si udhërrëfyes të rrugës së drejtë. (Megjithatë, Allahu e di më së miri!).

---

[13] *El-Lu’lu’u vel merxhan fima ittefeka alejhi esh-Shejhan,* hadithi nr. (859).

[14] *Fi Rihabi-t-Tefsir*, vëll. 30. f 7985.

[15] Dr. Musaid et Tajjar, *Tefsir Xhuz’u Amme*, Demmam, 1420 h., f. 147.

**3. Betohem në prindin dhe në atë që lind prej tij!**

Në këtë ajet, sipas shumicës së dijetarëve në krye me Ibën Abasin, Muxhahidin, Kataden, Dahhakun etj., Allahu xh.sh. është betuar në Ademin a.s. si prind i parë i krejt njerëzimit, po edhe në pasardhësit e lindur prej tij deri në Ditën e Gjykimit.[16] Betimi në Ademin a.s. dhe në llojin njerëzor, ka ardhur për disa arsye, ndër të cilat do të veçonim krijimin e njeriut në formën më të bukur, siç ka ardhur në suren *Et Tin*, ajeti 4: ***"Vërtet, Ne e krijuam njeriun në formën më të bukur."*** Pastaj Allahu e ka fisnikëruar dhe nderuar njeriun ndaj krijesave të tjera, të cilën gjë e vërteton edhe ajeti i 69-të i sures *El-Isra'ë*: ***"Ne, vërtet nderuam pasardhësit e Ademit*** *(njerëzit),* ***u mundësuam të udhëtojnë hipur në tokë e në det, i begatuam me ushqime të mira, i vlerësuam ata*** *(i lartësuam)* ***ndaj shumicës së krijesave që Ne i krijuam."*** Mu për këtë, i Madhërisahmi i urdhëroi melekët që t'i binin në sexhde nderimi Ademit a.s., kur Ai ia dhuroi shpirtin dhe e bëri të gjallë. E nderoi njeriun dhe ia mundësoi të krijonte kulturë dhe të arrijë avancim teknologjik, të studionte Tokën dhe qiejt etj.. Pastaj vetëm nga lloji njerëzor zgjodhi pejgamberë, e prej ymeteve të tyre zgjodhi dijetarët dhe thirrësit në rrugën e Allahut etj..

Disa dijetarë të tjerë mendojnë se këtu Allahu i Madhërishëm është betuar në Ibrahimin dhe Ismailin a.s., pra, në babë dhe bir, nga loza e të cilëve rrjedh edhe Muhamedi a.s. si

[16] Fejsal bin Aid bin Muhamed el Hatabi, *En-Nuru-l bahiru min kelami-l Alijji-l Kahir - Tefsir Xhuz'u Amme,* Xheda, 2007, f. 137.

vula e krejt të dërguarve.[17] Disa e kanë detajuar edhe më këtë mendim duke thënë se me fjalën *prind* nënkuptohet Ismaili a.s., ndërsa me të *lindurin,* Muhamedin a.s., meqë ka lindur në Mekë, qytet ky që është shenjtëruar nga vetë Zoti Fuqiplotë.[18] Ndërkohë, mendimi i tretë është mendim i përgjithshëm që përfshin çdo prind dhe çdo të lindur prej tyre, pa e specifikuar nëse bëhet fjalë për prindërit e parë të njerëzimit, Ademin a.s. dhe Havanë,[19] i cili mendim pothuajse përputhet më së shumti me kuptimin e ajetit në fjalë, sepse flet në mënyrë të përgjithësuar për secilin prind dhe për secilin fëmijë të lindur. Sidoqoftë, që të gjitha këto mendime, kanë mbështetje në mesin e dijetarëve, dhe që të gjithë mund të jenë të synuara nëpërmjet këtij ajeti, sepse nuk vijnë në kundërshtim me njëri-tjetrin.

**4. Vërtet, Ne e krijuam njeriun për vështirësi të njëpasnjëshme.**

Ky ajet është përgjigje e betimeve paraprake të kësaj sureje dhe dëfton se njeriu, e me këtë nënkuptohet krejt lloji njerëzor, në këtë botë do të jetë vazhdimisht i ekspozuar ndaj sprovave dhe vështirësive të ndryshme, të cilat i vijnë atij një pas një dhe pandërprerë. Ky është fati i njeriut, që nga lindja e tij e deri në vdekje, përpjekje e vazhdueshme për mbijetesë,

---

[17] Muhamed el Gazali, *Nahve tefsirinn mevduijjin li suveri-l Kuran,*. Kajro 2000, f. 520;

[18] Për më gjerësisht shih: Ibën Adil ed-Dimeshkij el Hanbelij, *El-Lubab fi ulumi-l Kitab,* Bejrut, 1998, vëll. XX, ff. 341-342.

[19] Këtë mendim e ka zgjedhur Ibën Xherir et Taberiu. Shih tefsirin e Ibën Kethirit, Giza, 2000, vëll. XV, f. 354.

për sigurimin e rrëskut, krijimin e familjes, mirëqenies materiale, edukimit, arsimimit, punësimit etj.. Në fund, të gjithë do ta përjetojnë vdekjen dhe ndarjen nga kjo botë, e dallimi i vetëm në mes njerëzve është përfundimi i tyre, dhe mënyra se si kanë arritur t'i menaxhojnë situatat dhe rrethanat, përfshirë këtu edhe sprovat e njëpasnjëshme.[20]

Fjala *"kebed"* e përdorur në këtë ajet, në aspektin gjuhësor do të thotë vështirësi, e në këtë rast mbase mund të ketë aludime edhe për vuajtjet që po i përjetonte i Dërguari i Allahut nga idhujtarët kurejshë, sepse ata në këtë mënyrë duke e shqetësuar të Dërguarin a.s., njëkohësisht e kishin përdhosur edhe shenjtërinë e Shtëpisë së Shenjtë, kur secili njeri duhet të ndjehej i sigurt në të.[21]

**Porosia e ajeteve (1-4)**

- *Allahu i Madhërishëm është betuar në Mekën fisnike, duke e vërtetuar edhe njëherë shenjtërinë e këtij vendi të bekuar, në të cilin ka lindur më fisniku i krejt njeëzimit, Muhamedi a.s..*
- *Pastaj është betuar në Ademin dhe lozën e tij, që nënkupton çdo prind dhe çdo të lindur (fëmijë) deri në Ditën e Gjykimit, se vërtet, njeriu, si krijesa më e privilegjuar nga i Lartmadhërishmi, u krijua për të përjetuar sprova dhe vështirësi të njëpasnjëshme në këtë botë. Ky është ligj i jetës, dhe i gjithë njerëzimi do t'i nënshtrohet sprovave të ndryshme, në shëndet, në pasuri, në fe e në çdo gjë tjetër.*

---

[20] Dr. Mish'al Abdulaziz el Felahi, *Rihletu tedebburi - xhuz'u Amme*, Kajro, 2016, f. 166.

[21] *Hadaik-r-rrevhi ve-r-rrejhan*, vëll. 32, f. 12.

## Sprova e njeriut dhe mburrja e tij me pasuri

**“A mendon ai se askush nuk ka pushtet mbi të? Ai thotë** (me mburrje): **“Unë kam shpenzuar shumë pasuri!” Vallë, a mendon ai se nuk e ka parë askush? A nuk i dhamë Ne atij dy sy, edhe gjuhë, e dy buzë, dhe ia kemi bërë të qarta të dyja rrugët?”** - (El-Beled, 5-10).

***

### Shkaku i zbritjes së ajetit (5)

Ashti siç e përmendëm në fillim të sures, disa studiues të shkaqeve të zbritjes, mendojnë se ajeti i 5-të i kësaj sureje ka zbritur për Ebil Eshed Usejd ibën Keledete el Xhumehij, i cili mburrej së tepërmi me pamjen dhe forcën e tij fizike. Transmeton Ibën Abasi të ketë thënë: “Ebul Esheddi thoshte haptazi: “Kam shpenzuar shumë pasuri në armiqësinë ndaj Muhamedit”, ndonëse pretendimet e tij ishin të rrejshme.”.[22]

### Shkaku i zbritjes së ajetit (6)

Si shkak i zbritjes së ajetit të 6-të, transmetohet nga Mukatili të ketë thënë: “Ky ajet ka zbritur për Harith ibën Amir ibën Nevfel, i cili kishte mëkatuar dhe kishte kërkuar nga i Dërguari i Allahut që ta mësonte se si t’i shpaguante mëkatet

---

[22] *Et-Tefsiru-l Munir*, vëll. 30, f. 628.

e tij, ndërsa i Dërguari i Allahut e kishte urdhëruar që të paguante kefaret si shpagim. Më vonë, ai në formë talljeje e përqeshjeje thoshte: "Më shkoi pasuria në kefarete-shpagime, që prej se hyra në fenë e Muhamedit."[23]

**Koment:**

**5. A mendon ai se askush nuk ka pushtet mbi të?**

Njeriu nga natyra e tij, meqë është i lirë në veprime, e ka në vetvete një dozë të konsiderueshme të mburrjes dhe vetëpëlqimit. Ky ves, nganjëherë fryhet edhe më shumë nga shejtani i mallkuar, i cili në këtë mënyrë e vë në lajthitje njeriun, duke e cytur e nxitur në mosbesim, mosmirënjohje dhe mospërfillje ndaj Zotit-Krijuesit të vet, dhe kështu merr përmasa dhe dimensione vërtet shqetësuese.

Pasuria dhe pushteti janë ndër sprovat më të mëdha me të cilat mund të goditet njeriun. Shumë prej njerëzve mbase edhe nuk janë të vetëdijshëm për këtë tundim nga pasuria dhe pushteti, ndonëse nga historia kemi mësuar për fatin tragjik të shumë prej këtyre të pasurve dhe pushtetarëve, të cilët kishin rënë pre e këtij tundimi djallëzor, por a thua, ku mbeti tërë ajo pasuri e tyre?! Jo që nuk iu ndihmoi, përkundrazi u bë shkak që njerëzit t'iu vërsuleshin atyre për t'i zhdukur edhe fizikisht, vetëm e vetëm që t'ua grabisnin e ta përvetësonin atë pasuri. Këta pushtetarë dhe njerëz të pasur, si në të kaluarën, ashtu edhe tash, mendojnë se për shkak të pasurisë dhe pushtetit të tyre absolut që kanë në tokë, askush nuk ka pushtet mbi ta, duke harruar se Krijuesi Fuqiplotë është ai që

---

[23] *Hadaik-r-rrevhi ve-r-rrejhan,* vëll. 32, f. 8.

na mbikëqyr në çdo çast. Këta njerëz të dobët, nuk e kuptojnë se ata nuk e kanë në dorë as jetën e madje as edhe frymëmarrjen e tyre, që është dhuratë nga Zoti.

**6. Ai thotë** (me mburrje): **"Unë kam shpenzuar shumë pasuri!"**

Ndonëse sipas shkakut të zbritjes pamë tek flitej se ky ajet ka zbritur për Harith ibën Amrin, megjithatë kuptimi i këtij ajeti është gjithëpërfshirës dhe nënkupton të gjithë ata arrogantë e mburravecë me pasuri, të cilët krenohen para të tjerëve me atë që posedojnë. Vetë fjala e përdorur në këtë ajet *"ehlektu",* që vjen prej rrënjës *"heleke",* e që do të thotë *"shkatërrim",* jep shenjë se kjo pasuri e tyre do të jetë shkak që ata ta humbin përgjithmonë Ahiretin. Në botën tjetër, nuk bëjnë punë as pasuria e as fëmijët, përveç atij që del para Allahut me zemër të pastër, pra me vepra të mia dhe pa asnjë grimë mendjemadhësie në shpirt.

Gjithsesi janë të mjerë ata që shpenzuan pasuri dhe energji duke kundërshtuar e luftuar fenë e Allahut, e duke u zhytur në kufër dhe në mëkate.[24] Kjo pasuri e shpenzuar nuk do t'u bëjë aspak dobi për botën tjetër, sepse atje do të jenë vërtet të përbuzur e të poshtëruar në greminat e Xhehenemit.

**7. Vallë, a mendon ai se nuk e ka parë askush?**

Nga ky ajet kuptojmë se njeriu në çdo çast është nën mbikëqyrjen e Allahut. Asgjë nga jeta dhe veprimet e njeriut nuk

[24] Dr. Abdulmelik el Kasim, *Tefsiru-l Kurani-l Adhim - Xhuzu Amme,* f. 118. (Pa vend dhe vit botimi).

mbeten pa u regjistruar tek i Gjithëdijshmi, i Cili është i njoftuar për çdo gjë.[25] Njeriu mbase edhe harron se në të djathtën dhe të majtën e tij i ka dy engjëj fisnikë, të cilët shkruajnë pandërprerë veprat dhe fjalët e tij gjatë jetës në këtë botë, andaj nesër, kur të dalë para të Madhit Zot, ai që ka kundërshtuar urdhrat e Allahut në këtë botë, do të mundohet të arsyetohet se nuk e ka bërë këtë ose atë veprim. Por, secili prej këtyre njerëzve do të shtanget nga habia, kur kundër tij do të dëshmojnë pikërisht gjymtyrët e tij siç janë syri, gjuha, dora, këmba etj.. Prandaj, askush të mos mendojë se Allahu nuk e di se çfarë veprojmë në këtë botë, përkundrazi, kur të vihen peshojat e drejtësisë hyjnore, secili do t'i shikojë veprat e tij, të mirat dhe të këqijat. Atë ditë askujt nuk i bëhet e padrejtë as sa një grimë.

**8. A nuk i dhamë Ne atij dy sy,**

**9. edhe gjuhë, e dy buzë,**

Allahu xh.sh. në këto ajete i drejtohet krijesës njeri, natyrisht, pyetja qortuese në këtë rast iu drejtohet mohuesve dhe jobesimtarëve, duke ua rikujtuar të gjitha dhuntitë dhe mirësitë që ua ka dhuruar, duke ia dhënë sundimin e kësaj bote, në të cilën ia nënshtroi gjithçka. Por, sërish, nga raca njerëzore dalin mohues të tillë, të cilët pasojnë intrigat e shejtanit. Prandaj Allahu thotë: *"A nuk i dhamë Ne atij (njeriut) dy sy",* me të cilët sheh, dhe shijon bukuritë e kësaj bote, por njëkohësisht nëpërmjet shikimit e sheh botën përreth tij dhe i shfrytëzon nimetet e Krijuesit. Vallë, si mund të jenë njerëzit

---

[25] Adil Muhamed Halil, *Evvelu merretin etedebburu-l Kurane*, botimi i 13-të, Kuvajt, 2017, f. 297.

mohues të Zotit, kur vetëm sytë dhe shikimi nëpërmjet tyre është mirësi që s'mund të krahasohet ndoshta me asnjë mirësi tjetër. Përveç kësaj, njeriun e përsosi në krijim, i dhuroi gjuhën dhe buzët, nëpërmjet të cilave organe qeniet njerëzore artikulojmë tingujt dhe fjalët, shijojnë shijet e ndryshme të ushqimeve dhe të pijeve.

Arsyeja pse Allahu ia përmend njeriut se i ka dhënë sy, gjuhë dhe buzë, është që t'ia sjell atij ndërmend se vetëm Allahu është i Plotfuqishëm që t'i dhurojë dikujt shikimin dhe mundësinë e të folurit.

**10. dhe ia kemi bërë të qarta të dyja rrugët?**

Pasi që i Lrtmadhërishmi sqaroi se si e nderoi dhe fisnikëroi njeriun, duke i dhuruar sytë me të cilët e vrojton botën përreth, duke u kënaqur me shikimin e bukurive që Allahu i krijoi në Tokë dhe në qiej, duke i dhuruar edhe gjuhën si një organ që shërben për të folur dhe buzët për të qenë zbukurim i përsosur për fytyrën e njeriut, tash në këtë ajet flet se njeriut ia bëri të qartë dy rrugë. Rrugën e së mirës dhe rrugën e së keqes, rrugën e udhëzimit dhe rrugën e humbëtirës. Ibën Mesudi dhe Muxhahidi, këto dy rrugë i kanë komentuar si rruga e së mirës dhe rruga e së keqes, kurse Ibën Abasi e ka sqaruar si rruga e udhëzimit dhe rruga e humbëtirës.[26]

Pra, njeriu para vetës i ka dy rrugë, dhe vetëm një mundësi për të zgjedhur. Ose të besojë Allahun dhe të përpiqet që këtë besim të tij të pastër ta mbajë dhe ta mbrojë, përkundër

[26] Dr. Ahmed Mahir Seid Nasr, *Tefsir sureti-l Beled*, Medinetu-s-Sadat, Egjipt, pa vit botimi, f. 310,

vështirësive dhe sprovave me të cilat mund të ballafaqohet, sepse nga vetë historia kuptojmë se besimtarët e Njëshmërisë, gjithmonë kanë qenë shënjestër e fyerjeve, persekutimeve e madje edhe vrasjeve më makabre.

Në anën tjetër, është rruga e kufrit, e cila po ashtu e zhyt njeriun në llumin e mëkateve, dhe jeta e tij, pavarësisht kënaqësive të përkohshme, shndërrohet në ferr të vërtetë. Ai njeri, nuk ka më identitet, sepse jeton i përhumbur nëpër labirintet e kufrit, nga e cila vështirë se mund të dalë vetë, pa ndihmën dhe udhëzimin e Allahut Fuqiplotë.

**Porosia e ajeteve (5-10):**

- *Në këto ajete shohim qortimin hyjnor për njeriun, të cilit i dha shumë të mira, ia dha sytë që të shohë me ta, gjuhën dhe buzët me të cilat gjymtyrë flet, por edhe përkundër kësaj, njeriu është mosmirënjohës, sepse me mburrje thotë se askush nuk mund të ketë pushtet mbi të, duke u mburrur me shpenzim të pasurisë etj..*

# Sprovat e kësaj bote, rrugëtim drejt shpëtimit në Ahiret

**"Atëherë, përse nuk u përpoq ta kapërcente "rrugën e vështirë"! E ku e di ti se ç'është "rruga e vështirë"? Ajo është lirimi i një skllavi ose dhënia e ushqimit në kohën kur mbretëron uria: ndonjë jetimi që është i afërt ose ndonjë të varfëri të cilin e ka dëshpëruar varfëria." -** (El-Beled, 11-16).

***

**Koment:**

**11. Atëherë, përse nuk u përpoq ta kapërcente "rrugën e vështirë"!!**

**12. E ku e di ti se ç'është "rruga e vështirë"?**

Ky ajet, fillon me një pyetje për secilin njeri, të cilit Allahu i dha sy, gjuhë, buzë dhe intelekt, duke e lënë të lirë në vepra, që të zgjedhë nga vetë natyrshmëria e tij rrugën e drejtë të besimit, se a thua përse nuk e kapërceu vetë atë *"rrugë dhe përpjetës"* të vështirë. Dihet se njeriu vetë e ka në dorë, ta zgjedhë rrugën drejt Allahut, duke qenë i vetëdijshëm se kjo rrugë kërkon sakrifica të mëdha, sepse shejtani i mallkuar vazhdimisht i rri në pritë me intrigat dhe joshjet e tij, që ta largojë nga besimi dhe rruga e drejtë. Ruana Zot, ka edhe të tillë që me vullnetin e tyre e zgjedhin rrugën e gabuar të mëkatimit e të mosbesimit, duke menduar se jeta e tyre është vetëm në këtë dynja, duke qenë të bindur se nuk ka ringjallje e as jetë pas vdekjes.

Fjala *"akabe"* e përdorur në këtë ajet, gjuhësisht nënkupton majën e një kodre, kurse në aspektin terminologjik, nënkupton vështirësitë me të cilat ballafaqohet besimtari gjatë jetës së tij, i cili për ta arritur kënaqësinë e Allahut, i duhet të kalojë sprova dhe sfida të ndryshme, sepse vetë koncepti i jetës në këtë botë, është mishërim i një rruge të vështirë, pas së cilës, pason shpërblimi me Xhenet.

E përmendëm në ajetin paraprak, se në këtë sure kemi të bëjmë me përmendje të emërtimeve të vendeve, e po ashtu edhe fjala *"akabe"*, nënkupton vend, apo majën e një kodre, sepse vetë konteksti i sures është i tillë. Këtë element, do ta hasim edhe pak më vonë tek komentimi i ajeteve 17-20. Por se çfarë në të vërtetë nënkupton fjala *"akabe"*, përgjigjen e kemi në ajetet vijuese.

**13. Ajo është lirimi i një skllavi**

E para prej këtyre veprave të mira e të përshpirtshme, të cilat na afrojnë deri te kënaqësia e Allahut, është lirimi i një skllavi nga robëria. Nga historia e lavdishme islame, shohim se në shumë raste, shpagimi për mos përmbushjen e një detyrimi fetar është lidhur me lirimin e një skllavi, duke nxitur kështu që njerëzit të lirohen dhe të ndjehen të barabartë me të tjerët. Prandaj, sahabët e mëdhenj, sidomos ata që ishin më të pasur, siç ishte rasti i Ebu Bekrit dhe të tjerët, garonin në mes vete se cili po lironte më shumë robër. Natyrisht, Ebu Bekrit nuk mund t'i afrohej askush në këtë zemërgjerësi.

**14. ose dhënia e ushqimit në kohën kur mbretëron uria:**

Në shumë vende të botës, sidomos në të kaluarën, nuk kishte një mirëqenie dhe bollëk për të gjithë, sidomos në vendet e Lindjes së Afërt dhe të Mesme. Atje edhe kushtet klimatike, pamundësonin zhvillimin e kulturave bujqësore, prandaj edhe në shumë prej këtyre vendeve ndjehej varfëria, madje diku-diku edhe ekstreme. Prandaj, Allahu i Madhërishëm nxit njerëzit e pasur që të ushqejnë popullatën në kohën kur një vend e kaplon uria, fjala vjen në rast të luftërave, epidemive të ndryshme etj..

**15. ndonjë jetimi që është i afërt**

Feja jonë e pastër islame, i ka kushtuar aq shumë kujdes jetimit si kategori sociale, saqë në Kuran fjala jetim është përdorur në 23 ajete. Prej tyre 8 herë është përmendur në trajtën e njëjësit, 1 herë në trajtën e dyjësisë dhe 14 herë në trajtën e shumësit.[27] Në të gjitha këto ajete kuranore, i Madhërishmi na nxit që të kemi kujdes ndaj jetimëve, sidomos nëse në mesin e familjes dhe farefisit tonë kemi ndonjë të tillë, atëherë kujdesi ndaj tyre duhet të jetë edhe më i madh. Fjala *"jetim"* në aspektin terminologjik, nënkupton fëmijën të cilit i ka vdekur babai, dhe legjislacioni islam e quan me këtë term derisa ky fëmijë ta arrijë pjekurinë – "bulug".[28]

Ata jetimë që Allahu i Madhërishëm i sprovoi në këtë dynja me humbjen e prindërve, tek ne duhet ta gjejnë ngrohtësi-

---

[27] Grup autorësh, Mevsuatu-t-tefsir el mevdui lil Kurani-l Kerim, Rijad, 2019, ff. 366-367.

[28] Ibën Mendhur, *Lisanu-l arab*, 12/645.

në e folesë prindërore, derisa të rriten e të bëhen të zotët e vetes. Bamirësia dhe sjellja e mirë ndaj jetimëve, është një prej urdhëresave më të rrepta hyjnore, të cilës secili duhet t’i kushtojë kujdes sidomos ata që janë kujdestarë të ndonjë jetimi. Ja disa prej këtyre ajeteve që nxisin në këtë mirësjellje ndaj tyre: ***“Silluni mirë ndaj prindërve, ndaj të afërmve, ndaj jetimëve...”*** - *(En-Nisa’ë, 36).*

Po ashtu, në Kuran hasim edhe kërcënime hyjnore për ata që e keqpërdorin pasurinë e jetimit: ***“Ata që e hanë pa të drejtë pasurinë e jetimëve, në të vërtetë ata hanë atë që mbush barkun e tyre zjarr dhe do të futen në zjarrin e Xhehenemit.”*** - *(En-Nisa’ë, 10),* etj. Ndërkohë, përveç këtyre ajeteve, disa prej të cilëve i përmendëm sa për të qartësuar se çfarë kujdesi duhet të tregojë familja, farefisi, po edhe mbarë shoqëria për jetimin, kemi po ashtu edhe shumë hadithe nga Pejgamberi a.s., i cili edhe vetë u rrit jetim pa të dy prindërit. Ai në hadithet e tij nxit për mirësjellje ndaj jetimëve, si fjala vjen në këtë: *“Unë dhe kujdestari i jetimit do të jemi së bashku në Xhenet kështu”,* duke aluduar me gishtin tregues dhe të mesëm dhe i ndau në mes[29] etj..

**16. ose ndonjë të varfëri të cilin e ka dëshpëruar varfëria.**

I Madhërishmi në këtë ajet, nxit që të ushqehen të varfrit në nevojë, të cilët nuk kanë pasuri, por janë të shtrënguar që nga vështirësitë dhe sprovat e jetës, të shtrijnë dorën për lëmoshë. Fjala *“miskin”* në terminologjinë gjuhësore të arabi-

---

[29] Buhariu, (4892) dhe Tirmidhiu, (1841).

shtes nënkupton njeriun e varfër, i cili nuk posedon pothuajse asgjë nga pasuria, madje as shtëpi, por jeta e tij është bredhja rrugëve dhe fjetja në dhe të Tokës, të cilën gjendje e përshkruan edhe vetë termi i përdorur në këtë ajete: *"dha metrebetin" - "njeri të ngjitur për pluhuri-dheu"*[30]. Ndoshta këtij termi në gjuhën shqipe do t'i përshtatej fjala "njeri i mjerë, ia pa plëng" etj.. Ndërsa me fjalën *"fekir"* nënkuptojmë dikë që të paktën ka diçka nga pasuria, së paku një kulm mbi kokë, ku të strehohet, por pa pasuri për ta marrë veten.

Sidoqoftë, Allahu i Madhërishëm nxit që të ushqehet edhe ky lloj varfanjaku, shtroja e të cilit është dheu, dhe i cili nuk ka asnjë grimë pasurie. Ai është një i pashpresë, i pa krah, andaj, ai që e ndihmon të tillin vetëm për hir të Allahut dhe nxiton t'ia zbusë vuajtjet dhe urinë e tij, i tilli do të jetë në grupin e atyre njerëzve që e kanë kuptuar siç duhet rrugën "e vështirë" deri te kënaqësia e Allahut.

**Porosia e ajeteve (11-16)**

- *Rruga e imanit është rrugë e vështirë, sepse në çdo cep të saj, njeriu ballafaqohet me kurthet e shejtanit të mallkuar. Por, megjithatë, pas çdo vështirësie, vjen lehtësimi dhe shpërblimi.*
- *Për ta arritur kënaqësinë e Allahut, njeriu duhet së pari të jetë falënderues ndaj Zotit për të gjitha mirësitë dhe nimetet e Tij ndaj nesh. E në sferën e këtyre mirësive të përmendura në këto ajete është lirimi i një skllavi nga*

[30] Ahmed bin Jusuf, i njohur si Es Semin el Halebi, *E-Durru-l mesun fi ulumi-l Kitabi-l meknun*, Medinë, 1406 h., vëll. XI, f. 10,

*robëria, për ç'gjë, Islami ka thirrur që në fillet e tij, pastaj ushqimi i njerëzve kur një vend e pllakos uri e përgjithshme, ose ushqimi i një jetimi me të cilin të lidh lidhja farefisnore, ose kujdesi dhe ushqimi i ndonjë të varfri, të cilin e kanë rënduar e mundur hallet e jetës, sepse i tilli vërtet është i mjerë e i pa krahë.*

## Grupi i shpëtuar dhe grupi i humbur

**"Veç kësaj, të jetë nga ata që besojnë, që e këshillojnë njëri-tjetrin për durim dhe këshillojnë për mëshirë. Këta janë të anës së djathtë. Ndërsa ata që i mohojnë argumentet Tona, janë të së majtës. Mbi ta do të jetë një Zjarr i mbyllur** (përvëlues)". - (El-Beled, 17-20)

***

**Koment:**

**17. Veç kësaj, të jetë nga ata që besojnë, që e këshillojnë njëri-tjetrin për durim dhe këshillojnë për mëshirë.**

Të gjitha mirësitë e cekura në ajetet paraprake, lirimi i një skllavi nga robëria, duke e bërë këtë vetëm për hir të arritjes së kënaqësisë së Allahut, pastaj ushqimi i njerëzve kur një vend e pllakos uria e përgjithshme, kujdesi ndaj një jetimi, të cilin e ke në amanet, derisa ai të bëhet i zoti i vetes, si dhe ushqimi i njerëzve të varfër, të cilët janë të mjerë dhe të pastrehë, dhe nuk kanë mundësi ta mbajnë vetveten, nuk do të kenë vlerë nesër në peshojën e Allahut, nëse këtyre nuk u paraprin besimi i pastër në Krijuesin Fuqiplotë. Pra besimi në Njëshmërinë e Krijuesit, është çelësi i çdo pune që të shpie te

kënaqësia e Allahut, sepse besimtarët e vërtetë, nuk janë egoistë e as mburravecë. Ata e këshillojnë njëri-tjetrin për durim dhe për mëshirë, duke qenë të vetëdijshëm se kjo është rruga e vetme, e cila garanton kënaqësinë e Mëshirëplotit dhe shpërblimin me Xhenet. Në këtë ajet është përmendur këshillimi për durim, kur ata i godet ndonjë sprovë, ashtu siç ka ardhur edhe në ajetet 2-3 të sures *El-Asr*, ku i Lartmadhërishmi thotë: ***"Përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, këshillojnë njëri-tjetrin për të vërtetën dhe këshillojnë njëri-tjetrin për durim."***

Të jesh i durueshëm në sprova dhe i mëshirshëm në raport me të tjerët, kjo të bën njeri të kompletuar, sepse krahas durimit, mëshira dhe dhembshuria ndaj të tjerëve, ta zbut zemrën, e ai që e ka zemrën e butë dhe plot ndjeshmëri, sigurisht se do të jetë i pari që do ta ndihmojë një jetim, a ndonjë të varfër, që ka nevojë për ndihmë dhe tejkalim të gjendjes së rënduar nga hallet e jetës.

Përveç shumë ajeteve që flasin rreth kësaj tematike, po ashtu edhe i Dërguari i Allahut ka folur për ata besimtarë që janë të mëshirshëm mes vete kur thotë: *"Të mëshirshmit, i ka mëshiruar i Gjithëmëshirshmi. Mëshironi ata që janë në Tokë, që t'ju mëshirojë Ai që është në Qiell."*[31]

**18. Këta janë të anës së djathtë.**

Pikërisht, këta besimtarë me të tilla cilësi e përshkrime, janë fatlumët në Ditën e Gjykimit, sepse libri i veprave të ty-

[31] E transmetojnë nga Abdullah ibën Umeri r.a. Ebu Davudi, (4941); Tirmidhiu (1924) dhe Imam Ahmedi (6494).

re iu vjen nga ana e djathtë ose para, dhe shpërblimi i tyre meritorë është Xheneti. Një përshkrim madhështor për besimtarët e së djathtës e hasim te surja *El-Vakiatu*, në ajetet (27-34): ***"Po njerëzit e së djathtës? E kush janë të djathtët vallë? Ata qëndrojnë mes lotusëve, pa gjemba, dhe bananeve me fruta palë-palë, nën hije të gjera, pranë ujit që rrjedh, mes frutave të llojllojshme, që as nuk mbarohen, e as nuk janë të ndaluara, dhe qëndrojnë në shtretër të lartë...".***

**19. Ndërsa ata që i mohojnë argumentet Tona, janë të së majtës.**

**20. Mbi ta do të jetë një Zjarr i mbyllur** (përvëlues).

Mohimi i argumenteve të Allahut, pa dyshim që është prej llojeve më të këqija të mohimit-kufrit, sepse argumentet hyjnore janë të qarta, sikur drita, që nuk mund të mohohet se është dritë dhe ndriçuese. Këta janë ata ta mjerët, fatkeqit, që do të jenë përjetësisht të privuar nga Drita e Zotit, sepse përveç mohimit të Njëshmërisë, ata ishin zhytur në greminat e çdo të keqeje e ligësie, andaj edhe do të jenë në grupin e atyre që do të ndëshkohen me zjarr për shkak të kufrit të tyre. Ky grup është quajtur me emërtimin *"ashabul mesh'emeti"* dhe *"ashabu-sh-shimali",* dhe nënkupton njerëzit e vrazhdë dhe arrogantë në mosbesimin e tyre, mohues ndaj dhuntive të Zotit Fuqiplotë dhe mohues të ringjalljes e të Ahiretit. Këtyre, libri i veprave të tyre do t'u vijë nga ana e majtë ose nga prapa, dhe do ta mallkojnë vetveten për shkak të kufrit të tyre në këtë dynja. Këta në Ahiret do të jenë në grupin e të humburve e të të shkatërruarve, andaj edhe ajeti i fundit i kësaj sureje, vjen si vulosës i fatit të tyre, për të cilin edhe punuan në këtë botë, duke pasuar epshet dhe egot e tyre të sëmura.

Dhe, si rezultat i këtyre ligësive dhe i mohimit të tyre, zjarri i Xhehenemit do t'i përcëllojë pafundësisht dhe përjetësisht. Dënimi dhe ndëshkimi i tyre do të jenë i tmerrshëm, sepse do të jenë në greminat e Xhehenemit, në një zjarr të mbyllur. Në lidhje me këtë vendqëndrim të tyre, i Madhërishmi thotë: ***"Po njerëzit e së majtës? E kush janë ata të majtit se?! Ata janë në frymën përvëlues të zjarrit dhe ujit të valë, e në errësirën blozë të tymit, as të freskët e as të këndshëm".*** - *(El-Vakiatu, 41-44).*

Për ta nuk ka shpresë nga asnjë anë, dhe nuk shohin asgjë përveç zjarrit, i cili i mbulon nga të gjitha anët, duke i përpirë e djegur me flakët përcëlluese të tij.

**Porosia e këtyre ajeteve:**

- *Në botën tjetër, njerëzimi do të jenë të ndarë në dy grupe, në të shpëtuarit, të cilët simbolizojnë anën e djathtë, nga e cila u vjen regjistri i veprave të tyre, dhe të cilët do të jenë nën hijen e mëshirës së Allahut, dhe grupi i humbur, të cilët simbolizojnë anën e majtë, nga e cila anë edhe do t'u vjen regjistri i veprave të tyre.*
- *Të djathtët, të cilët ishin vepërmirë, të mirësjellshëm në raport me të varfrit, jetimët dhe të ngratët, e të cilët besimin e tyre e zbukuruan duke u këshilluar mes vete me durim dhe mëshirë, këta do të jenë banorë të Xhenetit, duke shijuar mirësitë e Krijuesit të tyre.*
- *Të majtët, të cilët jetuan jetën e tyre si të shfrenuar, duke mos besuar në Zotin Fuqiplotë, këta do të jenë banorë të Skëterrës, mbi të cilët përjetësisht do të jetë i ndezur një zjarr përcëllues, i mbyllur nga çdo anë, nga i cili nuk mund të shpëtojnë kurrë.*

**Dr. Ajni SINANI**

# TRI STILE TË NDRYSHME - KURANI, HADITHI KUDSIJ DHE HADITHI PEJGAMBERIK

Secili njeri ka një stil të veçantë të të folurit dhe të të shkruarit. Nëse lexojmë vazhdimisht një autor, do ta dallojmë dhe kuptojmë stilin e tij të të shkruarit sapo që t'i lexojmë fjalët e tij, pa e ditur se ai është autori. Muhamedi a.s. na erdhi me diçka të pamundur, solli tri stile të të shkruarit, dhe secili prej këtyre tri stileve ka një karakter që dallohet letrarisht dhe retorikisht nga stili tjetër. Prandaj, Muhamedi a.s., po të mos ishte Pejgamber dhe i Dërguar i Zotit, nuk do të mund të sillte Kuranin, hadithin kudsij dhe hadithin pejgamberik. Ai s'do t'ia dilte as edhe të fliste në mënyrë shumë koncize dhe jashtëzakonisht elokuente. Madje, nuk dihet një person në historinë njerëzore që ka sjellë tri stile letrare, dhe se secili stil të dallohet nga tjetri, sikurse ndodhi me Muhamedin a.s..

Çudia bëhet edhe më e madhe kur dihet se Muhamedi a.s. nuk dinte shkrim e lexim dhe nuk ishte i njohur për poezi a retorikë. Gjëja më e mahnitshme është se gjuhëtarët dhe oratorët më të rrjedhshëm arabë në kohën e tij, apo edhe më vonë, deri në ditët tona, nuk ia dolën të sjellin ndonjë gjë të ngjashme apo të afërt me atë që solli ai. Tri stilet që i solli

Muhamedi a.s. janë: **Kurani, hadithi kudsij dhe hadithi pejgamberik.** Ato janë dëshmi se ato nuk ishin prej tij, por prej Zotit të Madhëruar. Le t'i shqyrtojmë këto tri stile të nivele të ndryshme një nga një!

## Kurani - stili i veçantë dhe paimitueshmëria e tij

Kurani është fjalë e Allahut. Edhe shprehja, por edhe kuptimi i Kuranit janë prej Allahut. Kurani si i tërë, germë për germe dhe fjalë për fjale, i është shpallur Muhamedit a.s. nga Allahu xh.sh., nëpërmjet të besueshmit, Xhibrilit a.s.. Është shkruar në mushafë dhe është transmetuar në mënyrën më të besueshme (tevatur) deri te ne. Xhibrili a.s. dhe Muhamedi a.s. vetëm kanë transmetuar fjalën e Zotit, ashtu sikurse e kishin pranuar pa kurrfarë ndërhyrje prej tyre.[1]

Kurani u transmetua nga gjenerata në gjeneratë. Ai është një libër që fillon me suren (kaptinën) *El Fatiha* dhe mbaron me suren *En Nas*, leximi (këndimi) i të cilit vlerësohet si një ibadet (adhurim fetar) shumë i virtytshëm.[2] I gjithë informacioni në të ka origjinë hyjnore. Kurani ka ekzistuar dhe ka qenë kompletuar para krijimit të Muhamedit a.s.. Ai nuk përmban asnjë prej fjalëve apo porosive të tij. Një përfshirje e

[1] Kurani, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, përktheu dhe komentoi H. Sherif Ahmeti, shih komentin në f.10.

[2] Kurani famëlartë, libri i fesë islame: https://www.trt.net.tr/shqip/jeta-dhe-shendeti/2016/03/18/kurani-famelarte-libri-i-fese-islame-453405

fjalëve të Muhamedit a.s. brenda Kuranit, do ta kundërshtonte dhe do ta komprometonte atë si një libër i Zotit.[3]

Kurani është libër me karakter mbinatyror dhe metahistorik e tejepokal. Ai është përshkrim i tekstit që është skalitur në Pllakën Qiellore (Tabula Secreta). Në tërësi, është fjalë e Zotit dhe nuk është tregim i dorës së dytë dhe as fryt i mendjes njerëzore. Kurani nuk ngjason me asnjë libër tjetër. Fjala Kuran do të thotë recitim apo përsëritje. Kurani është Libër i Zotit, par excellence.[4]

Kurani ka stilin e tij, strukturën dhe mënyrën e të shprehurit të qartë. Gjuha dhe shkrimi i tij janë të ndryshme nga gjuha dhe shkrimi i hadithit. Është fakt se gjuha kuranore nuk është kopjuar dhe as që mund të sfidohet e të imitohet nga ndonjë qenie njerëzore. Nuk ka krahasim të gjuhës së Kuranit më gjuhën e zakonshme, apo madje edhe me gjuhën e folur nga Pejgamberi a.s. në jetën e tij të përditshme. Për këtë arsye, studiuesit e Kuranit e përshkruajnë cilësinë e Kuranit si paimitueshmëri të tij.[5]

Dijetari Dibag, në librin e tij *"El Ibriz"* ka thënë se: "Çdokush që e dëgjon Kuranin dhe e njeh në thellësi domethënien e tij, pa dyshim që do ta kuptojë se Kurani është të folurit e Zotit, ndërsa madhështia që gjendet në të dhe autori-

---

[3] Gary Miller, *Kurani i mrekullueshëm* (2), Dituria Islame, Revistë mujore fetare, shkencore e kulturore, numër 368/369, viti 35, korrik-gusht, Prishtinë, 2021, Dhul Hixhxhe-Muharrem, 1442/1443, f. 21.

[4] Ziauddin Sardar, *Fytyra të Islamit, biseda për probleme bashkëkohore*, (Profesor Kemal Hasan, Kitab-i në intervistë me Ziauddin Sardar), Logos A, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2017, f. 46.

[5] Po aty, f. 47.

teti që ndërtohet brenda tij, reflekton Lartmadhërinë dhe Autoritetin e Zotit.”[6]

***“Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi*** *(çdo gjë).” (El Alak, 1).* Ky ajet kuranor depërton thellë në zemrën e njeriut, duke ia bërë me dije se ligjëron më i Larti, i Cili ka autoritetin e pacenueshëm në fuqinë dhe madhështinë e fjalëve të Tij.[7]

Nuk ka asnjë diskutim ndërmjet myslimanëve dhe jomyslimanëve, mbi autencitetin e Kuranit, pra kjo është si të thuash se askush nuk e ka vënë në dyshim kurrë pastërtinë e Kuranit. Edhe pse Kurani është fjalë e pa konkurrencë e Allahut, pjesa më madhe e orientalistëve dhe studiuesve perëndimorë besojnë se Muhamedi është autor i Kuranit. Kjo është diçka plotësisht e pabazuar dhe mund të hidhet poshtë shumë lehtë, në veçanti kur njeriu studion historinë e përpilimit të tekstit, e cila është e dokumentuar, dhe e krahason atë me hadithin.[8]

Nëse kësaj ia shtojmë edhe faktin se Muhamedi a.s. nuk dinte shkrim-lexim dhe as që ka mësuar në shkollë, nuk ka rënë në kontakt me civilizime të tjera, sepse nuk kishte dalë jashtë Siujdhesës Arabe, atëherë bie poshtë mundësia e çfarëdo dyshimi.[9]

---

[6] Dr. Mustafa Mahmud, *Njihe Lajmëtarin*, botoi: Sira Prishtinë, 2018, f.146.

[7] Po aty, f. 146.

[8] Ziauddin Sardar, *Fytyra të Islamit, biseda për probleme bashkëkohore*, (Profesor Kemal Hasan, Kitab-i në intervistë me Ziauddin Sardar), op. cit., f. 48.

[9] Mustafa Mahmud, *Dialogu me mikun ateist*, (Pse të mos jetë Kurani vepër e Muhamedit a.s.), Sira, 2018, Prishtinë, f. 141.

## Kurani - mrekulli mendore

Kurani është mrekulli mendore, jo sikurse mrekullitë e tjera vetëm shqisore. Mrekullitë e pejgamberëve të tjerë ishin shqisore, vepër nga veprat e Zotit, e mrekullia shqisore mund të pushojë, kur Allahu e kryen atë vepër dhe ajo mund të përjetohet vetëm nga ata që janë dëshmitarë të saj kur ajo ndodh. Është mrekulli mendore sepse, mendjet e njerëzve, sado që të arrijnë të zbulojnë çështje e ligje në natyrë, do të shohin se Kurani i ka përmendur ato shumë më herët. Si e tillë mrekullia e tij është aktuale në çdo kohë dhe mund të përjetohet nga gjenerata në gjeneratë.[10]

## Bukuria gjuhësore dhe përmbajtjesore e Kuranit

Kurani sipas formës, shprehjeve, shkronjave, përmbajtjes, bukurisë së të shprehurit, saktësisë së gjuhës, paraqet diç të pamundur për kapacitetet dhe mundësitë njerëzore.[11] Kurani u shpall në gjuhën arabe dhe arabët e admironin bukurinë gjuhësore, por ai, apo ajetet e tij nuk u përputhën plotësisht me normat e poezisë arabe. Ai ishte poetik, por ishte krejtësisht i ri. Kurani nuk është as prozë, e as prozë e thjeshtë, ndonëse në ajetet prozaike njeriu gjithmonë mund të diktojë

[10] Kurani, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, përktheu dhe komentoi H. Sherif Ahmeti, shih komentin në f. 14-15.

[11] Mustafa Mahmud, *Dialogu me mikun ateist,* (Pse të mos jetë Kurani vepër e Muhamedit a.s.), op. cit., f. 86.

bukurinë poetike. Ai është një kombinim i bukurisë në poezi dhe në prozë.[12]

Çështja tjetër që dallohet është përmbajtja e Kuranit, vetë mesazhi i tij. Thellësia e ideve në Kuran, krahasuar me përmbajtjet e hadithit, është e qartë, dhe si rrjedhim është e pabesueshme që Pejgamberi a.s. të jetë autor i një libri të tillë.[13]

## Mrekulli gjuhësore me origjinë hyjnore

Kurani ka gjuhë unike, të përkryer e të pakrahasueshme, stili, elokuencë dhe fuqi, në të cilin populli i Gadishullit Arab i shek. XVII nuk kishte hasur kurrë më parë.[14] Kurani fisnik përfshin të gjitha artet e retorikës, që nga format e theksimit; llojet e përngjasimit dhe të përfaqësimit; llojet e metaforës; leximin e mirë dhe pjesët; ndarjet; parafjalët larg nga fjalët e dobëta e jonormale, të cilat janë jashtë analogjisë që anon nga përdorimi; si dhe lloje të tjera të retorikës. Asnjë nga retorikët e arrirë nga arabët origjinalë nuk është i aftë përpos në një ose dy prej llojeve të përmendura, dhe nëse ai kërkon një lloj tjetër në fjalimin e tij, ai është mangët. Ndërkaq Kurani i shenjtë i përmban të gjitha ato.[15]

---

12 Ziauddin Sardar, *Fytyra të Islamit, biseda për probleme bashkëkohore*, (Profesor Kemal Hasan, Kitab-i në intervistë me Ziauddin Sardar), op. cit., f. 47.

13 Po aty, f. 49.

14 Bassam Saeh, *Gjuha e mrekullueshme e Kuranit, dëshmi e origjinës hyjnore,* Tiranë, 2020, f.11.

15 Osman Nuri Topbash, *Vargu i profetëve nën dritën e Kuranit, Hazreti Muhamed Mustafa (slalallahu alejhi ve selem),* Shkodër, 2012, f. 252.

El Xhahidhi ka shkruar: “Ajo që dëshmon se Kurani është shpallje autentike është kompozimi i tij i jashtëzakonshëm, të cilin nuk mund ta bëjë njeriu.” Kurse El Bakilani, ka thënë: “Kurani mbetet i paimitueshëm, sepse kompozimi i tij ndryshon nga çdo trajtë tek arabët. Kurani i fton ata që nga materiali i njëjtë gjuhësor të ndërtojnë një arkitekturë të tillë madhështore.”

Shprehja “*ixhaz*” nënkupton pafuqinë dhe pamundësinë e tjetrit. Kjo do të thotë se Kurani ka konstatuar pafuqinë e njerëzve që ata të sjellin një libër të ngjashëm me të. Pra të tjerët janë të pafuqishëm që të sjellin diç të tillë për nga kuptimi, forma dhe përmbajtja, ngase Kurani është në një nivel që njeriu s’mund ta arrijë atë asnjëherë, në asnjë formë dhe në asnjë mënyrë.[16]

Kurani i mahniti zotëruesit e gjuhës dhe letërsisë arabe dhe tregoi se ata ishin të paaftë të shkruanin diçka, qoftë madje edhe të përafërt me kaptinën më të shkurtër të tij. Lexuesi sfidohet që të sjellë shpjegime se nga erdhi ky libër i bërë nga letra dhe boja. Në thelb, Kurani, sikurse thotë për kundërshtarët: “Ky libër është një shpallje hyjnore, në qoftë se ju nuk e besoni, atëherë nga e ka burimin Kurani? Është i rëndësishëm fakti se askush nga kundërshtarët nuk ka asnjë shpjegim të vlefshëm për këtë gjë, përpos kundërshtimit të pabazë.”[17]

[16] Afif Abdul Fetah Tabbareh, *Shpirti i fesë islame*, Prishtinë, 2020, f. 43.

[17] Osman Nuri Topbash, *Vargu i profetëve nën dritën e Kuranit, Hazreti Muhamed Mustafa*, op. cit., fusnota 144, f. 159; Gary Miller, *Kurani i mrekullueshëm (2)*, Dituria Islame, Revistë mujore fetare, shkencore e kulturore, numër 368/369, viti 35, korrik-gusht, Prishtinë, 2021, Dhul Hixhxhe-Muharrem, 1442/1443, f. 21.

# Hadithi kudsij

Kuptimi i hadithit kudsij i përket Allahut, kurse fjalët janë prej hasreti Muhamedit a.s., i cili ishte i autorizuar prej Allahut.[18]

Për ta kuptuar më mirë dallimin ndërmjet Kuranit dhe hadithit kudsij, citojmë thënien e Xhuvejnit, i cili ka thënë: "Shpallja prej Allahut është dy llojesh: Një lloj ishte që Allahu i thoshte Xhibrilit: "Thuaji Pejgamberit, tek i cili po të dërgoj, puno këtë dhe këtë, urdhëro për këtë dhe për atë!" Xhibrili e kuptoi atë çka i tha Zoti, erdhi te Pejgamberi dhe ia tha vetëm kuptimin, por jo edhe tekstin e fjalës, kurse Pejgamberi a.s. e shprehu atë me gjuhën e vet, pra teksti i fjalës është tjetër. Kurse te Kurani, edhe kuptimi edhe fjalët janë prej Zotit."[19]

Prandaj, Kurani është superior kundrejt hadithit kudsij, sepse ai është prej Allahut edhe si fjalë edhe si kuptim. Leximi i Kuranit duhet të bëhet kur jemi të pastër dhe me abdes. Hadithi kudsij nuk lexohet në namaz dhe nuk është e ndaluar prekja e librave të hadithit kudsij prej njerëzve që nuk kanë abdes. Hadithi kudsij mund të lexohet në çdo gjendje.[20]

Pra, hadithet kudsij janë thënie të Pejgamberit a.s., në të cilat kuptimi është shpallur nga Zoti, kurse formulimi është bërë nga Pejgamberi a.s.. Zinxhiri i transmetimit të hadithit

---

[18] El Ezhar esh Sherif, *Katërdhjetë hadithe të shenjta-kudsij*, Kajro, 1990, f. 10.

[19] Kurani, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, përktheu dhe komentoi H. Sherif Ahmeti, shih komentin në f. 13.

[20] El Ezhar esh Sherif, *Katërdhjetë hadithe të shenjta-kudsij*, op. cit., f. 11.

kudsij përfundon tek Allahu. Hadithet kudsij, në të shumtën e rasteve, janë të shënuara në veten e parë. Për shembull: Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a., se i Dërguari i Allahut a.s., ka thënë: “Allahu i Lartësuar thotë: “Unë jam ashtu siç më përfytyron robi Im. Unë jam me të kur ai të më përmend Mua. Nëse më kujton në vete, edhe Unë e kujtoj në Vete; nëse më kujton në tubim, Unë e përmend atë në kuvend më mirë se ai, nëse më afrohet një pëllëmbë, i afrohem një krah, nëse më afrohet një krah, i afrohem një pash, dhe nëse më afrohet duke ecur, Unë i afrohem me shpejtësi.” (Buhariu nr. 7405, Muslimi nr. 2675, Tirmidhiu, Ibën Maxhe).

Po ashtu, nuk ka kontradiktë në hadithet e Pejgamberit dhe hadithet kudsij, e kjo tregon për vërtetësinë e pejgamberisë së tij.

## Hadithi pejgamberik – nebevi

Fjalët dhe kuptimet e hadithit pejgamberik (*nebevi*) janë prej Pejgamberit a.s., nëpërmjet frymëzimit hyjnor. Te hadithi nebevi, zinxhiri i përcjelljes së tij përfundon te Pejgamberi a.s.. Pejgamberi a.s. ua tërhiqte vërejtën sahabëve që të mos përzihej fjala e Allahut xh.sh., të cilën e pranonte prej Xhibrilit a.s. me fjalën e tij.[21]

Kurani i shenjtë është i përcjellë me tevatur, kurse hadithet kudsij janë përcjell me tevatur ose me ahad. Sa u përket

[21] Dr. Muhamed Seid Ramadan el Buti, *Fikhu Sire*, studime metodologjike-shkencore për biografinë e Muhamedit, alejhi selam, Shkup, 2018, f. 86.

saktësisë së përcjelljes së haditheve kudsij, ato klasifikohen sikurse hadithet pejgamberike, në të sakta dhe të dobëta.[22]

Kurani është i ndarë në sure dhe ajete, ai që këndon Kuranin shpërblehet dhjetëfish për secilën germë të lexuar. Allahu ka premtuar se Kuranin do ta ruajë nga ndryshimet dhe shtrembërimet, prandaj Kurani, i tëri është ruajtur: ***“Ne ma madhërinë Tonë e shpallëm Kuranin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij.”*** *(El Hixhr, 9).* Kur lexohet Kurani, duhet të lexohet fjalë për fjalë, ashtu siç ka zbritur dhe nuk mund të thuhet me kuptim, kurse sa i përket hadithit kudsij dhe hadithit pejgamberik, ata mund të citohen edhe sipas kuptimit.[23]

Ndryshe nga hadithet pejgamberik, që janë fjalë të Pejgamberit a.s., stili i Kuranit është stil i Krijuesit të Madhërishëm, prandaj, asnjë hadith profetik nuk mund të krahasohet me ndonjë ajet kuranor. Te hadithi pejgamberik, zinxhiri i transmetimit përfundon te Muhamedi a.s.. Për shembull: Ebu Hurejra r.a. përcjell se i Dërguari i Allahut a.s., ka thënë: “Shembulli im dhe i pejgamberëve para meje është si shembulli i atij njeriu, i cili ndërtoi një shtëpi, e zbukuroi dhe e përsosi, përveç një pjesë të një tulle në një skaj. Njerëzit filluan të sillen rreth saj, e mahniteshin nga bukuria, e thoshin: “Ah po të ishte vendosur edhe kjo tullë?” Ai tha: *“Unë jam ajo tulla dhe unë jam vula e pejgamberisë.”* (Buhariu, 3535).

Fjalët e Pejgamberit, gjatë 23 vjetëve të pejgamberisë së tij, janë përpiluar në atë që quhet hadith, apo thënie. Dhe kur ndokush e shqyrton hadithin, ai mund ta shohë se stili dhe

[22] El Ezhar esh Sherif, *Katërdhjetë hadithe të shenjta-kudsi*, op. cit., f. 12.
[23] Po aty, f. 13.

gjuha janë krejtësisht të ndryshme nga Kurani. Gjithashtu nëse e vërejmë strukturën e të shprehurit –stilistikën kuranore të ndryshme nga ajo e të shprehurit të Muhamedit a.s., do të vërejmë qartë dallimin në çdo aspekt ndërmjet Kuranit dhe hadithit, si në mënyrën e të shprehurit, njashtu edhe të tematikave që trajton. Në hadith shihet gjuha e bashkëbisedimit, kuptimësisë, mësimit dhe ligjërimit në format dhe metodologjitë e njohura tek arabët në formë koncize, për dallim nga stilistika kuranore, e cila nuk ka ngjashmëri me stilistikën e të folurit të arabëve.[24]

Në stilin e të shprehurit në hadith krijohet ndjesia se ke të bësh me personalitet njerëzor, ndryshe nga Kurani, ku që nga fillimi deri në fund ke ndjesinë e një Qenie Madhështore dhe Absolute.[25]

Kur kritiku letrar me shije të mprehur e dëgjon hadithin (fjalët e Pejgamberit a.s.) dhe e krahason atë me Kuranin, ndien se çdonjëra prej tyre rrjedh nga dy burime të ndryshme dhe se do të kishte qenë e pamundur që autori i hadithit të jetë njëkohësisht edhe autor i Kuranit.[26]

Ndryshimi ndërmjet mënyrës së shprehjes së Kuranit dhe mënyrës së shprehjes së Pejgamberit Muhamed a.s., dallohet mjaft lehtë. Ndërmjet stilit gjuhësor e letrar të Kuranit dhe stilit gjuhësor e letrar të haditheve (thënieve) të Pejgamberit a.s., ka një ndryshim shumë të madh. Gjuha e haditheve të Pejgamberit a.s. ishte shumë më e kuptueshme, karshi shpre-

---

[24] Afif Abdul Fetah Tabbareh, *Shpirti i fesë islame*, Prishtinë, 2020, f. 45.

[25] Po aty, f. 45.

[26] Dr. Mustafa Mahmud, *Njihe Lajmëtarin*, op. cit., f.145.

hjeve kuranore, nga të cilat habiteshin dhe mahniteshin edhe vetë arabët. Duke lexuar thëniet e Pejgamberit a.s. kuptohet qartë se aty përvijohet imazhi i një njeriu që mendon e bisedon i përulur nga frika e Allahut xh.sh., kurse në gjuhën dhe zërin e Kuranit ndihet një guxim i lartë, një vizion tronditës e një tingëllim madhështor. Logjikisht, nuk është as e mundur dhe as e pranueshme që në shprehjen e një njeriu të sendërtohen aty për aty dy stile aq të ndryshme nga njëri-tjetri. Ky dallim kaq i madh dhe i gjerë ndërmjet strukturës së fjalëve kuranore nga ajo e hadithit, të cilin e vëren secili që ka dell për gjuhën arabe, dëshmon se Kurani është shpallje hyjnore.[27]

Dallimi ndërmjet Kuranit dhe hadithit është i qartë, dhe në fakt këta dy janë të pakrahasueshëm. Kurani fton njerëzimin në sfidë për të shkruar diçka të ngjashëm, ndërsa hadithi nuk e bën këtë. Ndonëse mjaft elokuente, hadithet nuk janë të paimitueshme. Duke tërhequr vëmendjen mbi këtë fakt, H.A.R. Gibs, në librin e tij *"Muhamedanizmi"* shprehet me këto fjalë: "Përshtypje të veçantë të lë fjalimi i Muhamedit a.s. në "haxhillëkun e lamtumirës" të cilin e mbajti gjatë vizitës së tij të fundit në Mekë, ndonëse me një përmbajtje tërësisht fetare dhe në një rast mjaft solemn, kjo përshëndetje e tij nuk gjendet në Kuran..."[28]

Këtu shihet se Muhamedi a.s. është një njeri si të tjerët, me dallimin e vetëm se atij i vjen shpallja nga Zoti xh.sh., gjë

[27] Afif Abdul Fetah Tabbareh, *Shpirti i fesë islame*, op. cit., f. 45.

[28] Hamza Mustafa Njazi, *Burimet e Kuranit, një pasqyrë kritike e teorive të Autorësisë së Kuranit,* Tiranë, 1993, f. 42.

të cilën e pohon vetë Kurani: ***“Thuaj: Unë jam vetëm njeri, sikurse ju, mua më shpallet se vetëm një Zot është Zoti juaj, e kush është që e shpreson takimin e Zotit të vet, le të bëjë vepër të mirë, e në adhurimin ndaj Zotit të tij të mos përziejë askënd.”*** *(El Kehf, 110).*

**Resul ef. REXHEPI**

# DISA DISPOZITA TË SHERIATIT LIDHUR ME KEFARETIN DHE FIDJEN E MOSAGJËRIMIT TË RAMAZANIT

Agjërimi (ar. saum-sijam) është abstenim nga ngrënia, pirja e ujit ose lëngjeve të lejuara dhe nga marrëdhëniet seksuale, nga koha e agimit të hershëm e deri në perëndim të diellit, me qëllim të bërjes ibadet-adhurim.

Përndryshe, agjërimi i muajit Ramazan është një nga pesë kushtet-shartet e fesë islame. Duhet pasur kujdes se ne, sa herë që flasim për agjërimin, e kemi për qëllim agjërimin sipas konditave islame, sepse agjërim kanë edhe pjesëtarët e feve të tjera, por agjërimi i tyre ka dallim nga ai islam. Si i tillë, agjërimi në fenë islame është detyrim fetar islam, është *farz* për çdo besimtar të moshës madhore dhe me zhvillim normal shëndetësor mendor dhe fizik. Prandaj, mohimi, tallja, neglizhenca, mosagjërimi i paarsyeshëm dhe mospërfillja e këtij detyrimi islam është rreptësisht i ndaluar (haram). Shkelja e shenjtërisë së agjërimit islam gjithsesi është haram dhe, rrjedhimisht, llogaritet të jetë mëkat i madh. Për këtë arsye, edhe shpërblimi për këtë ibadet-adhurim është i veçantë, siç është thënë në hadithin kudsij:

كل عمل ابن أدم له إلا الصوم فإنه لي و أنا أجزي به...

*"Çdo gjë që bënë njeriu është e tij, përveç agjërimit. Ai bëhet vetëm për Mua dhe Unë shpërblej për të posaçërisht."*[1]

Agjërimi i Ramazanit është bërë obligim-farz në muajin shaban të vitit të dytë të hixhretit, para betejës së madhe të Bedrit, gjegjësisht, një muaj pasi që kibleja qe kthyer në drejtim të Qabesë.[2] Duhet thënë edhe këtë se, asgjë nuk mund ta zëvendësojë plotësisht adhurimin e agjërimit, qëllimi kryesor i të cilit është transformimi shpirtëror i njeriut dhe plotësimi i cilësive të nevojshme për ngritjen në nivelet e devotshmërisë (takvallukut).

Në këtë shkrim tonin, kësaj here nuk synojmë të ndalemi më gjerësisht rreth gjithë ç'ka të bëjë me agjërimin, sepse për të është shkruar edhe më parë.[3] Me këtë rast, dëshiroj të hedh pak dritë lidhur me disa dispozita që kanë të bëjnë "me shpagimin", ose, thënë ndryshe, "me kundërshpërblimin e mëkatit të tyre", që në terminologjinë përkatëse emërtohet si *kefaret*. Me këtë rast, do të shkruajmë edhe për *fidjen*, sepse që të dyja këto janë të lidhura ngushtë ndërmjet vete. Kjo, edhe për faktin se në aspektin praktik, mendoj se besimtarët tanë kanë

---

1 Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi. Më gjerësisht: Esh Shelebi, prof. Muhamed Mustafa. "*El Med'hal fit tarif bil fikhi-l islamij*", botoi "Dar an Nahda al Arabijje", Bejrut, 1969.

2 Ajetet e Kuranit, të cilat flasin për këtë detyrim islam janë në suren El Bekare, ajetet 183-187.

3 Ma gjerësisht, shih punimin tonë te "Tema islame - 1", bot. Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, 2020, Prishtinë, nga faqe 43 e tutje. Ez Zuhejli, dr. Vehbe. *El Fikhu-l islamij ve edil letuhu*, "Daru-l fikr", Damask, 1996.

nevojë, së paku, të jenë të njoftuar me elementet themelore, ato më të nevojshme, me të cilat ata ballafaqohen gjatë kohës sa (nuk)agjërojnë. Për më tepër, shpresoj që kjo të bëhet shkak që dikush nga penat kompetente, këtë çështje ta elaborojë edhe më në hollësi, sepse edhe vetë tematika, po edhe besimtarët tanë këtë e meritojnë.

## Kefareti - shpagimi ose kundërshpërblimi

Nuk ka as edhe një mëdyshje se Allahu i Madhëruar është pafundësisht i Mëshirshëm dhe i Butë. Ai u la mundësinë atyre që e prishin agjërimin e tyre në mënyrë të pajustifikueshme ose e humbasin plotësisht agjërimin gjatë Ramazanit, të ndiejnë së paku disa nga të mirat e këtij muaji të bekuar dhe të meritojnë shpërblimin e Allahut të Lartësuar, duke e kompensuar lëshimin e tyre në formën e *kefaretit* ose *fidjes*. Prandaj, dijetarët islam kanë qenë të vendosur se për një agjërim të prishur në mënyrë të pajustifikuar dhe qëllimisht, shlyerja gjegjësisht shpagimi bëhet me *kefaret*.

Mirëpo, në rast se përkundër ndalimit të konfirmuar, besimtari e përdhosë shenjtërinë - hyrmetin e agjërimit të Ramazanit, duke e prishur agjërimin pa arsye dhe qëllimisht, qoftë përmes ushqimit, pijes ose marrëdhënieve seksuale, Sheriati, personin në fjalë, përveçse e obligon me pendim duke kërkuar falje nga i Gjithëmëshirshmi dhe me kompensimin e ditës së humbur, me kërcënim për dënim në Ahiret, ai gjithashtu ka paraparë edhe një sanksion në këtë botë në formën e *kefaretit - shlyerjes për mëkatin e bërë.* Ky rregull i Sheriatit, është i bazuar në hadithin e mirënjohur të Pejgamberit a.s.,

sipas të cilit, Ebu Hurejreja r.a., transmeton se: “Një ditë erdhi një njeri te Pejgamberi a.s. dhe i tha: “O i Dërguari i Allahut, unë u shkatërrova!” Pejgamberi a.s. e pyeti: “Ç’të shkatërroi ty?” Njeriu iu përgjigj: “Bëra marrëdhënie (seksuale) me gruan gjatë ditës në Ramazan!” Atëherë Pejgamberi a.s. iu drejtua: “A mund ta lironi një skllav?” Personi në fjalë iu përgjigj: “Jo!”. -“A mund të agjëroni dy muaj rresht (pa ndërprerje)?” - e pyeti më tej Pejgamberi a.s.. Personi në fjalë iu përgjigj: “Jo!”. Pejgamberi sërish e pyeti: “A mund të gjesh mundësi për të ushqyer gjashtëdhjetë të varfër?” Ai prapë iu përgjigj: “Unë nuk kam asnjë mundësi!”. Pastaj, Pejgamberi a.s. u ulë. Në këtë moment, Pejgamberit a.s. i sollën një enë me hurme.[4] Duke ia zgjatur enën njeriut, Pejgamberi a.s. i tha: “Merri këto hurma dhe shpërndajua të varfërve si sadaka (lëmoshë).” Njeriu i tha: “A ka më të varfër se ne, se familja ime, ja Resulullah? Në tërë gurishtën e zezë mes lindjes dhe perëndimit të Medinës nuk ka familje më nevojtare se ne!” Atëherë, Pejgamberi a.s. qeshi, sa iu duk bardhësia e dhëmbëve, dhe i tha: “Merri, shko dhe jepja familjes t’i hanë!”[5]

[4] Në komentimin e këtij hadithi, thuhet se ka pasur rreth 50 kokrra hurme (sa'a). Më gjerësisht: Grup autorësh, *Udhërrëfyesi i një myslimani*, Sh. B. “Prizmi”, Tiranë, 2010.

[5] Ky hadith është përmbledhur në gjashtë koleksionet kryesore të haditheve. Shiko: “Nejlu-l Eutar” të Sheukaniut, (4: 214); El Kasani, Imam Alaud-din, *Bedâi’us sanâi’ fî tertîbish sherâi’*, botim i tretë, botoi “Dar el ihja al Turath el Arabi” dhe “Muesese et Tarih el Arabi”, Bejrut, 2000.

## Arsyeja juridike (عِلَّةُ اْلحُكْمِ)

Rregullimi i kefaretit e ka edhe arsyen juridike *('il-letu 'l-hukmi),* kështu që sipas juristëve hanefi dhe maliki, në pyetje është përdhosja e shenjtërisë së agjërimit të Ramazanit, kështu që rregulli për shenjtërinë e kefaretit shtrihet në mënyrë analoge me përdhosjen e hyrmetit të Ramazanit, duke ngrënë ushqim, apo duke pirë lëngje, apo marrëdhënie seksuale.

Shkollat e tjera juridike islame konsiderojnë se përdhosja e shenjtërisë së agjërimit të Ramazanit shkaktohet vetëm me marrëdhënie seksuale (xhima), e jo me ushqim e pije, ose në çfarëdo mënyre tjetër. Pra, sipas tyre, në pyetje është mënyra më e vrazhdë e përdhosjes së shenjtërisë së agjërimit të Ramazanit. Prandaj, këta, obligimin e kefaretit e lidhin ekskluzivisht me prishjen e agjërimit me anë të marrëdhënieve seksuale.

Duhet theksuar edhe këtë se, kefareti nga njëra anë është dënim, kurse nga ana tjetër është ibadet-adhurim. Është dënim, sepse ka të bëjë me detyrimin e kryerjes, i cili është i lidhur me veprën e kryer. Nga ana tjetër, ibadeti-adhurimi ka të bëjë me vetë ekzekutimin, pasi që bëhet me agjërim ose me dhënien e sadakasë, e këto vepra në vetvete janë ibadete.

## Mënyra e kryerjes së kefaretit

Sheriati çështjen e *kefaretit* e ka normuar në mënyrë të detajuar. Duke qenë se një periudhë kohore, për shumë arsye, e sidomos për shkak të zhvillimeve praktike, mund të ketë dallim nga një tjetër, juristët islam, mënyrën e kefaretit për kohën aktuale e kanë paraparë në njërën nga dy mënyrat:

1. Agjërimi i dy muajve hënor radhazi (pandërprerë). Në rast të pamundësisë, atëherë është mënyra e dytë:
2. Ushqyerja e gjashtëdhjetë të varfërve ose një të varfëri gjashtëdhjetë ditë. Lidhur me respektimin ose jo të radhës së alternativave të përmendura si në hadithin e sipërcituar (lirimi i një skllavi, agjërimi i gjashtëdhjetë ditëve ose ushqimi i gjashtëdhjetë të varfërve), ka diskutime të ndryshme ndërmjet juristëve islam. Sipas juristëve hanefitë, është e detyruar ndjekja e radhës së alternativave në fjalë. Mirëpo, meqë sot nuk ekziston skllavëria, së pari kërkohet agjërimi i dy muajve radhas, pastaj, nëse personi nuk ka mundësi fizike për këtë, kërkohet të ushqejë gjashtëdhjetë të varfër për një ditë ose një të varfër për gjashtëdhjetë ditë.[6]

Sasia e shujtës me këtë rast korrespondon me sasinë e sadakatul fitrit për një person. Sasia e sadakatul fitrit është caktuar në bazë të burimeve të Sheriatit, dhe mbështetur në ato mësime, te ne, këtë në mënyrë praktike dhe konform rrethanave aktuale, e cakton organi kompetent, e që është Kryesia e Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës. Gjatë Ramazanit të kaluar, Kryesia e Bashkësisë Islame, sadakatul fitrin e ka caktuar në sasi monetare: 3, 5 dhe 10 euro për person, varësisht sipas gjendjes financiare të personit. Meqenëse për shumicën e njerëzve është vështirë të agjërojnë dy muaj

[6] El Kasani, Imam Alaud-din, *Bedâi'us sanâi' fî tertîbish sherâi'*, botim i tretë, botoi "Dar el ihja al Turath El Arabi" dhe "Muesese et Tarih el Arabi", Bejrut, 2000. Mund të konsultohet edhe: Ekipi Studimor i Kërkimeve, *Udhërrëfyesi i një myslimani*, Prizmi, 2010, Tiranë (Përkthim nga turqishtja).

rresht, e nga ana tjetër një pjesë e njerëzve nuk janë në gjendje të mirë financiare, duket mjaftueshëm i arsyeshëm dhe i pranueshëm mendimi i dijetarëve, të cilët konsiderojnë se personi që e ka prishur agjërimin pa arsye mund të zgjedh këtë opsionin e dytë (pra, të ushqyerit e të varfërve), i cili përndryshe është qëndrim i dijetarëve të medhhebit maliki. Këta dijetarë, këtë mendim e arsyetojnë se në disa versione hadithi për kefaretin e ka përmendur pjesëzën lidhëse "ose", pra, në formë alternative.

## Me rastin e kryerjes së kundërshpërblimit - kefaretit duhet pasur kujdes

- Personi që është i detyruar me agjërim si kundërshpërblim (kefaret), është i detyruar të agjërojë dy muaj radhazi pa asnjë ndërprerje. Prandaj, në mes të këtyre dy muajve, nuk duhet të hyjë Ramazani ose të ketë ditë gjatë së cilave e ka të ndaluar (haram) të agjërojë, siç janë ditët e dy bajrameve. Në rast të kundërt, do të jetë i detyruar ta rifillojë nga e para agjërimin e kefaretit.
- Ndonëse kur personi udhëton gjatë Ramazanit e ka të lejuar të mos agjërojë, nëse ai është duke agjëruar për kefaret, agjërimin duhet ta vazhdojë edhe kur është në udhëtim.
- Në qoftë se femra është duke agjëruar për kefaret, dhe i paraqitën të përmuajshmet ose bëhet lehonë, ajo nuk do të agjërojë dhe kjo nuk ia prish radhën e agjërimit për dy muaj, por pas mbarimit të ciklit mujor ose kalimit të kohës së lehonisë, e vazhdon ku e ka lënë dhe i plotëson ditët e mbetura.

- Në qoftë se prishja e agjërimit të Ramazanit në mënyrë të paarsyeshme do të përsëritej para se personi ta ketë bërë kefaretin për shkeljen e parë, një kefaret mjafton për të gjitha shkeljet, natyrisht nëse nuk është kryer kefareti për shkeljet e mëparshme, pasi që një kefaret i absorbon të tjerët, ngjashëm me dënimet nga fusha e "hududit" në rast të përsëritjes së veprës penale, në qoftë se shkelësi nuk është dënuar për veprat penale të mëparshme. Duhet thënë edhe këtë se, qëllimi i dënimit arrihet me një kefaret. E, nëse pas mbajtjes së një dënimi vepra përsëritet, pason një dënim i ri – kefareti tjetër, pasi që kefareti i parë nuk ia ka arritur qëllimit. Nëse një person nuk mund ta kryej kefaretin, detyrimi për ta kryer ngelet borxh që zgjatë deri në kryerjen e tij.

## Situata kur personi lirohet nga kundërshpërblimi (kompensimi-kefareti)

Në qoftë se gjatë ditëve të Ramazanit një grua është duke agjëruar, mirëpo e prish agjërimin me qëllim, e në qoftë se atë ditë asaj i krijohet një situatë e tillë që e liron nga agjërimi, siç janë paraqitja e të përmuajshmeve ose lehoia, gjë që ngrënien e bëjnë normale (mubah), pra i lejohet ta prishë agjërimin, atëherë me këtë rast kundërshpërblimi (kefareti) bie dhe i mbetet vetëm detyrimi për zëvendësimin e ditëve të pa agjëruara (kaza). I njëjti konkluzion vlen edhe për shfaqjen e ndonjë sëmundjeje që e pengon agjërimin.

E kundërta e këtij rasti është në qoftë se agjërimin e prish me dashje, e pastaj niset në udhëtim në mënyrë të qëllimshme, ose me detyrim, ose me vetëprovokim të sëmundjes,

në këto raste kundërshpërblimi (kompensimi) – kefareti mbetet në fuqi, pra personi i tillë nuk lirohet nga kefareti.

## Fidja

Në literaturën përkatëse të jurisprudencës islame (fikhut), kur flitet në kontekstin e lirimit nga obligimi i agjërimit i të sëmurit apo udhëtarit, të cilët janë të obliguar të agjërojnë ditët e humbura që nuk i kanë agjëruar, Zoti i Madhëruar përmend në Kuran një rast të veçantë, të cilit si alternativë i bashkëngjitet detyrimi i kompensimit për shkak se e ka pasur obligim për të agjëruar.

Allahu xh.sh., në Kuran, na udhëzon duke na thënë:

أَيَّامًا مَعْدُودَاتٍ فَمَنْ كَانَ مِنْكُمْ مَرِيضًا أَوْ عَلَى سَفَرٍ فَعِدَّةٌ مِنْ أَيَّامٍ
أُخَرَ وَعَلَى الَّذِينَ يُطِيقُونَهُ فِدْيَةٌ طَعَامُ مِسْكِينٍ فَمَنْ تَطَوَّعَ خَيْرًا
فَهُوَ خَيْرٌ لَهُ وَأَنْ تَصُومُوا خَيْرٌ لَكُمْ إِنْ كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ (١٨٤)

*“(Jeni të obliguar të agjëroni)* ***Disa ditë të caktuara, e kush prej jush është i sëmurë ose është në udhëtim*** *(e nuk agjëroi),* ***atëherë ai*** *(le të agjërojë)* ***aq ditë nga ditët e mëvonshme. E ata që e kanë të vështirë*** *(e nuk mund të agjërojnë),* ***janë të obliguar për kompensim ushqim ditor i një të varfëri, e ai që nga vullneti jep më tepër, ajo është aq më mirë për të. Mirëpo, agjërimi është më i mirë për ju po që se e kuptoni!”***[7]

---

[7] Kuran, El Bekare, 184. Krahaso dhe: Ez Zuhejli, dr. Vehbe. *El Fikhu-l islamij ve edil letuhu*, “Daru-l fikr”, Damask, 1996. El Halebi, Ibrahim. *Multeka’l-ebhur*, vëll. I, përktheu: Omer Nakičević e të tjerë, botoi “FSHI”, Sarajevë, 2002.

Ibën Abbasi e interpretoi këtë ajet, duke thënë se çështja ka të bëjë me një person në pleqëri të thellë që me shumë vështirësi e përballon agjërimin. Duke qenë se nuk ka asnjë shpresë në përmirësimin e shëndetit të tij, i cili në të ardhmen vetëm se mund të përkeqësohet akoma më shumë, personit të tillë ia ka përcaktuar kompensimin e ditëve të pa agjëruara në formë të *fidjes*, d.m.th. *që për çdo ditë që nuk e ka agjëruar të Ramazanit të ushqejë një të varfër.*

Kjo, gjithashtu, në mënyrë analoge me rastin e përmendur, vlen edhe për personin që vuan nga një sëmundje kronike të përhershme, sëmundje e rëndë, së cilën agjërimi do ta vështirësonte akoma më shumë, ose thjesht, në atë gjendje agjërimi do të ishte shumë i vështirë dhe i lodhshëm për t'u kryer.

Vlerësimin e një gjendje të tillë më së miri e bën vetë personi, sidomos duke u bazuar në përvojën e tij ose nga një mjek i besueshëm mysliman.

Mirëpo, në qoftë se personat e përmendur, për shkak të gjendjes së tyre të rëndë materiale, nuk kanë mundësi t'i kompensojnë ditët e pa agjëruara, ky detyrim bie, bazuar në ajetin kuranor:

لَا يُكَلِّفُ اللَّهُ نَفْسًا إِلَّا وُسْعَهَا... (٢٨٦)

***"Allahu nuk e ngarkon askënd përtej mundësive të tij..."***

Dhe në ajetin tjetër:

فَٱتَّقُواْ ٱللَّهَ مَا ٱسْتَطَعْتُمْ

***"Prandaj, keni frikë Allahun sa të mundeni..."***

Nëse personi, i cili për arsye të justifikueshme (sëmundje ose udhëtim), nuk ka agjëruar disa ditë ose tërë Ramazanin

dhe vdes para se t'i agjërojë ditët e humbura, ky obligim bie dhe nuk detyrohet të bëjë kompensimin me fidje. Mirëpo, nëse ai ka vdekur pasi ka mundur të agjërojë ditët e humbura dhe nuk e ka bërë këtë para vdekjes së tij, nga pasuria e atij personi do të ndahet sasia e fidjes, e nëse ai person nuk ka lënë pasuri, atëherë trashëgimtarët e tij do ta bëjnë këtë nga pasuria e tyre. Shuma dhe përfituesit e fondeve në emër të kefaretit (kur bëhet në formën e ushqimit të të varfërve) dhe fidjes bëhet në nivel të sadakatul fitrit. Kur bëhet fjalë për kefaret, ai është gjithsej 60 ditë x 3 euro = 180 euro për ata me gjendje më të ulët financiare. Ndërkaq, për ata me gjendje mesatare, kjo do ishte 60 x 5 = 300 euro. Kurse për ata me gjendje të mirë materiale, kjo do të duhej të llogaritej: 60 x 10 = 600 euro.

Kur është fjala te rasti i fidjes, sasia është e njëjtë (si te sadakatul fitri) duke e shumëzuar për ditët e pa agjëruara. P.sh. nëse një person nuk i ka agjëruar 5 ditë, ai duhet të llogarisë sipas kushteve të tij materiale me nga 3, 5 ose 10 euro për një ditë, që i bie 5 x 3 = 15, ose 5 x 5 =25 ose 5 x 10 = 50 euro. Kështu bëhet llogaria qoftë për më pak ose për më shumë ditë.

Pra, për t'u kuptuar drejt, *fidja* është shpërblimi që japin personat që nuk mund të agjërojnë për shkak të ndonjë sëmundjeje të vazhdueshme, ose për shkak të pleqërisë së thellë, duke ushqyer një të varfër për çdo ditë të pa agjëruar. Ngjashëm me kefaretin, me anë të fidjes, edhe personi që nuk agjëron do të çlirohet nga përgjegjësia përkatëse, e nga ana tjetër plotësohet një nevojë shoqërore mjaftë e ndjeshme, siç është ushqimi i të varfërve. Edhe në kohën tonë, fatkeqësisht shumë individë, por edhe familje, kanë nevojë për t'iu ndih-

muar, e ku më mirë se sa përmes kësaj norme fetare. Njeriu, duke e dhënë kefaretin dhe fidjen individëve me gjendje të rëndë ekonomike, nga njëra anë, lirohet nga përgjegjësia e mosagjërimit, e nga ana tjetër, e gëzon një besimtar, i cili aq shumë ka nevojë t'i ndihmohet. "*Allahu është në ndihmë të robit të Tij aq sa ai është në ndihmë të vëllait të tij*"- ka thënë i Dashuri i Zotit, Muhamedi a.s.. Gjithashtu, nëse vendos që fidjen ta paguajë në organet e Bashkësisë Islame, e sidomos në Shoqatën Bamirëse Humanitare "Bereqeti" kjo është shumë, shumë me vend, sepse përmes saj arrin te shtresa që ka nevojë.

**Literatura e shfrytëzuar:**

- Imam Muslimi, *Sahihi Muslim bi sherh en Nevevi*, Shtypshkronja "Misrijje", Kajro, pa v.b.
- El Bureni, Muhamed A.I.. *Çështjet të fikhut sipas Kuduriut*, bot. Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë, 2002.
- El Halebi, Ibrahim. *Multeka'l-ebhur*, vëll. I, përktheu: Omer Nakičević i drugi, botoi "FSHI", Sarajevë, 2002.
- El Karnshavi, Abdul-Xhelil. *Dirasat fi 'l Sheriati 'l islamije*, botime të Universitetit të Benghazit, Benghazi, Libi, pa v.b.
- El Kasani, Imam Alaud-din, *Bedâi'us-sanâi' fî tertîbish-sherâi'*, botim i tretë, botoi "Dar el ihja al Turath el Arabi" dhe "Muesese et Tarih el Arabi", Bejrut, 2000.
- El Xheziri, Abdurrahman, *Kitabu 'l fikh alel medhahebil erbeati*, Dar u rrejan lit-turath, bot i parë, Kajro, 1987.
- Esh Shelebi, prof. Muhamed Mustafa. "*El Med'hal fit tarif bil fikhi-l islamij*", botoi "Dar an Nahda al Arabijje", Bejrut, 1969.
- Esh Sheukani, Muhamed bin Ali. *Nejlul Eutar*, "Darul Xhil", Bejrut, 1973.
- Ez Zuhejli, dr. Vehbe. *El Fikhu-l islamij ve edil letuhu*, "Daru-l fikr", Damask, 1996.
- Enes Ljevakovic, Vendi i kefaretit në Sheriat, botuar në portalin e FSHI-së, Sarajevë, 2007.
- Sibai, dr. Mustafa, Dispozitat e agjërimit dhe filozofia e tij në dritën e Kuranit dhe synetit, Bejrut, 1397.
- Resul Rexhepi, Tema islame (Festat, Ditët dhe Netët e Mëdha), bot. Kryesia e Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2020.

**Dr. Rexhep SUMA**

# BESIMI NË ZOTIN DHE NDIKIMI I TIJ NË FORMËSIMIN DHE PREDIKIMIN E MORALIT

Bindja në besimin e drejtë e bën fenë islame që të hyjë thellë dhe konstruktivisht në çdo pore dhe aspekt jetësor. Sipas fesë islame, besimi i vërtetë ka një efekt tejet të vendosur dhe të rëndësishëm në të gjithë jetën shpirtërore dhe materiale të njeriut, në sjelljen e tij personale dhe sociale, si dhe në pikëpamjet politike dhe në jetën financiare të tij. Që të tregojmë se si i përshkruan Kurani besimtarët e vërtetë, në vazhdim do të paraqesim disa shembuj.[1]

Besimi në Allahun Një, ndikon jashtëzakonisht shumë në etikën e cila ka një ndikim të dukshëm në ndërtimin e shoqërisë dhe individëve të saj, pasi përmes saj matet shkalla e përshtatshmërisë, duke qenë një tregues i përkushtimit ndaj vlerave dhe cilësive të mira. Etika kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në inkurajimin e shoqërisë, që ajo të jetë një shoqëri e mirë dhe funksionale. Po ashtu, mungesa e saj reflektohet negativisht në shoqëri. Etika e mirë e mbjell besimin

[1] Hamude Abdulati, *Islami në fokus*, përktheu Bujar Hoxha, Logos-A, Shkup, 2000, f.58.

te individët dhe lufton sjelljet e prishura.[2] Ibën Kajimi ka thënë: "Feja është mirësjellje (etikë), ai që ta kalon ty në mirësjellje, vetëm se ta ka kaluar edhe në aspektin e fesë."[3] Nga ana tjetër, dijetari me famë botërore, dr. Jusuf Kardavi, ndanë mendimin se s'ka etikë fetare pa fe. Sipas tij, feja nuk ndalet vetëm te thirrja për respektimin e normave të moralit dhe lartësimi i tyre, porse ai i forcon rrënjët e saj, përcakton shenjat e etikës, vendos rregullat e saj, përcakton trajtat dhe përkufizon standardet e saj të përgjithshme. Ai sjell shembuj për shumë aspekte të sjelljes së qëndrueshme, e më pas nxit për përmirësim dhe paralajmëron për pasojat e shmangies. Ai vendos shpërblimin dhe ndëshkimin si dy shtylla të qarta për t'u mbajtur parasysh. Pa fe s'mund të ekzistojë morali. Pa moral nuk mund të ketë ligj.[4] Me vëzhgimin e situatës që po kalon njerëzimi sot, në lidhje me krizat e ndryshme në shoqëri dhe individë, konfirmohet një e vërtetë e rëndësishme se një pjesë e madhe e këtyre krizave rrjedh nga ekzistenca e boshllëqeve të mëdha në fushën etike, të cilat kanë reflektuar negativisht në aspektet shpirtërore dhe të sjelljeve të njeriut modern. Shoqëritë tona islame, gjithashtu, kanë pësuar nga këto kriza shumëdimensionale, duke ndikuar ndjeshëm në rënien e dukshme morale. Duhet theksuar faktin se Islami, kur

[2] Halid Mezjen, *El kijemul ahlakije el mutedamine fi muhteva kutubi lugatina*, 2013, f.32.

[3] Ebu Abdullah Shemsu'din Muhamed ibën ebi Bekr ibën Ejub ibën Sa`d ibën Hariz al-Zur`i el-Dimeshki (i njohur si Ibën Kajjim el Xhevzije), *Medarixhus' salikijn*, Daru'l kutub el Ilmije, Bejrut, 2010, botim i 1-rë, v.2, f. 307.

[4] Jusuf Kardavi, *El Imanu vel hajatu*, Muesesetur'risale, bot. i 13-të, Bejrut, 1987, f. 209.

depërton në një mjedis apo popull, atë e shndërron në një fushë të mbushur me lëvizje, aktivitete dhe kujdes. Nxit për ndërtim të shpirtërores dhe materiales. I lufton sëmundjet dhe negativitetet, duke u përballur me to në luftë të vazhdueshme dhe duke ua lënë thellë në zemrat e masës vendin ndershmërisë dhe devotshmërisë.[5]

Qasja etike islame buron nga parimi i tevhidit (besimi në një Zot) dhe në atributet dhe veprimet e Tij. Ajo bazohet në idenë se Allahu i Madhërishëm ka vendosur në njeriun një prirje natyrale, që e nxit atë drejt së mirës dhe arritjes së përsosmërisë me vullnetin dhe zgjedhjen e tij. Qëllimi përfundimtar i moralit është arritja e afërsisë me Allahun, e cila përfaqëson përsosmërinë absolute. Lumturia e vërtetë e njeriut qëndron në arritjen e këtij qëllimi.

Qasja etike e pranuar bazohet në parimin se Allahu xh.sh. ka vendosur sistemin më të mirë në univers, i cili e udhëheq çdo krijesë drejt përsosmërisë së saj. Ai gjithashtu ka krijuar një sistem etik të plotë, që ka për qëllim ta çojë njeriun drejt këtij perfekti përmes përcaktimit të qëllimit të tij më të lartë, caktimit të rrugës dhe shpjegimit të pengesave që mund të shfaqen në këtë rrugë, si dhe identifikimin e modelit dhe udhëheqësit në këtë udhëtim. Kjo është një nga funksionet më të rëndësishme për të cilat është dërguar Muhamedi a.s., siç e ka shpjeguar ai vetë në një hadith: *"Unë kam ardhur për të përsosur virtytet më të mira të moralit."* Kjo tregon se ekziston një sistem etik, i plotë dhe i harmonishëm me naty-

[5] Muhamed Gazali, *Edavetu el islamije testakbil karneha el hamis ashere*, Daru'l kalem, bot. i II, Damask, 2005, f.10.

rën e njeriut, i cili është shpjeguar nga mesazhi islam. Prandaj, është e domosdoshme që ne t'i njohim dhe eksplorojmë themelet dhe mësimet e këtij sistemi, si dhe të punojmë për t'i përhapur, promovuar dhe edukuar me mjete dhe metoda të ndryshme. Kjo do të ndihmojë në ndërtimin e një shoqërie që respekton dhe ndjek vlerat etike, të cilat nxisin moralin dhe përmirësimin e individëve. Duke u thelluar në mesazhin e Islamit dhe thirrjen e tij të vërtetë (*hak*), secili mund të has në karakteristika të cilat nuk i has në njohuritë njerëzore e as në fetë e tjera. Ai përmban një kompletim në kuptim dhe në rezonim që i përgjigjet jetës së individit, në udhëzimin në besim dhe formimin e individit me moral të lartë që nga fëmijëria e deri te pleqëria.[6]

Refleksioni i besimit është në gjendje të shërojë devijimet, ai ngul në çdo individ konceptin e mbikëqyrjes së Allahut, përpjekjen për të fituar shpërblim, duke e bërë besimtarin të kujdeset që sjellja e tij të jetë e mirë me të gjithë njerëzit, madje edhe me kafshët dhe mjedisin që e rrethon. Ky është mesazhi i Islamit, një fryt nga frytet e besimit. Po ashtu besimi është ai që e drejton sjelljen në shtëpi, me fqinjët, në punë, në treg, dhe kudo që gjendet. Nga Ebu Hurejre r.a. transmetohet se Pejgamberi a.s. ka thënë: "*Kush beson në Allahun dhe në Ditën e Fundit, le të mos e dëmtojë fqinjin e tij, dhe kush beson në Allahun dhe në Ditën e Fundit, le të nderojë mikun e tij, dhe kush beson në Allahun dhe në Ditën e Fundit, le të thotë fjalë të mira ose le të heshtë.*" (Mute-

[6] Abdurrahim Magdhevi, *Dirasatun menhexhijetun fid'aveti vel hisbeti*, Daru'l hadare, bot. i I, Riad, 2019, f.115.

fekun alejhi). Islami i ka dhënë një vend të lartë etikës, duke e lidhur atë me përhapjen e vlerave të mira morale. Një nga çështjet kryesore që është fokusuar në legjislacionin islam është riparimi i asaj që ka prishur morali i injorancës në shoqëri.[7]

## Faktorët në sjelljen etike

### Besimi

Nuk ka dyshim se nxitësi i parë i virtyteve të mira është besimi, sepse ai e lidh njeriun me Krijuesin e tij, Allahun e Lartësuar, dhe kur e kujton madhështinë e Allahut dhe dobësinë e njeriut, i dhuron atij virtytin e përulësisë. Prandaj është thënë: *"Kush e njeh veten, e njeh Zotin e tij."; "Nëse të thërret fuqia jote për të bërë padrejtësi ndaj njerëzve, kujto fuqinë e Allahut mbi ty."*

### Adhurimet

Adhurimet kanë një ndikim pozitiv në sjelljen e individit. Kjo manifestohet tek ata që vazhdojnë t'i ushtrojnë adhurimet në mënyrë të saktë dhe në përputhje me Sheriatin. Namazi ndihmon në kontrollin e sjelljeve, qetëson nervat dhe rrit vetëkontrollin. Adhurimet kanë një ndikim të madh në sjelljen dhe moralin e individëve. Allahu i Madhërishëm thotë: ***"Me të vërtetë, namazi ndalon nga veprat e turpshme dhe të këqijat."*** *(El Ankebut, 45).* Namazi zbut zemrën, rrit besi-

---

[7] Ijhab Ahmed, *Mekanetu'l ahlak fi'l islam*, 2014, f. 56.

min, sjell sinqeritet dhe e lidh njeriun me jetën e amshuar. Kjo ka një ndikim të dukshëm në përulësinë e njeriut dhe mëshirën ndaj të tjerëve. Zekati, po ashtu, kontribuon në kultivimin e mëshirës, bamirësisë dhe përulësisë, duke rritur lidhjet shoqërore dhe duke e lidhur individin me jetën e amshuar. Kjo ndikon në sjelljen e individit dhe mënyrën se si e shikon botën rreth tij. Agjërimi është një mjet për kontrollin e nervave dhe sjelljeve, duke rritur vetëkontrollin dhe duke e bërë njeriun të ndiejë dhe t'i ndihmojë të varfrit dhe ata në nevojë, të cilët nuk kanë çfarë të hanë. Haxhi, nga ana tjetër, edukon mbi durimin, përulësinë dhe barazinë, duke krijuar ndjenjën e barazisë mes myslimanëve. Këto veprime adhurimi ndihmojnë në formësimin e karakterit dhe sjelljes morale të individëve, duke kontribuar kështu në një shoqëri më të drejtë dhe të mirë.

## Shoqëria, miqësia dhe ndërveprimi

Islamit i jep rëndësi të madhe aspektit të shoqërisë, duke e inkurajuar njeriun që ta rrethojë veten me njerëz të mirë dhe të shmangë shoqërimin me ata që janë të keq. Allahu i Madhërishëm thotë: ***"Prandaj, pas kujtimit, mos u ul me ata që janë të padrejtë."*** *(El Enamë, 68).* Muhamedi a.s. ka thënë: "*Shembulli i shokut të mirë dhe shokut të keq është si ai i bartësit të erës së mirë dhe i atij që fryn në zjarr. Bartësi i erës së mirë ose të ofron diçka, ose ti blen prej tij, ose e ndien aromën e mirë nga ai. Ndërsa ai që fryn në zjarr, ose të djeg dhe të ndot veshjet, ose do të ndiesh erë të keqe nga ai.*"

Kjo tregon se shoqëria dhe miqësia kanë një ndikim të thellë në formimin e karakterit dhe sjelljes së individëve, du-

ke përforcuar rëndësinë e përzgjedhjes së shokëve dhe rrethit social. Shoqërimi me njerëz të mirë ndihmon në zhvillimin e vlerave të mira dhe në mbështetje të ndërsjellë, ndërsa shoqërimi me ata që kanë karakter të keq mund të ndikojë negativisht në sjelljen dhe moralin e individit.

## Edukimi

Edukimi ka një rol të rëndësishëm në orientimin e brezit të ri në një drejtim të mirë, duke pasur një ndikim të madh në moralin e tyre. Edukimi i mirë ka disa mjete, të cilat përfshijnë: inkurajimin, këshillimin dhe orientimin, modelimin dhe edukimin përmes situatave të jetës, si dhe ndonjëherë edhe përmes disiplinës. Këto metoda ndihmojnë në formimin e karakterit dhe sjelljes së individëve, duke u dhënë atyre mjetet e nevojshme për t'u përballur me sfidat e jetës dhe për të zhvilluar virtyte të mira. Një edukim i mirë i mbështetur në vlerat morale dhe etike është thelbësor për ndërtimin e një shoqërie të shëndoshë dhe të drejtë. Edukimi gjithashtu ndihmon në krijimin e një ndjenje përgjegjësie dhe ndërgjegjësimi tek individët, duke i bërë ata të vetëdijshëm për rëndësinë e veprimeve dhe vendimeve të tyre në jetën e përditshme. Krahas këtyre ajeteve, por edhe të shumta lidhur me këtë çështje kemi edhe traditën profetike. Transmeton Enes bin Maliku se Pejgamberi a.s., ka thënë: *"Nuk do të jetë besimtar (mu'min) askush nga ju, përderisa nuk i dëshiron vëllait të tij atë çka ia dëshiron vetes."*[8]

[8] Sahihu'l buhari, Kitabu' iman, 14/1, nr.13. Muslimi, nr. 45.

## Arsyeja e balancës

Të vetëkuptuarit e Islamit si udhë e mesme është njëkohësisht i mirënjohur dhe dallues, në kundërshtim me ca forma të zhvilluara të feve më të hershme. Në mënyrë etike, modeli i tij i jetesës është të mos përqafonte as asketizmin e rreptë të Krishterimit të hershëm, as hedonizmin e Romës së lashtë. ***"Kështu Ne ju bëmë juve umet të mesëm..."*** *(El Bekare, 143).* Komentuesit vendosen se ky përcaktim do të ishte gjeografik, shpirtëror dhe moral. Mirëpo në çfarë kuptimi mundej një vetimazh i tillë të ishte, më së pari, një bazë për jetën intelektuale? A mundemi t'i japim një rendësi të madhe arsyes (a mundet kjo të jetë vetja nëse praktikohet me tepri?). Apo t'i japim rendësi fort të vogël? Fjala e Zotit, Libri, si fjalë *(nutk),* është pikërisht themeli e garanti i logjikes *(mentik),* dhe Libri është në vetvete një takëm argumentesh të rrokshme prej mendjes.[9]

Në besimin monoteist, koncepti i moralit vjen si një urdhër hyjnor, që i ofron njeriut një udhë të përhershme drejt qëllimeve më të larta, të lidhura me harmoninë e brendshme dhe paqen sociale. Ky moral hyjnor nuk ndryshon sipas rrethanave apo interesave personale, përkundrazi, mbetet i qëndrueshëm dhe qëndron mbi interesat individuale. Kjo ndikon që individi të zhvillojë një sens të fortë të përgjegjësisë, jo vetëm për veprimet e tij personale, por edhe për kontributin e tij në mirëqenien e shoqërisë. Gjithashtu, besimi në Zotin frymëzon një lloj morali, që nuk varet nga shpresat ose

[9] Tim Vinter, *Besimi, arsyeja, shpallja,* përktheu Arjol Guni dhe Rezart Beka, Eramus, Tiranë, 2013, f.96.

frika e sanksioneve të jashtme, por nga një ndjenjë e brendshme e detyrimit moral ndaj diçkaje më të lartë. Kështu, besimi fetar ndikon që morali të mos mbetet thjesht një koncept abstrakt, por të zbatohet në praktikat e përditshme për të përmirësuar marrëdhëniet ndërnjerëzore dhe për të ngritur standardet e etikës në çdo aspekt të jetës.[10]

Në një kohë kur procesi i globalizimit – jo vetëm ekonomikisht por edhe kulturalisht – është i fortë, është me shumë rëndësi të përcaktohen gurët kyç të panoramës globale. Prirja është aq e fortë, saqë ne s'mundemi të kënaqemi me disa koncepte referenciale që japin ide të pjesshme të realitetit të shoqërive evropiane. Ne mund të vazhdojmë të flasim për asimilimin, integrimin dhe izolimin, por ato janë ende koncepte të zbrazëta, përderisa nuk e dimë sa duhet subjektin për të cilin po flasim, qoftë literalisht qoftë filozofikisht. Me fjalë të tjera, kush është ky mysliman të cilin duam ta asimilojmë, integrojmë ose ta izolojmë? Pa një përkufizim të qartë të këtij entiteti (kush), këto tri koncepte mund të bartin domethënie të njëjtë, duke përçuar perceptime të ndryshme lidhur me kuptimin dhe përmbajtjen e identitetit mysliman. Për më tepër, nga pikëpamja islame, përdorimi i konceptit të subjektit nuk është në asnjë mënyrë aksidental. Që myslimanët të kuptojnë se kush dhe çfarë janë dhe çka përfaqësojnë, ata duhet të jenë në gjendje ta përkufizojnë identitetin e tyre për se, në pajtim me referencat e tyre islame dhe jo përmes imazhit që të tërit kanë për ta si objekt i ndonjë elaborimi të huaj. Vetëm

[10] Abdulhamdi A. Ebu Sulejman, *Botëkuptimi kuranor një pikënisje për reformë kulturore*, përkthehu Festime Mehdiu, Logos-A, Shkup, f.144.

në këtë mënyrë së vepruari, myslimanët evropianë mund të ndiejnë se janë subjekt i historisë së tyre, llogaridhënës para Zotit dhe të përgjegjshëm para njerëzimit. Të jesh subjekt i historisë do të thotë të shkosh përtej këtyre ndjenjave të dëmshme, të të qenit i huaj, i ndryshëm dhe shfaqje e dukshme e një problemi të pazgjidhshëm. Me një vetëdije të qartë të identitetit, myslimanët evropianë, do të zhvillojnë një ndjesi të re, të bazuar në vetëbesim të rrënjosur dhe kjo do t'u mundësojë atyre të kuptojnë se prania e tyre mund të jetë pozitive, se munden që Evropës t'i ofrojnë më tepër përshpirtshmëri dhe ndjenjë të fortë të drejtësisë dhe vëllazërisë, si dhe përfshirje më të madhe në solidaritet. Në dritën e diskutimit tonë të mëparshëm, lidhur me pesë fushat esenciale të Islamit (*el-mesalih el-hamse*) dhe dëshmisë (shehadeti), mund të identifikojmë pesë elemente ose dimensione, të cilat, së bashku, mund të ofrojnë përmbajtje të përshtatshme për konceptin e identitetit mysliman. Në fakt, bëhet fjalë për çështjen e nxjerrjes së thelbit të këtij identiteti jashtë rastësisë së këtij aktualizimi në një hapësirë ose kohë specifike. Me fjalë të tjera, objekti dhe qëllimi jonë është ta dallojmë Islamin nga kultura, traditat ose zakonet arabe ose aziatike, në mënyrë që të konceptojmë se në ç'mënyrë mund të portretizohet imazhi i myslimanit evropian.

## Besimi, praktika dhe spiritualiteti

Elementi i parë dhe më i rëndësishëm i identitetit mysliman është besimi, që paraqet shenjën e brendshme se njeriu beson te Krijuesi i pashoq. Kjo është domethënia e konceptit qendror të tevhidit, besimit në ndjeshmërinë e Zotit, që kon-

firmohet dhe dëshmohet nga shehadeti. Në këtë kuptim, është shprehja më e kthjellët e thelbit të identitetit mysliman përtej hapësirës dhe kohës. Kjo, natyrisht se merr formë konkrete në praktikimin e adhurimeve (namazi, zeqati, agjërimi etj.). Lidhur ngushtë me këto dy realitete, si rezultat i menjëhershëm i tyre në jetën e besimtarit, ai përbën dimensionin themeltar të spiritualitetit. Spiritualiteti ose përshpirtshmëria është kujtesë, përkujtim dhe përpjekje e brendshme për të luftuar kundër prirjes njerëzore natyrore për të harruar Zotin, domethënien e jetës dhe botën e ardhshme. Të gjitha praktikat e përshkruara në Islam, në fakt janë mënyrë e rikujtimit *(dhikr):*

إِنَّنِي أَنَا اللَّهُ لَا إِلَٰهَ إِلَّا أَنَا فَاعْبُدْنِي وَأَقِمِ الصَّلَاةَ لِذِكْرِي

***"Vërtet, vetëm Unë jam Allahu, nuk ka zot tjetër pos Meje, pra Mua më adhuro dhe fal namazin për të më kujtuar Mua."*** *(Ta Ha, 14).*

Përsosmëria, e përkufizuar si sjellje ideale e myslimanit do të thotë të arrish gjendjen e mos harrimit. Profeti a.s., në hadithin e gjatë të Xhibrilit a.s., që e transmeton Omer ibën Hatabi, rreth përsosmërisë thotë: "Të adhurosh Zotin sikur e sheh atë, ndonëse ti nuk e sheh atë Ai të sheh ty!"[11] Kjo d.m.th. të jesh me Zotin në çdo çast e gjendje.[12]

Besimi në Zotin shpesh shihet si burimi më i thellë i kuptimit të drejtësisë dhe dhembshurisë, duke i dhënë moralit një themel të palëkundur dhe një përmasë të shenjtë. Për shumë njerëz, ky besim krijon një sistem vlerash, që nuk varet nga

[11] Sahihu'l Buhari, nr. 50.

[12] Tarik Ramadani, *Të jesh musliman evropian*, Sira, Prishtinë, 2021, f. 287.

normat kalimtare ose presionet sociale, por nga një marrëdhënie me Zotin që ofron një udhëzim të qëndrueshëm dhe kuptimplotë. Në këtë kontekst, besimi në Zotin nuk është thjesht një aspekt personal shpirtëror, por një burim moral që ndikon në sjelljen dhe veprimet e njeriut në çdo hap të jetës. Ky besim i mëson njerëzit të zhvillojnë virtyte të tilla si, ndershmëria, drejtësia dhe mëshira, duke i parë këto vlera si urdhëresa hyjnore që duhen respektuar jo vetëm për hir të përfitimeve personale, por për hir të përmbushjes së një detyrimi të lartë. Përveç kësaj, ndikimi i besimit në Zotin është i dukshëm edhe në përpjekjet e njerëzve për t'i shërbyer shoqërisë dhe për të kontribuar në të mirën e përgjithshme. Kur morali bazohet në besimin në një Krijues të drejtë dhe të gjithëdijshëm, motivimi për të ndihmuar të tjerët dhe për të mbrojtur drejtësinë merr një dimension të përjetshëm dhe të paprekshëm nga interesat e ngushta. Në vend që të udhëhiqet nga interesat personale ose nga normat e imponuara të shoqërisë, individi është i motivuar nga një ndjenjë e përmbushjes shpirtërore dhe e përgjegjësisë së thellë që e lidh atë me Zotin. Një aspekt tjetër i rëndësishëm është ndikimi i besimit në formësimin e moralit kolektiv, ku besimi në Zotin krijon një kuadër të përbashkët të vlerave që i lidh njerëzit përtej dallimeve të tjera dhe i drejton ata drejt qëllimeve të përbashkëta. Kjo bashkësi morale e mbështetur në besimin në Zot promovon ndjenjën e unitetit dhe të respektit të ndërsjellë, duke u bërë një bazë për një shoqëri më humane dhe të drejtë. Personaliteti islam është një sistem i integruar i cilësive dhe karakteristikave që ndërtojnë identitetin e individit mysliman në aspektin intelektual, emocional dhe atë të sjelljes. Ky sistem përfshin një sërë elementesh si vlerat, normat mo-

rale, sjelljet dhe qëndrimet, të cilat ndërveprojnë vazhdimisht dhe përshtaten sipas rrethanave. Këta përbërës janë të ndikuar nga besimi islam dhe udhëzimet e sheriatit, të cilat synojnë të ndërtojnë një personalitet të ekuilibruar që karakterizohet nga besimi i thellë në Zotin dhe përkushtimi ndaj parimeve të Islamit.[13]

Pejgamberët ishin modeli i ndryshimit. Zoti në Kuran dhe në jetën e profetëve, e ka përcaktuar me shembuj konkrete se si mund të realizohet ndryshimi. Profetët që kanë përgjegjësi shpjegimin dhe interpretimin e fesë së Allahut, kanë treguar në mënyrën më të bukur se si mund të ndryshojë individi dhe shoqëria për hir të Allahut.[14] Duke sjellë aspirata të tilla në qendër të vetëdijes tonë, botëkuptimi kuranor na udhëzon në atë mënyrë që të bëhet fokusi ynë dhe burimi i frymëzimit që ngre mendjen dhe zemrat tona dhe na bekon me paqe dhe lumturi të brendshme gjatë përpjekjeve tona.[15] Para urdhrit të Tij përulen të gjitha kokat, para Madhështisë se Tij nënshtrohen fytyrat, Atë e lavdërojnë të gjitha gjuhët, ndërsa gjykimit dhe urtësisë së Tij i nënshtrohen të gjitha zemrat, mendjet dhe trupat. Zemrat kthehen me dashuri të plotë vetëm nga Ai.

---

[13] Adnan Mustafa Hatatba, *Bunjetu esh sh'shahsije el islamije ve muhadidatiha ve simatiha, Journal of Islamic Studies,* King Saud University, Vol. 25, no. 1, Riad, 2009, p.54. https://jis.ksu.edu.sa/sites/jis.ksu.edu.sa/files/0025-01-07.pdf

[14] Ramazan Tamer Büyükküpçü, *Ta jetosh jetën sipas Islamit,* Alsar, Tiranë, pa vit botimi, f. 25.

[15] Abdulhamid A. Ebu Sulejman, *Botëkuptimi kuranor, një pikënisje për reformën kulturore*, Logos-A, Shkup, 2011, f. 144.

Allahu i Madhërishëm është i Vetmi i Përsosur e i Përkryer dhe zemrat e duan Atë.[16]

## Përfundim

Besimi në Zotin dhe ndikimi i Tij në formësimin dhe predikimin e moralit shpjegon se si besimi në Zotin xh.sh., ndikon në zhvillimin e parimeve morale të individit dhe shoqërisë. Ky besim formëson një standard moral të qëndrueshëm, duke e orientuar njeriun drejt të mirës dhe drejtësisë. Në traditën islame, si dhe në shumë fe të tjera, besimi në Zotin xh.sh., përbën një burim të fuqishëm të moralit, ku individi nxitet të respektojë parimet e drejta dhe të veprojë me ndershmëri dhe mëshirë. Besimi dhe bindja në Krijuesin gjithashtu ndikon në predikimin e moralit, duke e bërë atë një çështje misioni dhe përgjegjësie për të shpërndarë vlerat e larta morale në shoqëri. Besimi i thellë në Zotin i ndihmon besimtarët të përballojnë vështirësitë e jetës me integritet moral dhe të mbajnë qëndrueshmëri në parimet e tyre etike, pavarësisht ndryshimeve të kohës apo presioneve të përkohshme. Në këtë mënyrë, besimi në Zotin, jo vetëm që ndikon në formësimin e moralit individual, por gjithashtu frymëzon një moral kolektiv që synon përmirësimin e përgjithshëm të shoqërisë dhe promovon një jetë të ndershme dhe me qëllime të larta.

[16] Jusuf Kardavi, *El Islam el'ledhi ned'u ilejhi*, Muesesetu rrislale, Bejrut, 2000, f.19.

**Sedat ISLAMI**

# VEPRAT DHE VIRTYTET E NJERËZVE MË TË MIRË DHE MË TË DALLUAR SIPAS MËSIMEVE PROFETIKE

## HYRJE

Në Islam, më shumë se çdo gjëje tjetër, përparësi u jepet vlerave. Njerëzit vlerësohen për vlerat dhe virtytet që kanë, jo pse janë të bardhë a të zi, flasin këtë apo atë gjuhë, i përkasin kësaj apo asaj shtrese. Allahu i Madhëruar na mëson kështu në Kuran:

﴿ إِنَّ أَكْرَمَكُمْ عِندَ اللَّهِ أَتْقَاكُمْ ﴾

***"...Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij..."*** *(Huxhurat, 13).*

Këtë parim hyjnor e gjejmë edhe në mësimet profetike. Profeti Muhamed a.s. ua bëri me dije njerëzve, duke përfshirë këtu në radhë të parë familjarët më të afërm të tij, se feja që predikonte nuk ngrit apo ul askënd në baza të tjera, përveç atyre të besimit dhe vlerave. Njerëzit nuk vlerësohen sipas fizikut të tyre, por sipas zemrave,[1] pra vlerave. Njerëzit nuk gradohen sipas prejardhjes, por sipas veprave.

---

[1] Shih si dëshmi hadithin nr. 2564 në *Sahihun* e Muslimit.

﴿ وَمَن بَطَّأَ به عَمَلُهُ، لَمْ يُسْرِعْ به نَسَبُهُ ﴾

***"...e atë që vepra e ngadalëson, prejardhja nuk ka për ta shtyrë përpara."*[2]**

Njerëzit nuk vlerësohen pse janë arabë apo të tjerë,[3] ata vlerësohen për vlerat që përqafojnë. Me këto mësime e vlera janë edukuar myslimanët përgjatë gjithë historisë. Selman Farisiu r.a., i shkruante Ebu Derdasë r.a., më të cilin ishin vëllazëruar: "Toka nuk e shenjtëron askënd, janë veprat ato që e shenjtërojnë njeriun."[4] Pra, nuk ka rëndësi ku ke lindur e ku jeton, por çfarë vlerash përfaqëson e çfarë veprash bën. Mund të jetosh në vend të shenjtë e të jesh mëkatar i madh, apo edhe në vend të rëndomtë e të jesh evlia i Zotit.

Ky koncept, në formimin shpirtëror, edukativ e personal të besimtarëve, e ka rëndësinë e vet, pasi që ata nuk do të përmenden pse janë bijë e bija të dikujt, por për posedimin e vlerave dhe autorësinë e veprave.

Ky punim në fokus ka vlera dhe vepra, të cilat vlerësojnë në shkallë superiore besimtarët dhe i promovojnë ata në grada të larta te Zoti i Madhëruar. Sa për ilustrim, do t'i referohemi një sërë tekstesh profetike, për të mësuar se çfarë tiparesh dhe veprash e bëjnë një besimtar të përzgjedhur dhe të dalluar për të mirë nga të tjerët. Punimi nuk mëton të bëjë dallime përulëse ndërmjet besimtarëve, jo, sepse, siç na mëson

---

[2] Hadithin e shënojnë Muslimi, nr. 2699, Ebu Davudi, nr. 3643, etj..

[3] Shih si dëshmi hadithin nr. 313 në *Gajetu el meram,* të cilin e ka saktësuar Albani.

[4] Imam Maliku në *Muvetta*, 2/769, Imam Ahmedi në *Zuhd*, fq. 154.

Profeti ynë a.s.,[5] të gjithë besimtarët janë të mirë, por synon që ta rrisë nivelin e vullnetit dhe gatishmërisë te besimtarët për të shtuar veprat e mira, që ta kultivojë vullnetarizmin ndërmjet nesh dhe që të provokojë garën në punë të mira e të dobishme.

## Çiltërsia shpirtërore

Të jesh besimtar i dalluar kërkohet të kesh nivel të lartë shpirtëror e moral. Ngjitja në majat e fetarisë bëhet me virtyte shpirtërore e morale, me besim të thellë e moral të qëndrueshëm. Abdullah bin Amri r.a., tregon se një njeri e kishte pyetur Profetin a.s.:

أَيُّ النَّاسِ أَفْضَلُ؟ قَالَ: كُلُّ مَخْمُومِ الْقَلْبِ صَدُوقِ اللِّسَانِ. قَالُوا: صَدُوقُ اللِّسَانِ نَعْرِفُهُ، فَمَا مَخْمُومُ الْقَلْبِ؟ قَالَ: هُوَ النَّقِيُّ، التَّقِيُّ، لَا إِثْمَ عَلَيْهِ، وَلَا بَغْيَ، وَلَا غِلَّ، وَلَا حَسَدَ

*"Cili është njeriu më i mirë?" Profeti a.s. i tha: "Njeriu më i mirë është ai që ka zemër mahmum dhe gjuhë të pastër e të sinqertë."*

*"Ky që ka gjuhë të pastër e që e thotë të vërtetën po e dimë kush është, por ky që ka zemër mahmum kush është?" - e pyetën.*

*"Është zemra e pastër, e devotshme, në të cilën nuk ka mëkat, as padrejtësi, as urrejtje dhe as zili" - iu përgjigj.*[6]

---

[5] "Besimtari i fuqishëm është më i mirë dhe më i dashur tek Allahu se besimtari i dobët, edhe pse që të dy kanë të mira..." Shih: *Sahihu* i Muslimit, nr. 2664.

[6] Hadith i saktë. Shih: *Sahihu el Xhami,* nr. 3291.

Në këtë përkufizim profetik për zemrën e pastër, shohim se si i është dhënë rëndësi dy elementeve: çiltërisë në raport me Zotin, Krijuesin, dhe korrektësisë, respektivisht moralit dhe sjelljeve të mira në raport me krijesat. Nuk mund të imagjinohet një njeri të jetë i mirë, ndërsa brenda zemrës ka ngarkesa toksike të shtirjes, synimit të famës, urrejtjes, smirës, inatit. Kjo sepse, siç edhe do të shohim në tiparet dhe veprat e mëposhtme, të jesh në këto grada nënkupton të dallohesh për principe dhe praktika të dëlira dhe pozitive. Duhet ta synosh kënaqësinë e Allahut, të bësh mirë për Zotin, jo që të të përmendet emri, të bësh mirë pavarësisht se si sillen të tjerët me ty, të jesh i drejtë, t'ua duash të mirën dhe të jesh në shërbim të njerëzve, etj.. Ky hadith synon zemrën shpëtuese, zemrën e pastër sipas botëkuptimit kuranor,[7] e cila korrektësinë e ka të përgjithshme, me Zotin, Krijuesin, në radhë të parë, e pastaj edhe me krijesat e Tij, njerëzit me theks të veçantë, ndaj të cilëve nuk ushtrohet padrejtësi. Është kjo zemra që na shpëton në Ahiret:

﴿ يَوْمَ لَا يَنفَعُ مَالٌ وَلَا بَنُونَ ﴿٨٨﴾ إِلَّا مَنْ أَتَى اللَّهَ بِقَلْبٍ سَلِيمٍ ﴿٨٩﴾

***"Në Ditën, kur askujt nuk do t'i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët, përveç atij që vjen me zemër të pastër tek Allahu!"*** *(Shuara, 88-89).*

Përgjatë shtjellimeve në vazhdim do të shohim se si ky nivel i besimit dhe fetarisë, pra të qenët besimtari më i mirë, sillet rreth këtyre parimeve dhe vlerave.

---

[7] Parafrazuar nga: Ali bin Sulltan Muhamed, *Mirkat el mefatih sherhu Mishkat el mesabih*, (Bejrut: Dar el fikr, 2022), 8/267-268.

# Virtytet më të larta të moralit

Fetaria e vërtetë nuk është pretendim, por praktikë. Të jesh në piedestalin e besimtarëve më të mirë nënkupton që duhet të dallohesh jo vetëm për përkushtimin për adhurime, por edhe për vlerat dhe virtytet. Kjo për faktin se këto të fundit janë fryt dhe produkt i adhurimeve, prandaj personaliteti i besimtarit vlerësohet sipas tyre. Virtytet tregojnë për nivelin e fetarisë dhe për pozitën që besimtari ka tek Allahu i Madhëruar. Profeti Muhamed a.s. ka thënë:

إِنَّ خِيَارَكُمْ أَحَاسِنُكُمْ أَخْلَاقًا

*"Vërtet, më i zgjedhuri ndër ju është ai me moralin më të mirë."*[8]

Morali i mirë është mënyra se si besimtari arrin te dashuria e Allahut të Madhëruar, sepse: *"Robi më i dashur për Allahun është ai me moralin më të mirë."*[9] Në mësimet profetike ne nuk gjejmë vetëm hadithe, që trajtojnë parimisht këtë çështje, por gjejmë edhe shembuj konkretë të këtij morali që besimtarin e ngrit në grada të larta. Ja një shembull. Profeti Muhamed a.s. ka thënë:

فَإِنَّ خَيْرَكُمْ أَحْسَنُكُمْ قَضَاءً

*"...Më i miri ndër ju është më korrekti në shlyerjen e borxhit."*[10]

---

[8] Hadithin e shënojnë Buhariu në *Sahih*, nr. 3559, dhe Muslimi në *Sahih*, nr. 2321.

[9] Sahih el Xhami, nr. 179.

[10] Hadithin e shënojnë Buhariu në *Sahih*, nr. 2306, dhe Muslimi në *Sahih*, nr. 1601.

Jo rrallë ne shohim se si vonimi i pajustifikueshëm i borxhit është shkak për sherre e bela ndërmjet njerëzve duke iu kushtuar madje ndonjëherë edhe me jetë. Prandaj, vlerat fetare dhe morali janë ato që na duhen për një jetë të qetë, shpirtërore e shoqërore. Këtu qëndron arsyeja pse të parët tanë fenë nuk e trajtonin si teori a koncept filozofik, por si praktikë, si moral, si diçka me të cilën e adhuronin Allahun e Madhëruar dhe rregullonin raportet ndërmjet vete. Omeri r.a., thoshte: "Le të mos iu mashtrojnë namazi dhe agjërimi i askujt. Po deshët ta vlerësoni dikë, shikoni se kur flet a e thotë të vërtetën, kur t'i lihet diç në amanet a e çon në vend, dhe kur të ngritët në pozitë, a tregohet i devotshëm."[11]

## Etika dhe sjellja

Morali islam nuk është filozofik dhe as kompleks. Është i thjeshtë dhe praktik. Të jesh njeri me virtyte të larta nënkupton të kesh një personalitet paqësor, të atillë që njerëzit shohin vetëm mirësi te ti dhe asnjëherë rrezik a kërcenim. Profeti Muhamed a.s. ka thënë:

خيرُكم مَنْ يُرْجَى خيرُهُ، ويُؤْمَنُ شرُّهُ

*"Më i miri ndër ju është ai në mirësinë e të cilit shpresohet dhe nga e keqja e të cilit nuk kihet frikë."*[12]

Formimi i një personaliteti të këtillë të besimtarit është falë mësimeve të shumta profetike, të cilat myslimanin e për-

[11] Ebu Davudi, *Ezzuhd*, fq. 80.

[12] Hadithin e shënojnë Tirmidhiu në *Sunen*, nr. 2263, dhe Ahmedi në *Musned*, nr. 8812. Albani e ka saktësuar këtë hadith.

kufizojnë si qytetar paqësor, që nuk fyen të tjerët dhe as që i dëmton fizikisht,[13] që ua paraprinë me përshëndetje, që iu buzëqesh në fytyrë, e gjëra të këtilla që te tjetri, qysh në momentin e takimit me besimtarin përçojnë mesazhe paqeje e mirëdashëse, e assesi kërcënuese e dashakeqëse. Dikush e kishte pyetur Profetin Muhamed a.s. për *Islamin më të mirë,* për çka kishte thënë:

تُطْعِمُ الطَّعَامَ، وتَقْرَأُ السَّلَامَ علَى مَن عَرَفْتَ، وعلَى مَن لَمْ تَعْرِفْ

*"(Islami më i mirë është që) Të ushqesh të tjerët dhe ta përshëndesësh me selam këdo që takon, e njohe apo jo."*[14]

Siç mund ta shohim, këtu nuk kemi të bëjmë me personalitet neutral ndërmjet të mirës dhe të keqes. Nëse do të bënim ndonjë pozicionim, atëherë do të ishte ndërmjet të mirës dhe më të mirës. Kjo qasje pozitive e besimtarit ka dhe një dimension tjetër, atë të treguesit të përzgjedhjes hyjnore. Profeti Muhamed a.s. ka thënë: "Allahu ka disa robër, të cilët i ka veçuar me mirësi për t'iu bërë mirë njerëzve, mandatin e të cilëve e miraton për aq kohë sa ata e shpenzojnë (pasurinë për këtë qëllim). Ndryshe, nëse ndodhë që ata të mos e japin (pasurinë), atëherë Ai i privon prej saj dhe atë ua bartë të tjerëve."[15]

Pra, ata nxiten të vazhdojnë me këto sjellje dhe këtë mirëdashësi, sepse ajo tregon për pozitën e tyre te Zoti. E kurdo që largohen prej saj, rrezikojnë të humbasin këtë pozitë.

---

[13] Shih: *Sahihu* i Buhariut, nr. 10; *Sahihu* i Muslimit, nr. 40.

[14] *Sahihu* i Buhariut, nr. 12; *Sahihu* i Muslimit, nr. 39.

[15] Albani në *Es Silsiletu-s Sahihah*, nr. 1692, sipas dëshmive, e vlerëson në gradën *hasen*.

# Mirësjellja me gruan, fqinjët dhe shokët

Besimtari dallon për sjelljet dhe raportet e mira me të gjithë, e më së shumti me familjen e tij. Raportet me familjen në fakt janë edhe matës i fetarisë dhe moralit të tij. Jo rastësisht është zgjedh që pikërisht ky raport ta ngritë ose ulë atë. Profeti Muhamed a.s. ka thënë:

خَيرُكم خَيرُكم لأهلِه

*"Më i miri në mesin tuaj është më i miri për gruan e vet."*[16]

Në këtë hadith, Profeti a.s. na porosit që mirësjelljen në radhë të parë ta tregojmë me gruan,[17] e pastaj me të tjerët. Kjo dëshmon për kujdesin islam për femrën dhe të drejtat e saj. Jo rastësisht ndër këshillat e shumta që Profeti Muhamed a.s. ka dhënë, kanë qenë edhe ato për mirësjelljen me gratë.

Por kjo mirësjellje përfshinë të gjithë, qofshin ata që janë brenda, apo edhe jashtë shtëpisë. Përfshin edhe të huajt.[18] Përfshin edhe fqinjët dhe shokët. Kushdo që lexon në tekste fetare e ka të qartë se sa feja islame i kushton rëndësi fqinjëve dhe shokëve. Të parët i ka trajtuar me aq kujdes të shtuar, saqë gati i ka bërë trashëgimtarë në familje,[19] ndërsa për të

---

[16] Se me (ar. *ehl)* synohet gruaja, shih: Hasan bin Ali Fejumi, *Fet'hu el Karibi el Muxhib ala et Tergibi ve et Terhib lil Imami el Mundhiri*, red. shkenc. dr. Muhamed Ishak Muhamed al Ibrahim, (Riad: Dar es Selam, 2018), 8/527; Ali bin Sulltan Muhamed, *Mirkat el mefatih sherhu Mishkat el mesabih*, vep. cit., 5/125.

[17] Albani në *Sahih el Xhami,* nr. 3316, e saktëson.

[18] Shih: Ali bin Sulltan Muhamed, *Mirkat el mefatih sherhu Mishkat el mesabih*, vep. cit., 5/125.

[19] *Suneni* i Ebu Davudit, nr. 4833; *Suneni* i Tirmidhiut, nr, 2378; *Musnedi* i Ahmedit, nr. 8398.

dytët, shokët, ka deklaruar se *njeriu ka fenë që ka shoku i vet.*[20] Nga këtu nuk është çudi që ne ta gjejmë të dashurin tonë, Profetin Muhamed a.s., tek na këshillon që të kujdesemi për fqinjët dhe shokët, sepse kështu bëhemi besimtarët më të mirë.

خيرُ الأصحابِ عندَ اللهِ خيرُكم لصاحبِه، و خيرُ الجيرانِ عندَ اللهِ خيرُكم لجارِه

*"Tek Allahu, shoku më i mirë është më i miri për shokun e vet, dhe fqinji më i mirë është më i miri për fqinjin e vet."*[21]

## Reputacioni dhe personaliteti motivues

Njerëzit mund të bëjnë vepra të mira edhe pa folur fare. Mund t'i nxisin të tjerët të bëjnë vepra të mira edhe pa ua thënë asnjë fjalë. Kjo ndodhë kur ata kanë brendësi të pastër dhe të çiltër, të atillë që rrezaton mirësi, që i bën njerëzit të mendojnë rreth Zotit dhe fesë. Këta njerëz janë ata që listohen në mesin e më të mirëve. Profeti Muhamed a.s. ka thënë:

خِيَارُكُمُ الَّذِينَ إِذَا رُءُوا ذُكِرَ اللَّهُ عز وجل

*"Njerëzit më të mirë në mesin tuaj janë ata që kur të shihen, i bëjnë të tjerët ta përmendin Allahun e Madhëruar."*[22]

---

[20] *Sahihu* i Buhariut, nr. 6014; *Sahihu* i Muslimit, nr. 2624.

[21] Albani në *Sahih el Xhami,* nr. 32706, e saktëson.

[22] *Suneni* i Ibën Maxhes, nr. 4119. Albani e ka vlerësuar si hadith *sahih li gajrihi*.

Janë të këtillë për shkak të shenjave të devotshmërisë, për shkak se e përmendin Allahun e Madhëruar me gjuhë e në çdo gjendje.[23] Pra, pamja e tyre prej burrave fetarë, të matur e të kujdesshëm, i bënë që të tjerët ta përmendin Allahun e Madhëruar posa t'i shohin ata. Kjo mbase edhe për faktin se dhikri - përmendja e shpeshtë e Zotit, është prej veprave që besimtarin e lartësojnë në këtë pozitë. Dikush e kishte pyetur Profetin a.s. për veprën më të mirë, ndërsa ai i kishte thënë: "Ta braktisësh këtë dynja teksa gjuha jote të jetë e lagur me përmendjen e Zotit."[24]

## Lidershipi i drejtë

Një nga veprat më të mira që një besimtar mund të bëjë dhe të cilat e ngrenë dhe afirmojnë është udhëheqja me drejtësi. Jo rastësisht lideri i drejtë është zgjedhur, jo vetëm në mesin e shtatë grupeve të njerëzve që gëzojnë privilegjin e të qenit nën hijen e Arshit të Zotit në Ditën e Llogarisë, por edhe t'i prijë kësaj liste.[25] Dhe jo rastësisht lideri i mirë është i përzgjedhuri në mesin e ymetit. Profeti Muhamed a.s. ka thënë:

خِيارُ أئِمَّتِكُمُ الَّذِينَ تُحِبُّونَهُمْ ويُحِبُّونَكُمْ، ويُصَلُّونَ علَيْكُم وتُصَلُّونَ عليهم

*"Prijësit më të mirë nga mesi juaj janë ata që i doni dhe ju duan, luten për ju dhe luteni për ta..."*[26]

---

[23] Muhamed bin Ismail Sanani, *Et tenvir sherhu el Xhami'i es Sagir*, red.. shkenc. dr. Muhamed Ishak Muhamed Ibrahim, (Riad: Mektebetu Dar es Selam, 2011), 4/381.

[24] *Es silsiletu es Sahihah,* 4/452.

[25] Shih: *Sahihu* i Buhariut, nr. 660; *Sahihu* i Muslimit, nr. 1031.

[26] *Sahihu* i Muslimit, nr. 1855.

Siç është shpjeguar, arsyeja e krijimit të këtij raporti ndërmjet liderëve dhe popullit, qëndron në përmbushjen e detyrimeve përkatëse që kanë karshi njëri-tjetrit.[27]

## Përkushtimi shkencor dhe intelektual

Dituria është çelës i Islamit, është e mirë për të cilën njerëzimi duhet t'i jenë falënderues. Jo vetëm për konceptet, por edhe për praktikat.[28] Islami është feja që kërkimin dhe shpërndarjen e diturisë e ka ngritur në nivele adhurimi. Por jo për çdo dituri. Profeti Muhamed a.s. ka përmendur dy lloje të diturisë: të dobishme dhe të dëmshme.[29] Dituria të cilën e synojmë ne këtu është gjithsesi e dobishmja, e madje më e dobishmja. Është dituria dhe përkushtimi për Librin e Zotit, Kuranin fisnik. Profeti Muhamed a.s. ka thënë:

خَيْرُكُمْ مَنْ تَعَلَّمَ الْقُرْآنَ وعَلَّمَهُ

*"Më i miri prej jush është ai që e mëson Kuranin për vete dhe ua mëson të tjerëve."*[30]

---

[27] Shih: Ahmed bin Omer el Kurtubi, *El mufhim lima eshkele min telhisi kitabi Muslim*, red. shkenc. Muhjidin Dib Misto - Ahmed Muhamed Sejid – Jusuf Ali Bedevi - Mahmud Ibrahim Bezzal, Bejrut - Damask: Dar Ibën Kethir dhe Dar el Kelim et Tajib, 1996), 4/65; Safijurrahman Mubarekfuri, *Minnetu el Mun'im fi sherhi Sahihi Muslim*, (Rijad: Dar es Selam, 1999), 3/264-265.

[28] Islamit dhe myslimanëve bota mbarë i detyrohet për bartjen e shkencave. Will Durant në *Kissatu el hadare*, 13/180, shkruan: "Përcjellja e shkencave të grekëve në Evropë, e të cilat në fakt janë marrë nga Lindja, është mbase ngjarja më madhështore dhe më domethënësja në historinë botërore."

[29] Në hadith qëndron: "Luteni Allahun për dije të dobishme dhe kërkoni mbrojtje tek Ai nga dija e padobishme." Shih: *Sahihu Ibni Maxheh*, nr. 3114. Hadithi është hasen.

[30] *Sahihu* i Buhariut, nr. 5027.

Ky hadith profetik është vërtet madhështor. Në të fshihet aftësia profetike për të përmbledhur kuptime të thella me pak fjalë. Hadithi përveçqë shpalos dimensionin e diturisë së kërkuar, shpalos edhe dimensionin e personalitetit shoqëror të besimtarit, i cili nuk angazhohet për të qenë vetëm i mirë, *salih*, por edhe reformues, *muslih*. Pra, nuk mendon vetëm për vete, por edhe për të tjerët, sepse këto vlera e përfaqësojnë në mënyrën më origjinale besimtarin, në bindje dhe praktika. Besimtari i vërtetë atë që e do për vete, ua do edhe të tjerëve.

Prandaj përkushtimi për dijen vlerësohet edhe ndaj adhurimeve vullnetare.[31] Përkushtimi për dijen është vepër me shpërblim rrjedhës edhe pas vdekjes.[32]

## Angazhimi pozitiv dhe vullnetarizmi

Tipar për të cilin dallojnë besimtarët më të mirë është edhe angazhimi i tyre produktiv në shoqëri. Ata, jo vetëm që nuk janë barrë e shoqërisë, porse punojnë që barra shoqërore të lehtësohet. Këtë e bëjnë nëpërmjet angazhimit të tyre që mirëqenia me dimensionet e saj morale dhe materiale të mbretërojë në shoqëri. Profeti Muhamed a.s. ka thënë:

---

[31] Ebu Derda r.a., ka thënë: "Meditimi i një ore është më i mirë se namazi (vullnetar) i një nate." Ebu Davud, *Ezzuhd*, f. 191. Sufjan Theuriu ka thënë: "Nuk di për adhurim më të mirë se t'ua mësosh njerëzve dijen." *Xhamiu bejani-l ilm*, 1/124.

[32] Profeti Muhamed a.s. ka thënë: "Kur të vdes njeriu i ndërpritet përfitimi nga veprat përveç në tre raste: nga lëmosha rrjedhëse, nga dituria e dobishme që ka lënë pas vete dhe nga fëmija i mirë që lutet për të." *Sahihu* i Muslimit, 1631.

خيرُكُمْ مَنْ أَطْعَمَ الطعامَ، وردَّ السلامَ

*"Më i miri prej jush është ai që ushqen të tjerët dhe e kthen selamin."*[33]

Këto dy cilësi të përmendura këtu përfshijnë angazhimin material dhe moral të besimtarit për shoqërinë. E para manifestohet duke dhënë lëmoshë, duke u solidarizuar me të tjerët në raste nevoje dhe jo vetëm. Ushqimi jepet edhe për t'ua fituar zemrat njerëzve. Jo rastësisht nderimi i mysafirit është dëshmi e besimit.[34] E dyta duke iu dhënë selam, duke iu treguar qasjen integruese e jo përjashtuese, synimet paqësore e jo armiqësore, sjelljet e kulturuara e jo devijuara.

Kjo qasje e besimtarit të mirë i jep kuptim edhe jetës. Të jetosh e të jesh barrë është e rëndë. Të jetosh e të jesh krah për shoqërinë është mirësi. Jeta e gjatë me këtë qasje është tipar tjetër që i dallon besimtarët më të mirë. Profeti Muhamed a.s. ka thënë:

خيرُ الناسِ مَنْ طالَ عُمرُهُ وحَسُنَ عملُهُ

*"Njeriu më i mirë është ai që jeton më së gjati dhe bën vepra të mira."*[35]

Pra, sa më gjatë që të jetojë, ai shton veprat e mira dhe nuk ndalet. Ai përfiton nga secila ditë e re e jetës, nga secila mundësi, që të shtojë të mirat, që të bëjë vepra që rrojnë edhe pas tij, që të bëjë vepra, mirësia e të cilave prek të tjerët. Kjo

[33] Albani në *Sahih el Xhami*, nr. 3318, e vlerëson në gradën *hasen*.

[34] Profeti Muhamed a.s. ka thënë: "Kush beson në Allahun dhe në Ditën e Fundit, le ta nderojë mysafirin!" Buhariu, nr. 6018; Muslimi, nr. 47.

[35] Albani në *Sahih et Tirmidhij*, nr. 2330, e vlerëson në gradën *sahih li gajrihi*.

për shkak se të jesh i mirë nënkupton detyrimisht të jesh i dobishëm për të tjerët. Profeti Muhamed a.s. ka thënë:

خيرُ الناسِ أنفعُهم للناسِ

*“Njeriu më i mirë është më i dobishmi për njerëzit.”*[36]

Ky angazhim produktiv i besimtarit është absolutisht vullnetar. Ai bëhet për ta fituar kënaqësinë e Allahut. Kjo ndikon në shtimin e aktivitetit vullnetar, sepse nuk ka motiv më të madh për dikë që angazhohet vullnetarisht se ta dijë se puna e tij vlerësohet te Krijuesi.

﴿ وَيُطْعِمُونَ الطَّعَامَ عَلَىٰ حُبِّهِ مِسْكِينًا وَيَتِيمًا وَأَسِيرًا ﴿٨﴾
إِنَّمَا نُطْعِمُكُمْ لِوَجْهِ اللَّهِ لَا نُرِيدُ مِنكُمْ جَزَاءً وَلَا شُكُورًا ﴿٩﴾

***“Ata i ushqejnë të varfrit, jetimët dhe të zënët rob edhe pse vetë janë nevojtarë, duke thënë: “Ne ju ushqejmë vetëm për hir të Zotit. Për këtë, nuk duam shpërblim e as falënderim.”*** *(Insan, 8-9).*

## Përfundim

Këto ishin vetëm disa ilustrime nga tiparet dhe veprat që i ngritin dhe lartësojnë njerëzit në pozitat më të larta. Siç pamë, ato sillen rreth vlerave dhe moralit më shumë se rreth adhurimeve. Kjo për faktin se adhurimet, jo vetëm që janë të nënkuptuara si veprat më të mira, sepse me anashkalimin e tyre besimtari zbret në nivele të mëkatit, porse janë edhe filtra moral e edukativë. Morali i mirë dhe tërë këto sjellje të

[36] Albani në *Sahih el Xhami,* nr. 3289, e vlerëson në gradën *hasen*.

mira reflektojnë nga përkushtimi i thellë në adhurim. Janë fryt i adhurimit.

Këto tipare na rikujtuan rolin produktiv që besimtari duhet ta ketë në shoqëri. Pra, nuk bëhet fjalë për teori e koncepte, por për praktika morale, për sjellje konkrete. Mirësia, sipas fesë, matet me dobinë që të tjerët kanë prej nesh. Në këtë kontekst, e mira më e madhe që mund t'ia bëjmë shoqërisë është t'i thërrasim në rrugën e drejtë, t'iu ndihmojnë ta gjejnë rrugën e Zotit, rrugën e shpëtimit. E këtë duhet ta bëjmë duke ndërtuar fuqishëm personalitetin tonë së pari, duke u bërë sikur ata besimtarët që kur të tjerët i shohin motivohen ta përmendin Allahun e Madhëruar.

Dimension tjetër i tipareve dhe virtyteve të mira që gradojnë besimtarin është efekti i tyre dobiprurës për breza e breza. Shpërndarja e diturisë, si shembull, është ajo që na sjell të mira edhe pas vdekjes.

Këto tipare e vepra portretizojnë në mënyrën më origjinale besimtarin, i cili nuk është i vrazhdë, arrogant, nuk ua kërcënon sigurinë, nuk është i ligë që t'iu shkaktojë shqetësime. Përkundrazi, është i atillë që shpresohet hairi në të, i atillë që udhëzon njerëzit edhe pa folur fare.

Këto tipare e vepra na rikujtojnë përgjegjësinë që kemi në radhë të parë ndaj familjes, e me theks të veçantë ndaj gruas. Ato janë zë i fuqishëm kundër akuzave të pabaza se kinse Islami nxit për ashpërsi ndaj gruas.

**Ekrem SIMNICA**

# BASHKËJETESA PAQËSORE ME TË TJERËT SIPAS ISLAMIT

Nuk ka dyshim se feja islame është një fe, e cila përputhet në tërësi me natyrën e njeriut, prandaj edhe me të drejtë ajo quhet fe e njerëzimit. Nuk i takon të quhet e tillë për hir të dëshirës apo vullnetit të dikujt, por për hir të legjislaturës që përmban ajo. Këtë ligj natyrshëm e pranon mendja e njeriut, ngase ndriçon zemrat, si dhe skalitë besimin në thellësinë e shpirtit. Ky ligj vlen dhe i përshtatet çdo kohe dhe çdo vendi, ngase rregullon çështjet e bashkësisë njerëzore, duke iu siguruar barazi dhe raporte të ngushta ndërmjet vete. Ligji islam ua jep mundësinë atyre të besojnë në botën tjetër, në të cilën do të gëzojnë shpërblim në bazë të veprave të kësaj bote.

Këto dhe shumë të tjera bëjnë që Islami të jetë në përshtatshmëri të plotë me natyrën e njeriut, të jetë fe, që njeriu e përqafon dhe e konsideron atë si një fanar udhëzues në jetën e tij. Madje në këtë mënyrë, njeriu arrin që të ballafaqohet me plot sukses ndaj çfarëdo dyshimi apo sfide të kësaj bote.

Allahu xh.sh. nuk është Zot vetëm për myslimanët, por për të gjithë njerëzit, dhe Islami nuk është fe që është paraqitur me Muhamedin a.s., por është vazhdimësi e shpalljeve hyjnore të mëparshme, të cilat nga jobesimtarët u devijuan. Lidhur me këtë, Allahu xh.sh. e urdhëroi Muhamedin a.s. të thotë:

﴿قُلْ مَا كُنتُ بِدْعًا مِّنَ الرُّسُلِ وَمَا أَدْرِي مَا يُفْعَلُ بِي وَلَا بِكُمْ ۖ إِنْ أَتَّبِعُ إِلَّا مَا يُوحَىٰ إِلَيَّ وَمَا أَنَا إِلَّا نَذِيرٌ مُّبِينٌ﴾

***"Thuaj: "Unë nuk jam risimtar prej të dërguarve, e nuk e di se çka do të bëhet me mua e as me ju, unë nuk ndjek tjetër vetëm atë që më shpallet, unë nuk jam thetër pos i dërguar që ju tërheq vërejtjen qartas."*** *(El Ahkaf, 9).*

Se Islami është fe hyjnore për të gjithë njerëzit pa dallim race, nacionaliteti, vendi a kohe, dhe se ajo vetëm forcon raportet ndërnjerëzore, posedojmë shumë argumente nga Kurani, thëniet dhe veprat e Muhamedit a.s., si dhe nga sqarimet e dijetarëve.

## Nderi

Islami i ka dhënë rëndësi thelbësore qenies së njeriut, si krijesa më e përsosur dhe më e nderuar ndër krijesat e tjera mbi tokë. Zoti xh.sh. thotë:

﴿وَلَقَدْ كَرَّمْنَا بَنِي آدَمَ وَحَمَلْنَاهُمْ فِي الْبَرِّ وَالْبَحْرِ وَرَزَقْنَاهُم مِّنَ الطَّيِّبَاتِ وَفَضَّلْنَاهُمْ عَلَىٰ كَثِيرٍ مِّمَّنْ خَلَقْنَا تَفْضِيلًا﴾

***"Ne, vërtet nderuam pasardhësit e Ademit*** *(njerëzit),* ***u mundësuam të udhëtojnë hipur në tokë e në det, i begatuam me ushqime të mira, i vlerësuam ata*** *(i lartësuam)* ***ndaj shumicës së krijesave që Ne i krijuam."*** *(El Isra, 70).*

Dijetari Muhamed Gazaliu ka thënë: "Njeriu në Islam është ngritur shumë lart, deri në atë përmasë saqë është shpallur zotëri i tokës dhe qiellit, dhe kjo duke pasur parasysh se në të, në njeriun, ngërthejnë dy gjëra nga vetë Krijuesi i Ma-

dhërishëm, e ato janë: shpirti nga shpirti i Tij dhe shkëndija e dritës prej dritës së Tij të shenjtë. Prandaj, ky nder i lartë nga Allahu xh.sh. e ngriti aq lart, saqë e bëri edhe mëkëmbës të Zotit mbi tokë. Mbase kjo i bëri melaqet që ta pranojnë se njeriu është i veçantë dhe superior mbi të gjitha krijesat."[1]

Meqë njerëzit janë të nderuar deri në këtë nivel nga Zoti i tyre, atëherë është e natyrshme që ata doemos të jetojnë në harmoni ndërmjet vete. Për këtë arsye, Islami, parimin e bashkëjetesës me të tjerët e bëri fondament bazik. Sipas Kuranit, njerëzit janë një shoqëri, të cilët jetojnë në një familje njerëzore të vetme.

Në Islam, njeriu përpos që nderohet dhe respektohet për së gjalli, ai nderohet edhe pas vdekjes së tij. Pejgamberi i mbarë njerëzisë na dha shembull në rastin kur kaloi pranë tij një funeral nga hebrenjtë. Muhamedi a.s., në shenjë respekti, u ngrit në këmbë. Me atë rast, dikush nga shokët e tij iu drejtua me fjalët: *"O i Dërguar i Zotit, ky funeral është i hebrenjve!"* Ndërsa ai u përgjigj: *"A nuk është edhe ai njeri?!"* (Transmeton Muslimi).

Ashtu siç urdhëroi Islami për inkurajim të njeriut në çështje pozitive e veprime të mira, ai në të njëjtën kohë urdhëroi në metodë të mirë kur ndalojmë nga e keqja, e me këtë ndaloi edhe poshtërimin e njeriut. Me një rast Ebu Dherri i kishte thënë djalit të tij: *"O djalë i të keqes!" Muhamedi a.s., kur e dëgjoi këtë u hidhërua dhe e qortoi atë. Ai i tha: "Te ti o njeri paskan mbetur elemente të injorancës (xhahilijetit)."* (Transmeton Buhariu).

---

[1] "Hukukul Insan bejne tealijmul islam dhe ilan el umemul mutehide", Muhamed Gazali, f.11, botimi i tretë, viti 1984, Kajro.

## Mëshira

Prej parimeve bazë të Islamit është mëshira për mbarë botën. Ajo konsiderohet natyrshëm dhe në formë të mishëruar fondament i fesë hyjnore. Allahu i Madhëruar thotë:

﴿وَمَا أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا رَحْمَةً لِّلْعَالَمِينَ﴾

***"E Ne të dërguam ty** (Muhamed) **vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat!"*** *(El Enbija,107).*

Mbështetur në këtë parim, mëshira është e drejtë absolute për të gjithë, prandaj, praktikimi i saj nuk vije vetëm nga aspekti i mirësisë, por në të njëjtën kohë është edhe obligim. Sipas Islamit, të gjitha shtresat e shoqërisë pa dallim, kanë pjesë të barabartë në institucionin e mëshirës. Por, për fat të keq, në shoqëri të ndryshme njerëzore, e drejta e të dobëtit dhe nevojtarit kundrejt shtresës së lartë, nuk respektohet. Mëshira parimore e garantuar nga ligji islam është siguria e vetme për një bashkëjetesë paqësore ndërmjet njerëzve.

## Drejtësia

Drejtësia është një parim tjetër, prej bazave fondamentale të Islamit. Allahu xh.sh. thotë:

﴿لَقَدْ أَرْسَلْنَا رُسُلَنَا بِالْبَيِّنَاتِ وَأَنزَلْنَا مَعَهُمُ الْكِتَابَ وَالْمِيزَانَ لِيَقُومَ النَّاسُ بِالْقِسْطِ﴾

***"Ne i dërguam të dërguarit Tonë me argumente të qarta dhe Ne zbritëm me ata librin dhe drejtësinë që t'i përmbahen njerëzit të së drejtës..."*** *(El Hadid, 25).*

Drejtësia në Islam është gjithëpërfshirëse, ajo përfshinë vetveten, familjen dhe shoqërinë. Drejtësia është e domosdoshme

në të gjitha gjendjet, pavarësisht rrethanave, qofshin ato të paqes apo luftës eventuale. Lidhur me këtë, Allahu xh.sh. thotë:

﴿وَلَا يَجْرِمَنَّكُمْ شَنَآنُ قَوْمٍ عَلَىٰ أَلَّا تَعْدِلُوا اعْدِلُوا هُوَ أَقْرَبُ
لِلتَّقْوَىٰ وَاتَّقُوا اللَّهَ إِنَّ اللَّهَ خَبِيرٌ بِمَا تَعْمَلُونَ﴾

***"...dhe të mos u shtyjë urrejtja ndaj një populli e t'i shmangeni drejtësisë; bëhuni të drejtë se ajo është më afër devotshmërisë. Kini frikë Allahun se Allahu di hollësisht për atë që vepronі."*** *(El Maide, 8).*

## Barazia

Para drejtësisë ligjore janë të barabartë të gjitha shtresat e shoqërisë, pa asnjë dallim. Pavarësisht aktit të gjykimit, të gjithë sipas Islamit janë të njëjtë.

Largimi nga barazia çon drejt dëmtimit dhe shkatërrimit të shoqërisë. Muhamedi a.s. ka thënë: *"O ju njerëz, kanë humbur dhe kanë devijuar popujt para jush, sepse kur kryente vjedhje ndonjëri i shtresës së lartë, nuk e ndëshkonin atë, e kur kryente vjedhje ndonjëri i shtresës së ultë, e ndëshkonin atë. Për Zotin, po edhe sikur të kryente vjedhje Fatimeja (bija e Muhamedit) do t'ia kisha prerë dorën e saj."* (Transmetojnë Ahmedi, Buhariu dhe Muslimi).

Barazia në Islam nuk bie ndesh me drejtësinë, ngase Islami i ka caktuar përgjegjësitë dhe detyrat në bazë të natyrshmërisë krijuese nga Allahu xh.sh., në të gjitha aspektet psiko-fizike. Kjo përfshinë të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë me drejtësi të plotë për të gjithë pjesëtarët e shoqërisë.[2]

---

[2] Shiko: "Et Tajush es Silmi bejne muslimijne ve ajrihim", përgatiti: Surhaman Hadajat, f. 27-28, botimi i parë, viti 2001, Daru Selam, Kajro, Egjipt.

# Toleranca

Me tolerancë nënkuptojmë fleksibilitetin e plotë përballë besimeve të tjera, duke përfshirë këtu bindjet, ritualet fetare, etj.. Islami urdhëron që të respektohen të drejtat e të tjerëve në mënyrë të plotë, duke mos i armiqësuar ata. Ai nuk lejon përdorimin e asnjë metode të dhunës për t'i larguar ata nga besimi i tyre, çfarëdo qoftë ai. Por, kjo nuk nënkupton nënshtrim ndaj ideve dhe bindjeve tyre, mirëpo diskutim paqësor e të argumentuar mbi të vërtetën hyjnore islame.

Allahu xh.sh. thotë:

﴿وَلَا تَسُبُّوا الَّذِينَ يَدْعُونَ مِن دُونِ اللَّهِ فَيَسُبُّوا اللَّهَ عَدْوًا بِغَيْرِ عِلْمٍ كَذَٰلِكَ زَيَّنَّا لِكُلِّ أُمَّةٍ عَمَلَهُمْ ثُمَّ إِلَىٰ رَبِّهِم مَّرْجِعُهُمْ فَيُنَبِّئُهُم بِمَا كَانُوا يَعْمَلُونَ﴾

***"Ju mos ua shani ata** (zota) **që u luten** (idhujtarët), **pos Allahut, e** (si hakmarrje) **të fyejnë Allahun nga armiqësia, duke mos ditur** (për madhërinë e Tij). **Kështu Ne i kemi zbukuruar çdo populli veprimin e vet, mandej e ardhmja e tyre është te Zoti i tyre, e Ai i shpërblen për atë që vepruan."** (El Enam, 108).*

﴿وَإِذَا سَمِعُوا اللَّغْوَ أَعْرَضُوا عَنْهُ وَقَالُوا لَنَا أَعْمَالُنَا وَلَكُمْ أَعْمَالُكُمْ سَلَامٌ عَلَيْكُمْ لَا نَبْتَغِي الْجَاهِلِينَ﴾

***"Dhe kur e dëgjojnë ndonjë llomotitje marrëzie, i kthejnë shpinën dhe thonë: "Ne kemi vepra tona e ju tuajat, qofshi larg nesh, ne nuk na duhen injorantët!"** (El Kisas, 55).*

Toleranca islame i jep njerëzimit mundësinë madhështore për bashkëpunim dhe bashkëjetesë në të gjitha aspektet dhe

në të gjitha çështjet e jetës. Në anën tjetër, qasja argumentuese me të tjerët në mënyrën prosperuese, sjell në pah të vërtetën islame dhe kumtimin e saj tek ata.

## Ndihma dhe bashkëpunimi i ndërsjellë

Nga vetë natyrshmëria e tij, njeriu është krijesë shoqërore, prandaj, ai në parim nuk mund të jetojë vetëm dhe pa bashkëpunim me të tjerët. Ai kështu përfiton në të gjitha aspektet e jetës. Kjo maksimë në Islam konsiderohet fondament i domosdoshëm i bashkëpunimit ndërnjerëzor.

Njeriu gjithnjë ka nevojë për Krijuesin dhe është i varur prej Tij, madje edhe nëse nuk pranon ekzistencën e Tij. Për këtë arsye, Islami premtoi se ndihma e Zotit xh.sh. është me atë njeri që ndihmon njerëzit e tjerë. Lidhur me këtë, Muhamedi a.s. ka thënë: *"Zoti është në ndihmën e besimtarit, përderisa ai është në ndihmën e vëllait tij."* (Transmetojnë Muslimi, Ahmedi dhe Ebu Davudi).

Në anën tjetër, dallimet ndërmjet popujve për shkak të racës, gjuhës apo nacionalitetit, Islami i konsideron motivacion shtesë për t'u njohur dhe bashkëpunuar ndërmjet vete. Allahu xh.sh. thotë:

﴿يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِنَّا خَلَقْنَاكُم مِّن ذَكَرٍ وَأُنثَىٰ وَجَعَلْنَاكُمْ شُعُوبًا
وَقَبَائِلَ لِتَعَارَفُوا إِنَّ أَكْرَمَكُمْ عِندَ اللَّهِ أَتْقَاكُمْ﴾

***"O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se tek Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur."*** *(El Huxhurat, 13).*

Muhamedi a.s. është shëmbëlltyra praktike e shtrirjes së këtij bashkëpunimi ndërmjet njerëzve. Ai, me shpërnguljen e tij në Medinë, bëri marrëveshje me ithtarët e Librit, e më pastaj edhe me idhujtarët. Bazë e këtyre marrëveshjeve ishin paqja, drejtësia, bashkëpunimi dhe ndihma e ndërsjellë në mes të komuniteteve përkatëse. Prandaj, me plotë të drejtë në kohën bashkëkohore, marrëveshjet e tilla i quajmë "memorandume paqeje".

## Aplikimi i marrëveshjeve

Aplikimi i marrëveshjeve nënkupton zbatimin e plotë të të gjitha pikave të saj me plot besnikëri dhe sinqeritet. Përmbushja e marrëveshjeve vlerësohet lart, e kjo mbase kontribuon në rritje të bashkëpunimit ndërmjet njerëzve, ndërsa, e kundërta e saj, dëmton seriozisht atë. Për këtë arsye, Islami vlerësoi lart dhe urdhëroi prerazi zbatimin e marrëveshjeve, ngase premtimi gjithsesi duhet mbajtur. Në Islam, thyerja e marrëveshjes konsiderohet cilësi e hipokrizisë, ndërsa zbatimi i saj, shenjë e devotshmërisë së lartë.

Nëse myslimanët vërtetojnë qartazi se pala tjetër nuk po i përmbahet marrëveshjes përkatëse dhe po e shkel atë, atëherë, ata kanë të drejtë të mos respektojnë atë dhe ta shpallin të pavlefshme. Kjo ngase shkelja e premtimit konsiderohet tradhti e madhe në Islam. Allahu xh.sh. thotë:

﴿وَإِمَّا تَخَافَنَّ مِن قَوْمٍ خِيَانَةً فَانبِذْ إِلَيْهِمْ عَلَىٰ سَوَاءٍ إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ الْخَائِنِينَ﴾

***"Nëse ti e heton tradhtinë e një populli (ndaj marrëveshjes), atëherë edhe ti ua hidh atyre*** *(marrëveshjen)*

***në mënyrë të njëjtë, sepse Allahu nuk i do ata që tradhtojnë*** *(fshehurazi)." (El Enfal, 58).*

Nga e tëra kjo rezulton se, Islami i ka vendosur bazat e bashkëpunimit ndërnjerëzorë në të gjitha aspektet e jetës, në mënyrë që ata të jetojnë me tolerancë, paqe dhe harmoni ndërmjet vete.[3]

[3] Shiko: "Et Tajush es Silmi bejne muslimijne ve ajrihim", përgatiti: Surhaman Hadajat, f. 33-34, botimi i parë, viti 2001, Daru Selam, Kajro, Egjipt.

Dr. Jusuf el KARDAVI

# AMËSIA DHE ATËSIA - TË QENËT NËNË DHE BABA

Familja fillimisht fillon me një çift bashkëshortor, me një burrë dhe një grua, të cilët i lidh një lidhje e shenjtë, që është martesa legjitime e shpallur, të cilën e bekon Allahu dhe e vlerësojnë njerëzit, dhe mbi bazën e së cilës vendosen të drejtat dhe detyrat. Allahu i Plotfuqishëm, kujt dëshiron, prej tyre i dhuron fëmijë vajza dhe kujt dëshiron i dhuron fëmijë meshkuj. Në këtë mënyrë, kemi nënën, babanë dhe fëmijën. Familja e ngushtë fillon dalëngadalë të zgjerohet. Në bazë të fjalëve të Allahut të Plotfuqishëm në Kuran, fëmijët janë qëllimi kryesor nga qëllimet e familjes dhe martesës: ***"Allahu ka krijuar gratë nga lloji juaj, e nga gratë tuaja u jep djemtë e nipat..."*** *(En Nahl, 72).*

## Të drejtat dhe detyrat

Pasi të lindin fëmijët në familje, lind edhe amësia dhe atësia, të cilat janë dy kuptimet e mëdha, me burime të ngrohta, me dashuri, butësi dhe altruizëm. Secila nga këto të dyja, edhe amësia edhe atësia, kanë të drejta dhe detyra. Sa u përket të drejtave të amësisë dhe atësisë, detyra e parë për fëmijët - qofshin djem ose vajza - është respektimi dhe mirësia ndaj prindërve. Kjo është një e drejtë të cilën e kanë kërkuar

të gjitha fetë hyjnore, kurse Islami e ka theksuar respektin e prindërve dhe mirësinë ndaj tyre, me fjalët e të Plotfuqishmit në Kuran: ***“Zoti yt ka urdhëruar që ta adhuroni vetëm Atë dhe t’u bëni mirësi prindërve. Nëse njëri prej tyre, ose të dy, arrijnë pleqërinë te ti, mos u thuaj atyre “uh!” dhe mos i kundërshto ata*** *(me fjalë të këqija),* ***drejtohu atyre me fjalë respekti. Lëshoj para tyre krahët tuaj të përuljes prej mëshirës dhe thuaj: “O Zoti im, mëshiroji ata, ashtu siç më kanë edukuar kur isha unë i vogël!”*** *(El Isra, 23-24).*

Islami ka treguar se vuajtjet e nënës janë më të shumta sesa vuajtjet e babait. Për këtë arsye, Pejgamberi a.s., ka rekomanduar kujdes për nënën tri herë, kurse për babanë një herë. Pastaj, kujdesin për amësinë dhe atësinë nuk e ka kufizuar vetëm për fëmijët, por për tërë shoqërinë, në mënyrë që ajo të kujdeset për amësinë e gruas derisa të lindë. Nëse është nëpunëse, ajo duhet të lehtësohet nga ngarkesa e punës. Nëse ajo lind, atëherë asaj patjetër duhet t’i jepet pushimi i arsyeshëm i lehonisë për gjidhënie, me kusht që kjo të jetë me pagë të plotë, sepse ajo po kryen një detyrë shumë të rëndësishme për shoqërinë.

Fituesi i çmimit Nobel në ekonomi, profesori Gary Baker, ka thënë: “*Gruaja që qëndron në shtëpinë e saj për t’u kujdesur dhe për t’i edukuar mirë fëmijët, kontribuon në zhvillimin e ekonomisë kombëtare me 25% deri në 50%, dhe kjo është ajo që shumë njerëz nuk e dinë, duke llogaritur se gruaja që kryen detyrën e nënës në shtëpinë e saj është e papunë. Sipas mendimit të tyre, ajo paraqet një barrë për prodhimin kombëtar.*”

Edhe pse të gjitha fetë janë marrë me amësinë dhe të drejtat e saj, ekziston diçka që është humbur. Çështja e ndar-

jes së amësisë ndërmjet dy grave, nënave trashëguese dhe nënave shtatzënë dhe lindëse, ka prishur kuptimin e amësisë, për të cilën janë kujdesur fetë dhe i kanë caktuar asaj të drejta dhe detyra. Me këtë ka humbur kuptimi i amësisë, ndërsa e vërteta e saj është humbur ndërmjet dy grave të përmendura.

Nëse pronarja e vezës është ajo që transmeton te fëmija gjithçka që mund të trashëgohet prej saj, pastaj prej babait dhe prej dy familjeve të tyre, atëherë pronarja e mitrës është ajo që i përjeton vuajtjet e shtatzënisë dhe lindjes, bashkë me vuajtjet e ushqimit të embrionit gjatë gjithë shtatzënësisë nga gjaku i saj. Këto vuajtje e kanë rëndësinë dhe rolin e tyre në theksimin e kuptimit të amësisë, për shkak të së cilave edhe meriton respektin dhe mirësinë prindërore.

## Jetim pa prindër, ndonëse ata janë gjallë

Privimi i fëmijës nga njëri prind i tij, p.sh. privimi nga babai, nga i cili ka lindur dhe i cili ndjehet kujdestar i tij, është krim dhe mëkat i madh. Këtë mund ta shohim te rasti i fëmijëve jashtë kurore, nënat e të cilëve kanë bërë shtatzëni të paligjshme. Këtë e ka prodhuar vala e pornografisë, të cilën e hodhi qytetërimi bashkëkohor. Ajo është shkaktare për shfaqjen e nënave të pa martuara. Përhapja e prostitucionit (zinasë), pastaj shtatzënia e grave në mënyrë haram (pa martesë), ka privuar shumë djem dhe vajza nga baballarët e tyre biologjikë. Ndërkaq, më e urryera e kësaj është gjendja e fëmijëve të braktisur, të cilët nuk kanë asnjë faj, përveç epshit të baballarëve dhe nënave. Në këtë mënyrë, fëmija jeton je-

tim duke i pasur prindërit gjallë, ose edhe më keq se kjo, jeton si fëmijë nga prindër anonim.

## Integrimi i arsimit

Rritja e fëmijëve kërkon më shumë se sa përpjekje. Fëmijëria e njeriut është fëmijëria më e gjatë dhe e vështirë sesa te të gjitha gjallesat. Ka nga kafshët dhe zogjtë që aftësohen për lëvizje dhe ecje sapo të lindin, por Allahu i Madhëruar e ka ditur që njeriu ka nevojë për kujdes të gjatë, stërvitje, edukim dhe disiplinë.

Së këndejmi, vjen përgjegjësia e prindërve që e kanë lindur fëmijën dhe janë bërë shkaktarë për nxjerrjen e tij nga errësira e mos ekzistencës për në dritën e ekzistencës. Është përgjegjësi e tyre për t'u kujdesur në aspektin material, atë moral dhe shpirtëror. Gjëja e parë që kërkohet nga prindërit karshi fëmijës së tij është ushqimi i tij nga gjiri i nënës.

Mirëpo, civilizimi modern ju ka sugjeruar grave që ato mos t'i "dobësojnë" fëmijët me qumështin e tyre, por të kufizohen në ushqimin artificial, në mënyrë që ta ruajnë "vijën" e trupit. E vërteta e ushqimit me gji nuk është vetëm arritja e qumështit në stomakun e fëmijës, por është më e madhe dhe më e thellë. Ajo është mbështetje për gjoksin e nënës dhe ndjenjë e ngrohtësisë së butësisë së saj. Kështu pra, me qumështin e nënës nuk është ekuivalent asnjë qumësht tjetër artificial.

Sa i përket përgjegjësisë për t'u kujdesur për jetimin, Islami kujdesin për të e konsideron një nga veprat e mira më madhore, të cilat afrojnë tek Allahu i Madhërishëm. Islami i

kërkon komunitetit mysliman dy gjëra që kanë të bëjnë me jetimin:

Çështja e parë është ruajtja e pasurisë së tij nëse ai ka pasuri. Allahu i Plotfuqishëm thotë: ***"Dhe mos iu qasni pasurisë së jetimit, përpos në një mënyrë të mirë, derisa ta mbërrijë pjekurinë..."*** *(El Enam, 152).*

Dhe çështja e dytë është ruajtja e personalitetit të jetimit, në mënyrë që mos të pikëllohet, mos të dëbohet, as mos të fyhet, siç thotë i Plotfuqishmi: ***"Sa i përket jetimit, mos e pikëllo!"*** Edhe më keq se kaq është kur fëmija sprovohet me prindër, të cilët nuk kujdesen për të, nuk mendojnë për të etj., ky pra është jetimi i vërtetë, për të cilin poeti i madh Ahmed Shevki është shprehur:

*Nuk është jetim ai, që prindërit e tij e përfunduan*
*jetën e tyre dhe atë e braktisën të poshtëruar;*

*e ai pastaj i shfrytëzoi mençuritë e dynjasë, dhe si*
*alternativë e jetoi mësimin e kohës!*

*Por jetim i vërtetë është ai, që nëna e ka braktisur,*
*ose babai i tij, për të nuk është kujdesur!*

Plotësimi i detyrës së prindit dhe fëmijës bëhet me kuptim reciprok dhe bashkëpunim të dy prindërve për edukimin e mirë të fëmijëve me edukatë gjithëpërfshirëse. Në aspektin shpirtëror - me mbjellje të besimit dhe ibadetit, në aspektin mendor - me mirëkuptim dhe kulturë të mirë, në aspektin moral - me edukim të mirë dhe me virtyte, në aspektin fizik - me pastërti dhe sport, në aspektin social - me dashjen e së

mirës dhe shërbim të komunitetit, në aspektin politik - me mësim të besnikërisë ndaj kombit dhe fesë, në aspektin teknik - me mbjellje të ndjenjës së bukurisë në universin përreth tij.

Ky edukim është detyrë e vështirë për të cilën janë përgjegjës të dy prindërit së bashku, siç ka thënë Pejgamberi a.s.: ***"Ju të gjithë jeni bari dhe secili është përgjegjës për kopenë e tij."*** Pra, nuk është vetëm sigurimi i fëmijëve të tyre në aspektin material siç veprojnë disa prindër.

Plotësimi i detyrës së nënës dhe babait bëhet në atë mënyrë, që ata të dy të pajtohen për mënyrën e edukimit. Nuk lejohet që babai të marrë metodë të shtrëngimit dhe egërsisë ndaj fëmijëve, ndërsa nëna të marrë metodë të lehtësimit dhe përkëdheljes. Ata të dy duhet të marrin metodë mesatare, e cila nuk shkon në asnjërin ekstrem, as të shtrëngimit e as të përkëdheljes. Për këtë arsye, Pejgamberi a.s., e ka kundërshtuar një udhëheqës arab, i cili ishte befasuar se pse Pejgamberi a.s., i puthte nipërit e tij, saqë i kishte thënë Pejgamberit: ***"Unë i kam 10 fëmijë, kurrë nuk e kam puthur asnjërin prej tyre."*** Pejgamberi a.s., e kishte shikuar dhe më pas i kishte thënë: *"Kush nuk tregon mëshirë, nuk mëshirohet."*

*Përktheu:*[1]
***Miftar AJDINI***

[1] http://www.qaradawi.net/new/Articles-10949

**Dr. Orhan BISLIMAJ**

# MEKTEBI - KANDIL NDËR BREZA

## Çka është mektebi?

Në të kaluarën i kanë thënë mejtep, kurse emri origjinal është mekteb, që nënkupton zyrën e imamit, përkatësisht mësonjëtoren e mësim-besimit, e cila është në kuadër të xhamisë dhe në të cilën edukohen dhe arsimohen fëmijët. Me kalimin e kohës, mektebi ka nënkuptuar organizimin pedagogjik të mësim-besimit, pavarësisht vendin ku ai mbahej, në zyrë, në një objekt të veçantë, apo në xhami.

Tradicionalisht, procesin e mësim-besimit në mekteb e ka mbajtur imami i xhamisë, i cili është quajtur mualim (mësues). Ndërsa, pas vitit 1999, me diplomimin e kuadrit femëror, në këtë detyrë fisnike janë angazhuar edhe mualimet (mësueset fetare) me përgatitje profesionale universitare.

## Historiku

Mektebi ka një histori të gjatë në trojet tona dhe ndërlidhet me ekzistimin e xhamive të para, qysh në shekullin XIV dhe fillimin e shekullit XV. Në Perandorinë Osmane, mektebi ka qenë nivel shkollor shtetëror, me planprogram dhe personel të kualifikuar, dhe kjo përbën një rëndësi të veçantë për fillimet e para të arsimimit zyrtar ndër shqiptarë.

Asokohe, ishin tri nivele arsimore zyrtare:

- *Mektebi* – ekuivalent me filloren e sotshme;
- *Medreseja* – ekuivalent me shkollën e mesme të ultë e të lartë të sotshme; dhe
- *Enderun* – nivel arsimor special në Stamboll, i dedikuar për elitën shtetërore, si dhe për përgatitjen e personelit të ardhshëm në administratën osmane.

Dy nivelet e para i hasim në të gjitha vendet e Perandorisë ku ka pasur myslimanë, kurse të krishterëve (jomyslimanëve), Perandoria ua njihte të drejtën e shkollimit sipas organizimit që funksiononte mbi bazën e feve të tyre. Në fund të shkollimit, mualimi (hoxha - mësuesi), u lëshonte nxënësve '*shehadetname*', ekuivalente me certifikatën apo diplomën e sotshme.[1]

## Mektebet e para

Historiografia jonë shqiptare evidenton tri mektebet e para, që mendohet se janë më të vjetrat:

- Mektebi i Sinanudin Jusuf Çelebiut, në Ohër, i ndërtuar para vitit 1491;
- Mektebi i Ishak Çelebiut, në Manastir, i ndërtuar para vitit 1508;
- Mektebi i Suzi Zërrinit (Çelebiu), në Prizren, i ndërtuar para vitit 1513.

[1] Dr. Nehat Krasniqi, *Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale prej shekullit XVIII deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare,* Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2017, fq. 229, e tutje.

Pas tyre kemi edhe plot të tjerë, siç është ai i Kuklibegut në Zinovë (Bresanë), para vitit 1538, gjersa bazuar edhe në udhëtimin e Evlija Çelebiut (shek. XVII), numri i mektebeve në trevat shqiptare deri kah mesi i shek. XVII, ka arritur mbi 200 sosh.

Ndërsa gjatë shek. XVIII e deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, shek. XIX, numri kishte shkuar rreth 1500 të tillë.[2]

## Mektebi është shkolla e parë shqipe ndër shqiptarë

Duke qenë nivel zyrtar arsimor i kohës, mektebi është shkolla e parë islame në gjuhën shqipe ndër shqiptarë. Njësoj si sot, imamët shqiptarë, u kanë folur fëmijëve shqip në mekteb, i kanë këshilluar shqip dhe u kanë mbajtur ligjërata pedagogjike në gjuhën shqipe. E, me themelimin e alfabetit, ata ua kanë mësuar dhe shkrim-leximin e shqipes.

Mektebet ishin si paraprirëse të Mësonjëtores së Korçës, të themeluar nga Pandeli Sotiri, në vitin 1887. Natyrisht, askush nuk e mohon rëndësinë e asaj Mësonjëtoreje në promovimin e shkrimit të gjuhës shqipe me alfabetin që e kishin nxjerrë vëllezërit Naim e Sami Frashëri, e sidomos për formatin e saj tejfetar apo laik, që ishte domethënës në atë periudhë me antagonizma fetar, por nuk do të thotë se arsimi po fillonte me të. Arsimi ndër shqiptarë ka filluar me mektebin rreth katër shekuj më parë.

---

[2] Dr. Nehat Krasniqi, *Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale...,* po aty, fq. 227.

# Mësimi në mekteb është mbajtur në gjuhën amtare

Në mekteb, gjithmonë mësimi është mbajtur në gjuhën amtare dhe kjo është e vërtetë e padiskutueshme. Natyrisht, është mësuar edhe gjuha osmane (si gjuhë e shkencës dhe e administratës shtetërore në atë periudhë), si dhe leximi i gjuhës arabe (si gjuhë e Kuranit - fesë), porse procesi mësimor është zhvilluar në gjuhën shqipe, njësoj si sot që fëmijët në shkollat tona e mësojnë anglishten, përmes komunikimit me arsimtarin në gjuhën shqipe.

Tani, mohimi i rëndësisë arsimore të mektebit, me paragjykimin se aty kinse nuk është mësuar në gjuhën shqipe, por vetëm në arabishte e osmanishte, është trillim nga disa studiues antiislamistë. Fundja, ne po flasim për arsimim në gjuhën shqipe në mekteb në një periudhë të hershme (shek. XV-XVIII), e nuk po flasim për shkrimin e saj, sepse alfabeti shqip është tepër vonë (1908). Pastaj, çdo njeri e di se ndërmjet shkrimit e arsimimit ka dallim, sikurse që ka dallim ndërmjet letërsisë gojore dhe asaj të shkruar.

Për shembull, sot ka të verbër që nuk dinë të shkruajnë shqip, por nuk mund t'ua mohosh përgatitjen e tyre arsimore nëpërmjet alfabetit 'braj', apo përmes dëgjimit. I njëjti parim vlen edhe për ata që kanë studiuar në gjuhë të huaja.

Apo rasti tjetër, kur Kemal Ataturku i Turqisë, në vitin 1923 përkatësisht 1928, e shndërroi popullin turk në analfabetë brenda natës, përmes ndryshimit të alfabetit, nga ai osman në atë latin. Sipas të njëjtës logjikë, i bie se arsimi tek ata (turqit) ka filluar prej atij viti, e dihet se kjo nuk është e vërtetë. Historiografia jonë shqiptare, duhet ta vlerësojë mek-

tebin ashtu siç e ka vlerësuar, ta zëmë, kritika letrare letërsinë shqipe të bejtexhinjve (alamiado), që ishte shkruar me alfabet osman.

Nezim Frakulla (vd.1759), Sylejman Naibi (vd.1762), Hasan Zyko Kamberi (vd.1822), Muhamet Kyçyku (vd.1844), Tahir efendi Boshnjaku - Gjakova (vd.1870), e shumë e shumë të tjerë, që shkruan me alfabetin osman, konsiderohen si pararendës të letërsisë së Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Muhamet Kyçyku, apo siç njihet Muhamet Çami, ishte hoxhë dhe i ka sidomos dy poemat e tij të njohura në funksion të idealeve të mektebit, "*Erveheja*", që e lartëson nderin e femrës, dhe "*Jusufi e Zylehaja*", ku e lartëson nderin e burrit.

Mendimtari i shquar i Rilindjes, Jani Vreto (vd.1900), e transilteroi poemën "*Erveheja*" të Muhamet Çamit dhe e kishte botuar në Bukuresht në vitit 1888. E, ideologu i Rilindjes, Naim Frashëri, këtë letërsi e vlerëson lart dhe e cilëson si 'letërsi kombëtare shqiptare'. Njësoj e kanë vlerësuar edhe autorët e tjerë, kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

## Mektebi lindi si motiv, kurse mbijetoi si vlerë

Në misionin e tij parësor, mektebi lindi si motiv, funksionoi si qëllim, mbijetoi si vlerë, kurse ekzistoi si nevojë. Ai u bë pjesë e rëndësishme e etnokulturës së shqiptarëve, jo për shkak të emrit, e as për shkak të historisë, apo për shkak të ndonjë imponimi, sepse gjithmonë ishte vullnetarë, por u bë pjesë e jona si një vlerë e pazëvendësueshme në edukimin e fëmijëve. Si i tillë, as nuk vjetërsohet e as nuk shuhet, sepse

vlerat e njëmendta ekzistojnë pavarësisht subjektit – njeriut. Për këtë, arsye gjithmonë kanë qenë preokupim i mendjes njerëzore.

Për shembull, besimi në Zotin, pra si vlerë themeltare i paraprinë njeriut, sepse Zoti ekzistoi edhe kur njeriu nuk ishte. Njësoj është dija, e cila ekzistoi që kur Allahu e shkroi në detaje ngjarësinë e krijesave; po ashtu edhe drejtësia, e cila filloi që kur Zoti e krijoi gjithësinë me një precizitet absolut, etj., andaj ato ekzistojnë përpara e pavarësisht nga njeriu. E njeriu fisnikërohet po aq sa merr prej këtyre vlerave ontologjike, sikurse që degradohet po aq sa i mungojnë ato.

Në antikitetin e thellë, njeriu e kërkoi Zotin, kur nuk kërkoi asnjë vlerë tjetër. Edhe në Mesjetë, njeriu e kërkoi Zotin. Edhe sot njeriu e kërkon Zotin, edhe në të ardhmen do ta kërkojë Zotin. Është thënë se uji kthehet në burimin e vet nga i cili ka dalë. E kërkon, sepse ishte dhe është motiv kongnitiv – i lindur, i skalitur në shpirtin e njeriut. Me vetë faktin që njeriu e ka etjen, është dëshmi e qartë se diku ekziston uji.

Në jo pak vende, Zoti i drejtohet njeriut: ***“Se në vetveten tuaj keni argumente, a nuk po logjikoni!?”*** *(Edh Dharijat, 20).*

Ndërsa, fraza “kush e njeh vetveten, në fakt e njeh edhe Zotin”, është bërë moto e përgjithmonshme te dijetarët dhe filozofët.

Prandaj, ka pasur periudha kur mektebi e feja kanë kaluar momente të vështira, do të ketë edhe në të ardhmen, por ato nuk janë shuar e as nuk do të shuhen kurrë, për të njëjtat arsye për të cilat po flasim.

# Shkolla dhe mektebi - dy anë të një medalje

Sot, shyqyr Zotit, kemi shkolla në trojet tona shqiptare, në të cilat fëmijët kanë ku të arsimohen. Është fjala për shkollat laike (shtetërore e private), ku fëmijët mësojnë për lëndë të ndryshme mësimore, duke filluar nga shkencat e natyrës, shkencat shoqërore, e deri te lëndët e artit e ato të teknologjisë. Por, shtrohet pyetja, shkollat e sotshme, a mund ta zëvendësojnë mektebin? Përgjigjja është jo, nuk mund ta zëvendësojnë kurrë, ngaqë fushëveprimet i kanë të ndara.

Vetë njeriu është qenie dihotomike, që përbëhet prej trupit e prej shpirtit, njëkohësisht. Në gjuhë arabe i thuhet '*abd*' – rob, dhe kurdoherë që ndodhë ndarja mes tyre, pason vdekja. E kjo do të thotë se trupi e shpirti janë dy entitete të ndara dhe të bashkuara. Njësoj është shkolla dhe mektebi.

Gjersa shkolla e ka për fushëveprim intelektin e njeriut (arsimimin), në anën tjetër, mektebi e ka fushëveprim shpirtëroren e tij (edukimin). Në një proces ndërveprimi, intelekti e ka prodhuar civilizimin, kurse shpirtërorja e ka prodhuar kulturën, me të cilat dallohen popujt ndërmjet vete. Këtu ngjizet rëndësia e patjetërsueshme e mektebit. Për këtë arsye, shkolla dhe mektebi janë dy anë të një medalje. Ato nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën, përkundrazi e kompletojnë njëra-tjetrën. Kush mendon se shkolla e mbulon edhe edukimin, nuk ia ka qëlluar.

Në fakt, shkolla bën përpjekje për ta mbuluar këtë pjesë, porse nuk mund të ketë suksese, sepse i mungojnë "veglat" e punës, e të cilat janë metafizike. Në ajër fluturohet me aeroplan, në deti me anije, kurse në tokë me rrota. Këto ligje nuk

i ka vendosur njeriu, porse njeriu duhet t'u përshtatet atyre, me apo pa dëshirë.

Njeriu është një mikrokozmos tipik. Vetë individi ka terr informativ për veten e tij, përkatësisht për shpirtëroren e tij, e lëre më të tjerët për të. Për këtë arsye, qasja pedagogjike ndaj njeriut, në formë të platformës, është dhënë e gatshme nga Zoti përmes Kuranit. Si e tillë është e ndjeshme e delikate, njësoj si shkenca e Kelamit (besimit), për të cilën është thënë se ngjason me detin, kushdo që hyn pa ditur not, mbytet.

Arsimi laik nuk e njeh terrenin e shpirtërores, e kjo do të thotë se nuk ka ndikim në gjysmën e individit, përkatësisht në pjesën më të rëndësishme të tij. Pa arsimim nuk bën, por as pa edukatë nuk bën, sa është me vlerë njëra, po aq është edhe tjetra. Njerëzit nuk janë keqbërës për shkak të mos arsimimit, por për shkak të mungesës së edukatës. Prandaj, edukimin e mirëfilltë e mbulon feja islame.

## Mektebi në mbrojtje të identitetit

Mektebi, duke qenë nivel shkollor zyrtar për shekuj me radhë, nëpër dyert e tij kanë kaluar pothuajse të gjitha figurat e rëndësishme kombëtare. Në pjesën e dytë të shek. XX, me ardhjen e komunizmit si ideologji antife, mektebi, njësoj si edhe feja e përjetoi një degradim publik, por megjithatë, proceset e mëvonshme kanë treguar se gjeneratat e asaj kohe (me përjashtim të shërbëtorëve të partisë e të pushtetit) e kanë dashur fenë dhe e kanë ndjerë mungesën e mektebit.

Në këtë periudhë të errët, rolin e mektebit e kanë arnuar vetë prindërit, duke ua mësuar fëmijëve gjërat elementare të fesë, prej Ilmihalit - doracak i mësim-besimit. Dhe, kur ko-

munizmi mendoi se e mbaroi punën me fenë, mu atëherë, në vitin 1989, mektebi e vazhdoi misionin aty ku e kishte lënë, duke i kompensuar humbjet e disa dekadave. Me punën e tyre të madhe edukativo-arsimore, imamët u bënë pjesë e secilës familje.

Prindërit, nuk e kanë parë mektebin si një edukim vetëm fetar, por si një adresë për frymëzimin e fëmijëve me të gjitha tiparet etnotipike, përkatësisht etnofetare si pjesë e nacionalizmit shqiptar. Sepse, shqiptari kurrë nuk e ka menduar veten të pa fe. Zakonisht, për dikë që është shprehur kundër fesë (kryesisht disa mësues të përkëdhelur nga partia komuniste dhe jugosllavët e kohës), njerëzit i kanë thënë *'filani ish ba shka!'* dhe e kanë urryer.

Bile, ky ka qenë edhe ai shkaku kryesor te disa prindër, të cilët kanë refuzuar t'i shkollojnë fëmijët e tyre në universitetet jugosllave, nga frika se mund t'i bëheshin *'shkije',* për nga aspekti i kulturës fetare dhe kombëtare, siç ka pasur raste. Ndikimin që e kishte mektebi te shqiptarët myslimanë, sot e hasim përafërsisht te boshnjakët e Kosovës. Tek ata, mektebi nuk është vetëm fe, por 'brend' i myslimanit boshnjak, ku shfaqet si mobilizim për identitetin dhe vlerat kombëtare të komunitetit. Kësisoj ishte mektebi për myslimanin shqiptar, sidomos deri në vitin 1999.

Atë që e kanë thënë studiuesit se islamizimi i shqiptarëve ka qenë pritë kundër sllavizimit, ne do të shtojmë edhe këtë se xhamitë e mektebi, duke bërë dallimin fetar me pushtuesin serbo-sllav, kanë qenë frymëzim psiko-kulturor për mbrojtjen e identitetit kombëtar shqiptar dhe mobilizim për çlirimin e atdheut. Kjo gjeneratë e bëri luftën dhe e çliroi Kosovën.

# Mektebi, mbrojtje kundër tjetërsimit

Dikur, prindërit e kishin preokupim sigurimin e bukës e të veshmbathjes për fëmijët, por ajo kohë ka mbaruar. Shyqyr Zotit, të gjithë e kanë një mirëqenie bazike. Po ashtu, dikur e kishin preokupim shkollimin e fëmijëve, saqë shumë talent janë djegur për shkak të kushteve. Edhe kjo brengë, sot nuk ekziston...

Por, periudha moderne, e ka prodhuar një sfidë tjetër tepër serioze, *brenga për ndërtimin e individit.* Çfarë individi po ndërtojmë në kohën tonë, kjo duhet të jetë brenga jonë si prind, si shoqëri dhe si komb. A është fëmija im i sotshëm, ai që do ta transmetojë imazhin e familjes shqiptare, të shoqërisë dhe të kombit në mënyrë autentike?!

Pastaj, ky transformim i pandalshëm shoqëror në të gjitha poret, a po ndodhë në gjërat periferike të kulturës e identitetit kombëtar, apo e ka prekur palcën tonë, duke na dërguar në portën e vetëasimilimit, huajtjesimit dhe tjetërsimit? Cili është roli i mektebit në këtë mes, a mund të jetë një gardian autokton?

Për shkak të globalizmit eruptiv e mbizotërues (ku kulturat e huaja hyjnë e dalin pa censurë, e ku ato të mëdhatë i rrëmbejnë ato të voglat), në shoqërinë tonë po ndodh një tjetërsim ideo-kulturor, ndoshta më i shpejtë se ç'është menduar. Ky tjetërsim, te rinia shqiptare po shpërfaqet në përmasat e degjenerimit si pjesë e diskursit modern, ku numri i prindërve të zhgënjyer me fëmijët është bërë tepër i madh. E, në këtë hall prindëror, mektebi na vjen në ndihmë. Fëmijët në mekteb frymëzohen për virtyte të larta dhe vetëbesim për vlerat tradicionale që posedojnë.

Aty e rifitojnë një membranë kulturore autoktone për fenë dhe traditën, që i bënë imunë kundrejt rrëkeve të huaja dhe veseve negative, atë që ndoshta nuk mund ta bëjnë prindërit në shtëpi, apo shkollimet e tjera alternative. Këtë rol, mektebi është duke e luajtur edhe në diasporën shqiptare, për dallim nga të tjerët që i janë dorëzuar fatit të tjetërsimit. Sot, marrë parasysh sjelljen, veshjen, moralin, etj., rinia fetare është duke e bërë dallimin në vlera me rininë, që nuk udhëhiqet nga vlerat fetare. Rrjedhimisht, nuk mund ta gjesh një prind, që në fund të ditës është zhgënjyer me këtë rini, përkundrazi.

## Mektebi, obligim prindëror ndaj fëmijëve

Shumë prindër çështjen e fesë e shohin si diçka të parëndësishme për fëmijët. Në fakt, ky është gabimi më i madh prindëror i tyre. Hyri rreth e përqark dynjasë, hyri rreth e përqark historisë njerëzore, lexoji librat e shko deri te Sokrati, te Platoni e tek Aristoteli, do të bindesh se besimi fetar ka qenë konstantja e vlerave qytetare dhe e vetë njerëzimit.

Shko edhe më larg, deri tek “Epi i Gilgameshit”, te Papiruset e Leningradit e te Kodi i Hamurabit, etj., që dihen si vepra më të lashta, do ta shohësh përsëri se elementi i besimit fetar ka qenë pjesa më e rëndësishme.

Me të drejtë, Henri Bergson ka thënë: “Është gjetur dhe gjendet shoqëri njerëzore pa shkencë, art e filozofi, mirëpo asnjëherë nuk është gjetur ndonjë shoqëri pa fe.”

Mbylle fletën e historisë, kalo në atë të sociologjisë, antropologjisë e psikologjisë! Të gjithë e thonë se besimi fetar

ka qenë pjesë e pandashme e njeriut. Të njëjtën e thotë sociologu më i njohur bashkëkohor, A. Giddensi. Të njëjtën e thotë antropologu i njohur, Erih Fromi, i cili nevojën për religjion e cilëson si diç të rrënjosur në kushtet themelore të ekzistencës së qenies njerëzore.

Të njëjtën e thotë Karl Gustav Jungu, themelues i psikologjisë analitike, sipas të cilit, në shpirtin e njeriut gjenden arketipa religjiozë, të cilët ai i cilëson si 'dispozita shpirtërore' që varësisht nga përkatësia e individit në një kulturë a religjion të caktuar, prodhojnë figura hyjnore të shumëllojshme. Domethënë, besimi fetar asnjëherë nuk ka qenë kontestues, por ka qenë problematike mënyra e besimit. Për këtë arsye, kurrë nuk kanë mundur ta ndalin fenë, e as nuk do të mund ta ndalin ndonjëherë.

Prandaj, sipas fesë islame, secili prind e ka për obligim që fëmijës së vet t'ia mundësojë mësim-besimin për gjërat elementare të fesë, si duhet besuar në mënyrë të drejtë e të saktë në Zotin. Nëse këtë nuk mund ta bëjë prindi vetë, dhe nuk mund ta bëjë, atëherë dërgimi i fëmijëve në mekteb është domosdoshmëri prindërore.

## Mektebi dhe besimi fetar si standard vleror

Pas një historie me plotë përplasje, luftëra e antagonizma në mes popujve, civilizimeve e kulturave, më në fund, Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB), më 10 dhjetor 1948, e shpalli Deklaratën e Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut, me 30 nene, duke i vënë pikën të gjitha dilemave.

Në nenin 2, thuhet:

*"Secili gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë Deklaratë pa kurrfarë kufizimesh për sa i përket racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit fetar, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes ose tjetër."*

Këtë frymë të Deklaratës e kanë ndjekur edhe konventat e tjera, si: Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (1950); Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (1966), etj.

Rrjedhimisht, të gjitha shtetet janë të detyruar që t'i respektojnë këto liri dhe të drejta universale, gjatë nxjerrjes së ligjeve. Mjaftojnë këto argumente për ta gjykuar dëmin e madh të diktatorit komunist, Enver Hoxha, si një person kundër historisë e kundër popullit shqiptar, kur e ndaloi fenë zyrtarisht në Shqipëri, në vitin 1967.

Ndërsa, në nenin 18, të Deklaratës, thuhet:

*"Gjithkush ka të drejtën e lirisë (...), të shfaqë publikisht ose privatisht, besimin ose bindjen e vet me anë të dhënies së mësimeve, kryerjes së kultit dhe ceremonive fetare."*

Shtetet e Evropës, e kanë futur lëndën fetare në shkollat laike shtetërore. Shtrohet pyetja, përse ata e bënë një gjë të tillë, e ne shqiptarët nuk e bëjmë?! Do të ishte gabim "enverist", nëse një vlerë njerëzore, siç është besimi fetar, që ka prezencë më të madhe ndër njerëz sesa çdo gjë tjetër, t'i lihet fatit apo të nëpërkëmbet.

Ndonëse mektebi ka ekzistuar shumë më herët, megjithatë është duke i qëndruar besnikë Deklaratës së OKB-së. Edhe prindërit duhet t'i qëndrojnë besnikë kësaj Deklarate, duke ua mundësuar fëmijëve edukimin dhe kulturën fetare në mekteb, atë që do të duhej t'ua mundësonte shteti në shkollë.

## Mektebi me personel arsimor shembull

Më kujtohet, një prind që e kishte dërguar fëmijën e vet në klasën e parë në shkollë, ndihej shumë i lumtur, ngaqë fëmija e kishte pëlqyer mësuesen. Kjo është domethënëse për një edukim kuptimplotë.

Imami apo mualimi që e ka mbajtur mësimin në mekteb ka qenë person i dalluar në popull në secilën periudhë historike. Njësoj si sot, ai duhej t'i plotësonte disa kritere bazike, të ishte i aftë, i arsimuar, i ndershëm, i edukuar, me karakter të fortë, i përgjegjshëm, etj.. Po ashtu, duhej të ishte i pastër nga veset negative e thashethemet.

Bile, Mehmet Kuklibeu, në vakëfnamenë e tij për mektebin që e pati themeluar pranë xhamisë së tij në Zinovë (Bresanë), në vitin 1538, e kishte theksuar se mualimi nuk duhej të merrej as me punë të bujqësisë, për ta bërë dallimin me masën e rëndomtë. Shyqyr Zotit, mektebet e sotshme kanë kuadër të arsimuar me përgatitje profesionale universitare dhe në këtë aspekt prindërit duhet të ndihen të qetë për fëmijët e tyre.

Në dy dekadat e fundit, përveç imamëve, janë angazhuar edhe mualimet e arsimuara (mësueset fetare), gjithandej Kosovës, dhe është prej veprimeve më të mençura të Bashkësisë Islame.

## Objektivat e mektebit

Mektebi nuk është qëllim në vetvete. Jo, ai ka për qëllim të përmbushë misionin e Pejgamberit a.s. për edukimin e individëve, me njohuritë dhe kulturën fetare islame.

Objektivi standard i mektebit fillon me mësimin e parimeve themelore të fesë, siç janë: shehadeti, kushtet e imanit, kushtet e Islamit, rregullat e mirësjelljes - ahlakut, memorizimi i disa sureve të Kuranit, etj., kurse mbaron me mësimin e leximit të Kuranit në gjuhën e tij origjinale.

Përgjatë kësaj periudhe mësimore, të ndarë në disa nivele, fëmijët mësojnë edhe për shumë aspekte të tjera, që ndikojnë në formimin e tyre. Mësojnë për rëndësinë e themelimit të familjes, për respektin ndaj prindërve, për dashurinë ndaj atdheut, ndaj kombit, edukatën qytetare, etj.. Po ashtu, në mekteb fëmijët pajisen me vetitë e mira, sipas Kuranit e Sunetit, si dhe braktisjen e shprehive të këqija, siç janë: vjedhja, gënjeshtra, tradhtia, përgojimi, zilia, etj., përfshirë largimin nga dukuritë negative shkatërrimtare, siç janë: droga, alkooli, bixhozi, duhani, etj..

## Përfundim

Mektebin duhet fuqizuar sa më shumë që është e mundur, jo vetëm si një kauzë fetare islame, por si një shërbim ideal ndaj popullit e atdheut, kundrejt kulturave degjeneruese që po i shërbehen rinisë dhe shoqërisë tonë në përmasa të gjithanshme, orë e çast, në televizione e internet, pa asnjë censurë. Prandaj, çdo fëmijë mysliman duhet të kalojë nëpër dyert e mektebit dhe ky është ai objektivi i përhershëm në nivel të ymetit të Pejgamberit a.s..

**Kurra. hfz. dr. Xhevad SHOSHIQ**

# DALLIMET DIALEKTORE NDËRMJET KIRAETEVE[1]

## Hyrje

Është e njohur se çdo fjalim në lidhje me shfaqjen dhe zhvillimin e shkencën së kiraetit fillon nga hadithi rreth *shtatë harfeve*. Kuptimi i sintagmës "*shtatë harfe*" ka qenë temë e debatit të gjerë në mesin e dijetarëve islam. Një prej mendimeve më dominuese është se *shtatë harfet* paraqesin shtatë dialekte arabe në të cilat është shpallur Kurani. Për këtë aspekt të kiraeteve flasim në tekstin e mëposhtëm.

Leja që Kurani të lexohet në *harfet,* arabëve u ofronte ndihmë, duke pasur parasysh se leximi i Kuranit në një kiraet, atyre iu dukej si vështirësi. Ata ishin injorantë, numri i paktë prej tyre dinte shkrim-leximin. Meqë situata ishte e tillë, që anëtarët e një fisi vështirë e pranonin dialektin e ndonjë fisi tjetër, atyre iu është mundësuar leximi i Kuranit sipas formave të tyre dialektore, por që domethënia dhe kuptimi i shprehjes kuranore duhej të mbetej e pandryshuar. Kjo zgjati kështu përderisa pjesa më e madhe e tyre u shkolluan dhe e

[1] Kurra hfz. dr. Dževad Šošić, "Dijalekatske razlike među kira'etima", *Zbornik radova*, Sarajevë, 2010, f.14.

përafruan fjalimin e tyre me atë të Pejgamberit a.s.. Kur arritën në mundësi që më lehtë të adaptojnë, të mbajnë në mend dhe të artikulojnë fjalët kuranore, leja për të recituar Kuranin në përputhje me lehtësimin e më parë iu është mohuar, konsideron Et Tahaviu.[2]

Ibën Atije[3] ka thënë se deklarata e Pejgamberit a.s.: *"Kurani është shpallur në* ***shtatë harfet",*** do të thotë se në strukturën gjuhësore të tij janë të përfshira shtatë dialektet e fiseve arabe në të cilat është shpallur Kurani. Ndonjëherë kuptimi është shprehur me dialektin e Kurejshëve, ndonjëherë me dialektin Huzejl, ndonjëherë me dialekte të tjera, në varësi të asaj se cila shprehje është elokuente dhe kuptimplotë. *"A nuk e vëreni!",* vazhdon Ibën Atije, "që folja *fetare* (فطر) në dialekte të tjera, ndryshe nga dialektin e Kurejshëve, do të thotë *'ibtede'e* (ابتدأ). Kjo folje është përdorur në tekstin kuranor, por Ibën Abasi nuk e kishte të qartë sfondin e saj etimologjik, përderisa para tij nuk u paraqitën dy beduinë, të cilët kishin debatuar rreth një pusi. Njëri prej tyre tha: *"Unë e kam ndërtuar* (انا فطرته)!" Ibën Abasi ka thënë: *"Atëherë e kuptova fjalën të Lartësuarit*: فاطر السموات والأرض."[4]

---

[2] Shih: Al Qurtubi, Abu 'Abdullah Muhamed b. Ahmad b. Abu Bakr b. Farh al Ensari alKazraği, *Al Ğami' li'ahkami'l-Qur'an* (Përpunimin, rishikimin dhe komentimin e bëri dr. Muhamed Ibrahim al Hafnawi, kurse identifikimin dhe vërtetimin e haditheve e bëri dr. Mahmoud Hamidit' Ulman) Daru 'l-Hadil, Kajro, bot. II, 1996, vëll. I, f. 59.

[3] Abu Muhamed 'Abdu'l-Haqq b. 'Atiyya, juristi Andaluzian i shkollës juridike malikite, muhadith, mufesir dhe gjuhëtar arab. Ka shërbyer si gjyqtar në qytetin e atëhershëm Almeria. Ka vdekur në vitin 481. h. Shih: 'Umar Rida Kahala, *Mu'ğamu'l-mu'allifin*, Mu'assasa ar Risala, Bejrut, 1993, vëll. II, f. 59.

[4] *Esh Shura,*11. Shih: *Tefsiri i Kurtubiu*, v. e cit., vëll. I, f. 61.

Megjithatë, as avokuesit e atij mendimit nuk mund të bien dakord për emrat e fiseve dhe mbajtësit e këtyre dialekteve.

Disa besojnë se këto dialekte janë të fiseve: Kurejsh, Hudhejl, Thekif, Hevazin, Kinane, Temim dhe Jemen; të tjerët mendojnë se ato janë: Kurejsh, Hudhejl, Temim, El Ezd, Rebia, Hevazin dhe Sad b. Bekër, kurse të tretë thonë se është fjala për shtatë dialekte të Mudarit, duke cituar si provë deklaratën e Othmanit r.a.: "*Kurani është shpallur në gjuhën e Mudarit.*" Ata e trajtojnë Mudarin si emërtim të përbashkët për shtatë fiset më të njohura: Kurejsh, Kinane, Esed, Hudhejl, Tejm, Dabbe dhe Kajs. Pretendojnë se fiset e përmendura hynë në përbërje të familjes së madhe të Mudarit dhe se ajo i integron shtatë dialekte në të cilat është shpallur Kurani, të renditur sipas renditjes së përendur. Po ashtu, ata i referohen transmetimit se Ibën Mesudi kishte preferuar që shkruesit e Kuranit të jenë nga Mudari. Por, disa e kanë kundërshtuar këtë qëndrim, duke pasur parasysh se në fjalimin e fiseve të përmendura ka kolokializma, të cilat nuk i përshtaten fjalorit kuranor. Një shembull i tillë është *keshkesha* (كشكشة) dialekti i Kajsit dhe *temtema* (تمتمة) dialekti i Temimit. Në *keshkesha* të Kajsit, në vend të *kafit* (ك), i cili tregon për përemrin vetor të gjinisë femërore, e shqiptojnë së *shin* (ش). Për shembull, ajeti: (جَعَلَ رَبُّكِ تَحْتَكِ سَرِيًّا) e shqiptojnë si vijon: (جَعَلَ رَبُّشِ تَحْتَشِ سَرِيًّا). Në *temteme* të Temimit, p.sh., në vend të *fi'n-nas* (فِي الناس) thonë: *fi'n-nat* (فِي الناتِ), ose në vend *'ekjas* (أكياس) thonë: *'ekjat* (أكيات). Kolokializma të ngjashme nuk mund të jenë pjesë e gjuhës kuranore, veçanërisht që as nga gjeneratat e para një gjë të tillë nuk mbahet mend.[5]

---

[5] Tefsiri i Kurtubiut, v. e cit., vëll. I, f. 62.

Një shqyrtim më i formës dhe strukturës së kiraeteve autentike thotë se ato përmbanin shumë dialekte arabe, d.m.th. shumicën e tyre, dhe se nuk mund të kufizohen vetëm në shtatë. Dallimet dialektore ndërmjet kiraeteve mund të reduktohet në katër baza: derivuese, morfologjike, fonetike dhe leksikore. Për çdo bazë individuale do të specifikohet në disa shembuj.

## Baza derivuese

**- Folja *ja'kufuune* në ajetin e 138-të të sures *El Araf*: *“Beni Israilët i kaluam përtej detit, e ata u takuan me një popull që adhuronte do statuja të tyre.”***

Hamza, El Kisai dhe Halaf, foljen e përmendur e lexonin me *kesren* në *kaf* (يَعْكِفُونَ), siç shqiptohej në dialektin e fisit të Esed. Fakti që imamët e Kufes e aplikonin kiraetin e përmendur, na tregon se ai është në përputhshmëri me dialektin e fisit Esed, anëtarët e të cilit e banonin sipërfaqen e Kufes. Imamët e tjerë të kiraeteve aplikonin versionin e fiseve të tjera arabe, d.m.th. me *damme* në *kafin* (يَعْكُفُونَ).[6]

Është e qartë se dallimi ndërmjet dy kiraeteve të përmendura, përkatësisht dialektit qëndron në baza derivuese (paradigmës foljore), sepse kiraeti i parë shkon në paradigmën (فَعَلَ) me *fet'han* në *kafin* në perfektin dhe me *kesren* në *kafin* prezentin (يَفْعِلُ), ndërsa kiraeti tjetër shkon në paradigmën (فَعَلَ) në perfektin dhe paradigmën (يَفْعُلُ) me *damen* në *kafin* në prezentin. Baza leksikore (ع ك ف) do të thotë: *ndeshja*

6 Shih: Muhamed Muhaysin, *Al Muharrab fi'l-qira'ati'l-'ašr wa tawğihuhâ*, Mekteba al Kulliyyat al Azhariyya, Kajro, 1970, vëll. I, f. 250.

(مُقَّابَلَة) dhe *mbajtje* (حَبْس); thuhet:عَكَفَ - يَعْكُفُ. kur i qasemi diçkaje dhe nuk ndahemi më kurrë.[7]

**- Folja *fejus'hitekum,* në ajetin e 61-të të sures *Taha*: *"Atëherë Musai u tha atyre* (magjistarëve)*: "Mjerimi është juaji, prandaj mos shpifni ndaj Allahut ndonjë gënjeshtër e t'ju shkatërrojë me ndonjë dënim, se pa dyshim ai që shpif ka dështuar keq."***

Hafsi, Hamza, El Kisai, Ruvejsi dhe Halafi, foljen tematike e kanë lexuar me *damme* në *ja* dhe *kesren* në *ha* (فَيُسْحِتَكُمْ), ndërsa imamët e tjerë të foljes e kanë lexuar me *fet'han* në të dy bashkëtingëllore (فَيَسْحَتَكُمْ) të përmendura. Varianti i parë është dialekti i Nexhdit dhe Temimit, kurse i dyti dialekti i Hixhazit.[8]

Në shikim të dy kiraeteve të përmendura, vërejmë se diferenca e tyre bazohet në baza derivuese. Kiraeti i parë është prezent i foljes (أَسْحَتَ) së llojit të katërt, kurse i dyti është prezent i foljes (سَحَتَ) i llojit të parë. Ebu Ubejde,[9] vë në dukje se të dy kanë kuptim: *shtypje* dhe *shkatërrimi* (سَحق وَأَهْلَكَ).[10] Nga shembulli i mësipërm mund të konkludojmë se llojet foljore në gjuhën arabe janë shfaqur si rezultat i derivimi të ndryshëm

[7] Abu'l-Husayn Ahmad b. Faris, *Mu'ğam maqayisi'l-luga*, Daru'l-Ğil, Bejrut, 1991, vëll. IV, f. 108.

[8] Shih: Muhamed Muhaysin, *Al Muharrab*, v. e cit., vëll. II, f. 143.

[9] Abu 'Ubayda Ma'mar b. al Mulannâ al Basri an Nahwi, gjuhëtari i Basrës, stilisti, mufesiri, muhadithi, shkrimtar dhe leksikolog, vdiq në vitin 208 h. Shkroi rreth 200 vepra nga fusha të ndryshme. Më të njohura janë: *Mağazu'l.Qur'an, I'rabu'l-Qur'an, Al Amlal, Fi garibi'l-hadil* etj.

[10] Shih: Muhamed Muhaysin, *Al Muharrab*, v. e cit., vëll. II, f. 143.

dialektor të së njëjtës themelimit leksikor, siç dëshmohet nga shembulli i tretë në vijim.

- **Folja *jubeshshiruke,* në ajetin e 39-të të sures *Ali Imran*:**

***“E duke u falur ai në faltore, engjëjt e thërrasin: “Allahu të përgëzon ty me Jahjanë, që do të vërtetojë fjalën (Isain) e ardhur nga Allahu, e që do të jetë prijës i matur dhe pejgamber nga të dalluarit!”***

Hamza dhe El Kisai, foljen e përmendur e kanë lexuar me *fet'ha* në *ja*, me *sukun* në *ba* dhe me *damme* në *shin* (يَبْشُرُكَ); të tjerët e kanë lexuar me *damme* në *ja*, *fet'ha* në *ba* dhe *kesre* në *shinin e geminuar* (يبشرك). Fjala është për dy dialekte të famshme: geminimi *(teshdid)* është varianti i hixhazit, kurse lënia e tij *(tahfif)* varianti i fisit Tihame.[11]

Dy kiraete paraqesin dy lloje foljore, të parë dhe të dytë, me të njëjtin kuptim, d.m.th. *të përgëzohet, të sillet lajm të mirë*; forma pa geminim është nxjerrë nga fjala *el bishr (qeshje,* gaz, gëzim, kthjelltësi); thuhet:بَشَرَ - يَبْشُرُ - بَشْرًا; emri i nxjerrë *el bishare* dhe *el bushare*, me *damme* dhe *kesre* në *ba,* ndërsa forma e geminuar është nxjerr nga fjala *et tebshir*, thuhet: بَشَّرَ – يُبَشِّرُ – تَبْشِيرًا. Emrat *el bishr* dhe *et tebeshir,* në bazën semantike, në bazë tregojnë në lajmin, i cili marrësit të vetë, ia ndryshon shprehjen e fytyrës dhe i jep gëzim.[12]

---

[11] Ibid., vëll. I, f. 121.

[12] Shih: Muhamed Muhaysin, *Al Muqtabas mine’l-lahağati’l-‘arabiyya wa’l-qur’aniyya*, Mekteba al Kulliyyat al Azhariyya, Kajro, 1979, f. 70.

## Baza morfologjike

**- Fjala *karh,* në ajetin e 140-të të sures *Ali Imran*:**
***"Në qoftë se juve u preku çka u dhemb (në Uhud), edhe atë popull (armikun) e pat prekur dhembje si kjo e juaja (në Bedër)."***

Fjala e titulluar (قَرْحٌ), me nyjën shquese ose pa të, Shube, Hamza, El Kisai dhe Halefi, e kanë lexuar me *damme* në *kafin* (قُرْحٌ), kurse imamë të tjerë me *fet'han* (قَرْحٌ). Fjala është për dy forma dialektore që përmbajnë kuptimin e fjalëve *el xherh* (الجَرْحِ) - *plagë*. Disa thonë se forma me *fet'ha* do të thotë: *plagë,* kurse forma me *damme* do të thotë: *dhimbje*. Sipas Ahfeshit, ka dy formë të infinitivit (masdarit), thuhet: قَرَحَ – يَقْرَحُ – قَرْحًا – قُرْحًا.[13]

**- Fjala *er ru'b,* në ajetin e 151 të sures *Ali Imran*:**
***"E do to mbjellim frikën në zemrat e atyre që nuk besuan sepse ata Allahut i trillojnë e i mveshin zota të tjerë, duke mos pasur për këtë kurrfarë fakti..."***

Fjalën *er ru'b* (الرُّعْب), e caktuar dhe e pacaktuar, Ibën Amir, El Kisai, Ebu Xhafer i Jakubit, e kanë lexuar me *damme* në *ajnin* (الرُّعُب), sipas variantit dialektor të Hixhazit; të tjerët, këtë emër e kanë lexuar me *sukun* në *ajnin* (الرُّعْب), sipas variantit të fisit Temim, Esed dhe Kajs. Në pyetje janë dy forma të infinitivit me të njëjtin kuptim - *frikë* (الخَوْف). Disa thonë se kjo formë me sukun është bazë, *damma* është përdorur për hir të harmonisë vokale, ngjashëm me fjalët: *usr* dhe

---

Abu Muhammad Mekki b. Abu Talib al Qaysi, *Al Kašf 'an wudžuhi'l-qira'ati's-seb'*, Mu'assasa ar Risala Bejrut, 1984, vëll. I, f. 356.

*jusr*/*'usur* dhe *jusur*. Disa, megjithatë, argumentojnë se forma me *damme* është bazë, e që *sukuni* është përdorur për lehtësimin e shqiptim, siç është rasti me emrin: *er rusul* (الرُّسُل) dhe *er rusl* (الرُّسْل).[14]

**- Fjala *es silm,* në ajetin e 208-të të sures *El Bekare*:**
***"O ju që besuat, hyni në islamizmin e tërësishëm*** *(përqafojeni fenë islame në tërësi),* ***e mos ndiqni rrugën e djallit, sepse ai është armik juaji i hapët."***

Fjalën e përmendur Nafi, Ibën Kethiri dhe El Kisai, e kanë lexuar me *fet'han* në *sinin* (السَّلْم), kurse të tjerët me *kesren* (السلم).

Kiraeti *es silm* dhe *es selm,* janë dy forma dialektore infinitivë të foljes *selime* (سَلِمَ). Varianti me *kesre* e paraqet *Islamin*, edhe pse forma me *fet'ha* mund të trajtohet si emër në kuptimin e infinitivit, duke iu referuar Islamit, ngjashëm emrit: *dhuratë* (عَطَاء) në kuptim: *dhurim* (إِعْطَاء). Forma me *fet'ha* mund të merret në kuptimin e: *paqes, tolerancës dhe bashkëjetesës* (الصُّلْح), e që, përsëri, e paraqet Islamin dhe vlerat e tij.[15]

## Baza fonetike

**- Fenomeni zbutës i artikulimit të *hemzes***

Te formimi i *hemzes,* litarët vokale janë të bashkangjitur në mënyrë të vendosur me njëri-tjetrin, në mënyrë që të mbyllë plotësisht kalimin e ajrit. Gjatë ndarjes momentale të lita-

---

[14] Shih: Muhamed Muhaysin, *Al Muharrab*, v. e cit, vëll. I, f. 138.

[15] Ibid., vëll. I, f. 88.

rëve vokale, ajri i ngjeshur depërton papritur duke prodhuar tingull shpërthyes, përderisa litarët vokale dridhen (vibrojnë). Pra, *hemze* është harf grykor (glotal) sipas vendit të formimit, shpërthyes (eksploziv) sipas metodës së formimit dhe i zëshëm sipas pjesëmarrjes të dridhjes së litarëve vokale.

Sa i përket mënyrës së artikulimit, *hemzeja* bën pjesë ndër bashkëtingëlloret më të vështira arabe. Prandaj, disa fise arabe kanë qenë të prira në zbatimin e tij (*tes'hil*), kryesisht ato në veri dhe perëndim të Gadishullit Arabik, siç është Hudhejl dhe banorët e Hixhazit (Mekës dhe Medinës); fise të tjera në pjesën qendrore dhe lindore të gadishullit, të tilla si Temimit, kanë praktikuar shqiptimin e tij të plotë (*tahkik*). Një fakt interesant është se shqiptimi i plotë i *hemzes* është tipar i mjedisit rural (beduin), në krahasim me zonat urbane ku e kanë zbutur, e çka mund të vihet në lidhje me mënyrën e jetesës dhe të karakteristikave të komunikimit shoqëror.[16]

Termi *tes'hil* në shkencën e kiraetit i referohet artikulim të zbutur të *hemzes,* edhe pse ndonjëherë me këtë term përcaktohen të gjitha ndryshimet në lidhje me artikulim të *hemzes*, d.m.th. katër mënyrat e artikulimit të tij: *kalim* (النَّقْل), *zëvendësim* (الابْدَال), *artikulim i patheksuar* (التَّسْهِيل) dhe *lëshim* (الحَذف).

Të gjitha këto mënyra të artikulimit janë të përfaqësuara në kiraetet autentike.

*Kalimi* përdoret në situatën kur *hemzeja* është e vokalizuar, kurse i paraprin *sukuni* i qëndrueshëm. Atëherë *hemzeja* lëshohet dhe vokali i saj, qoftë nëse është *fet'ha, damme*

---

[16] Shih: Muhamed Muhaysin, *Al Muqtabas*, v. e cit., f. 84.

ose *kesre,* kalohet në bashkëtingëlloren e mëparshme, p.sh.: قُلْ أُوحِيَ مِنْ إِسْتَبْرَقٍ قَدْ أَفْلَحَ

*Zëvendësimi* kryhet kur para *hemzes* së pa vokalizuar vjen bashkëtingëllorja me vokal, atëherë *hemzeja* ndryshohet në *waw* kur është para tij *damme*, në *elif* kur është para tij *fet'ha* dhe në *ja* kur është para tij *kesre,* p.sh.: الَّذِى ائتُمِنَ الهُدَى ائتِنَا يَقُولُ ائذَن لِى . Sa u përket *artikulimit të patheksuar* dhe *lëshimit,* artikulimi i tillë praktikohet, p.sh., kur në mes të dy fjalëve takohen dy *hemze* të vokalizuar, që mund të jenë me vokale të njëjta ose të ndryshme. Shembuj të vokaleve të njëjta janë fjalët: أَوْلِيَاء أُولَئِكَ هَؤُلاء إِنْ كُنْتُمْ جَاءَ أَحَدُكُمْ

Sipas një kiraeti lëshohet *hemzeja* e parë ose e dytë, sipas kiraetit tjetër *hemzeja* e parë ose e dytë shqiptohet pa theksim, sipas kiraetit të tretë *hemzeja* e dytë ndryshohet në harf të gjatësisë, *elif, waw* ose *ja,* në varësi të vokalit.[17]

**- *Idhhar* (إِظْهَار) dhe *idgam* (إِدْغَام)**

Praktikimi i *idhharit* dhe *idgamit* paraqet një nga fenomenet gjuhësore. Me të janë marrë gjuhëtarët klasikë dhe modern arabë, duke krijuar në këtë drejtim shumë rregulla dhe norma, edhe pse ata dallonin në arsyetimin dhe interpretimin e tyre, edhe në atë se cilat fise kanë qenë të prirë për të përdorur *idhharin*, dhe cilat përdorimin e *idgamit.*

*Idhhari* në gjuhën arabe do të thotë: *shfaqje*, *shprehje*, *manifestim* etj.

[17] Rreth artikulimit të *hemzes*, shih më shumë: Fadil Fazlić, *Komparacija između Hafsovog i Weršovog kira'eta*, FIN dhe El Kalem, Sarajevë, 2000, f. 82-94.

*Idhhari* në terminologji është artikulimi i çdo harfi në përputhje me nxjerrjen e tij gjatë të cilit nuk duhet të kihet nazalizimi në harfin e idhharit.

Në leksikologji, *idgam* do të thotë: *futje*, *përshtatje, bashkim, kontraktim, asimilim* etj.

*Idgami* në terminologji është bashkim i dy harfeve, ashtu që shqiptohet vetëm një harf i geminuar, pra harfi i dytë sipas radhës.

Edhe pse *idhhari* dhe *idgami* përdoren shpesh, prapë se prapë mund të thuhet se baza e shqiptimit të *idhharit*, pasi nuk është kushtëzuar me asgjë, ndryshe nga *idgami* që kërkon *përafrim*, *ngjashmëri* ose *afërsi* të bashkëtingëlloreve.

*Ngjashmëria* e bashkëtingëlloreve (التَّمَاثُل) nënkupton ngjashmërinë e tyre, duke pasur parasysh pikënisjen dhe vetitë (م dhe م); *lidhje të ngjashme* (التَّجَانُس) ka të bëjë me ngjashmërinë e pikënisjes së tyre dhe diferencën e disa nga cilësitë e tyre (د dhe ت), ndërsa afërsia (التَّقَارُب) ka të bëjë me afërsinë e pikënisjes së tyre dhe ngjashmërinë e disa vetive (ل dhe ر).

Me qëllim të aplikimit të *idgamit* në tekstin kuranor, është kusht që harfet e *idgamit* duhet të jenë të drejtpërdrejt njëri afër tjetrit, si në shqiptim ashtu edhe në drejtshkrim, ose vetëm në drejtshkrim, si për shembull: إِنَّهُ هُوَ - dy harfe të njëjta janë të ndara në mes veti në shqiptim, sepse i ndanë vokali i gjatë i të parit, por në drejtshkrim ato nuk janë të ndara dhe lejohet realizimi i *idgamit*, siç është në transmetimin e Es Sujutiut.

*Idgami* nuk lejohet të aplikohet në situatat e mëposhtme:

1) kur harfi i cili dëshiron të asimilohet është përemri vetor/damir i vetës së parë ose i vetës së dytë njëjës, kurse bashkohet vetëm me foljet, për shembull: كُنْتُ تُرَابًا ose أَفَأَنْتَ تُسْمِعُ;
2) kur harfi që dëshiron të asimilohet i geminuar, p.sh.:. مَسَّ سَقَرَ;
3) kur harfet e *idgamit* në të njëjtën fjalë, me kusht që i pari të jetë me vokal, kurse i dyti me *sukun,* p.sh.:. مَدَدْتَ;
4) kur pikënisja e harfeve është larg, e çka e vështirëson realizimin e *idgamit,* p.sh.: ت dhe ن dhe fjalët أَتَيْنَا.

*Idgami* ndahet në dy lloje: *idgam të madh* (الإدْغَام الكَبِير) dhe *të vogël* (الإدْغَام الصَّغِير). Tek *idgami i madh,* të dy harfet janë të vokalizuar, për shembull: شَهْرُ رَمَضَانَ; tek *idgami i vogël,* i pari është me *sukun,* kurse i dyti me vokal, p.sh.: قَدْ تَبَيَّنَ.

Gjithashtu, *idgami* ndahet në *të plotë* dhe *jo të plotë*. *Idgami i plotë* nënkupton asimilimin e plotë të njërit në harfin tjetër, d.m.th. pikënisja dhe vetitë, p.sh.:. مِن رَّبِّهِمْ, ndryshe nga *idgami jo i plotë* kur asimilohet pikënisja, por jo edhe vetia, për shembull:. مَنْ يَقُولُ.[18]

Është e qartë se *idgami* është fenomeni gjuhësor i shkaktuar nga plejada fonetike dhe dëshira për pretekstin më të shpejtë, e që veçanërisht ishte e theksuar sidomos në mjedise rurale arabe. Nëse merret parasysh se një numër i madh i pjesëtarëve të fiseve beduine është vendosur në provincat e

[18] Rreth *idhharit* dhe *idgamit* më shumë shih: ‘Abdu’l-Fattah al Marsafi, *Hidayetu’l-Qari ila tağwid kalami’l-Bari*, Maktaba Tayyiba, Medina, pa vit botimi, vëll. I, f. 231-260.

Irakut, atëherë është e kuptueshme se pse imamët e kiraeteve të Kufes në transmetimet e tyre kanë praktikuar *idgame* më shumë se të tjerët.

**– *Fet'h* (الفَتْحُ) dhe *imala* (الإمَالَة)**

*Fet'h* dhe *imala*, si fenomene gjuhësore, ishin të pranishme në të folurit arab shumë kohë para paraqitjes së Islamit. *Fet'h* ishte specifikë e fiseve që banonin në pjesën perëndimore të Gadishullit Arabik, duke përfshirë fise të Hixhazit: Kurejsh, Thekif, Hevazin dhe Kinane. *Imala* e karakterizonte të folurit e fiseve qendrore dhe lindore, të tilla si: Temim, Kajs, Esed, Taj, Bekr b. Vail dhe ‘Abdul Kajs.[19]

Kur u shpall Kurani, *fet'h* dhe *imala* u bënë pjesë integrale fonologjike të tij të leximit - *tilavetit*. Një numër i imamëve të kiraeteve shpesh e aplikonte *imalen*, si: Vershi, Ebu Amri, Hamza dhe El Kisaiju. Të tjerë, megjithatë, e preferonin *fet'hun*, si: Kaluni, Ibën Kethiri, Ibën Amir, Asimi, Ebu Xhaferi dhe Jakubi.

Me termin *fet'h,* mendohet në shqiptim të zakonshëm të vokalit të gjatë *a,* edhe pse në disa transmetime aplikohet edhe në vokalin e shkurtë *a:* gjuha lëshohet në pozitën më të ulët në gojë (në fund të gojës) pa lëvizur përpara ose prapa, buzët në të njëjtën kohë janë në pozicionin neutral, kurse hapja e gojës është më e madhe.

*Imala* është artikulimi i vokalit të gjatë ose të shkurtër *a* në mes të *a* dhe *e* nëse është në pyetje *imala e vogël.* Tek

[19] Shih: Ahmad b. Muhammad al Bannâ, *Ithaf fudala’i-l-bašar*, ‘Alamu’l-kutub i Maktaba al Kulliyyat al Azhariyya, Bejrut dhe Kajro, 1987, vëll. I, f. 247-248.

*imala e madhe,* ky vokal shqiptohet në mes *e* dhe *i;* gjuha ngrihet përpara, ndërsa pjesa e tij e përparme ngrihet në drejtim të qiellzës, teksa vetë maja prek prerës të poshtme, buzët janë të shtrira, kurse hapja e gojës është e ulur ndjeshëm.

Ekzistojnë edhe dukuri të tjera fonetike nëpërmjet të cilave pasqyrohen dallimet dialektore në mes të kiraeteve, megjithatë, rreth kësaj do të bëhet fjalë në ndonjë rast tjetër.

## Baza leksikore

Me bazën leksikore mendohet në fjalët dhe frazat kuranore karakteristike për fise të caktuara arabe. Shumica e fjalëve në Kuran, e që është mjaft e logjikshme, vijnë nga trashëgimia leksikore e fisit Kurejsh. Megjithatë, ka shumë fraza në Kuran që vijnë nga leksiku i fiseve të tjera. Për shembull, fjala *el mu'sirat* (المعصرات) vjen nga zona e të folurit të fisit Kurejsh, fjala *rixhz* (رجز) i takon dialektit të fisit Taj, fjala *es sa'ihun* (السائحون) fisit Hudhejl, fjala *hashi'a* (خاشعة) fisit Temim, fjala *el uhud* (العهود) fisit Benu Hanife, fjala *es sufeha* (السفهاء) fisit Kinane etj.[20]

Parashtrohet pyetja: Pse Kurani i mori fjalët e një numri të madh të fiseve arabe?

Mund të përgjigjemi se në këtë qëndron urtësia e madhe e Zotit. Libri i Allahut i afroi dhe i bashkoi fiset arabe të asaj kohe, ndër të tjera, duke përdorur shprehjet e tyre dialektore, që për ta ishte një nder i madh. Fjalimi kuranor është bërë forma e padiskutueshme gramatikore, letrare dhe stilistike e

[20] Shih më shumë: Muhamed Muhaysin, *Al Muqtabas*, v. e cit., f. 112-132.

shprehjes gjuhësore për të gjithë arabët, pavarësisht nga përkatësia e tyre rajonale apo fisnore.

## Përfundim

Baza e shkencës së kiraetit, nisma dhe zhvillimi i saj janë të lidhura direkt me hadithin rreth *shtatë harfeve*. Ekzistojnë mendime të shumta të dijetarëve islam rreth kuptimit të sintagmës *shtatë harfet*. Midis tyre është i dominuar mendimi se kjo sintagmë i referohet shtatë dialekteve arabe, në të cilat u shpall Kurani. Gjatë shpalljes së Kuranit, për arabët injorantë, ishte më e lehtë për ta kënduar Kuranin në dialektin e tyre, ashtu siç i kishte mësuar ata Pejgamberi a.s., kështu që kuptimi dhe mesazhi i Kuranit kanë mbetur të pandryshuar. Megjithatë, përfaqësuesit e këtij mendimi nuk mundën të bien dakord se, në fakt, për cilat dialekte është fjala. Në çdo rast, dialektet e hershme arabe janë një faktor i rëndësishëm i divergjencave dhe aplikimi i kiraeteve ndryshme.

Dallimet dialektike midis kiraeteve mund të reduktohet në katër baza: derivuese, morfologjike, fonetike dhe leksikore. Për secilën nga këto baza është e mundur të përmendim shumë shembuj nga Kurani, megjithatë, për qëllime ilustruese, ne jemi kënaqur me disa shembuj.

Te baza derivuese kemi vërejtur se dallimet dialektore në mes të kiraeteve ndodhin në nivelin e paradigmave të ndryshme foljore dhe bazave infinitive, edhe pse ato shpesh bazohen në përdorimin e llojeve të ndryshme të foljeve.

Baza morfologjike paraqet përdorimin e dy ose më shumë formave të një emri apo folje, e që arrihet me vokalizim

të ndryshëm, përkatësisht me mbajtjen ose lëshimin e vokalit.

Baza fonetike është në lidhje me ndryshime akustike të zërit te shqiptimi i bashkëtingëlloreve të caktuara, siç është rasti me *hemzen*, pastaj bashkimin dhe asimilimin e tyre në bashkëtingëllore të tjera, të plota ose jo të plota, pastaj shqiptimin specifik të vokalit të gjatë dhe të shkurtë "*a*" (*imala*) etj.

Baza leksikore manifestohet duke përdorur fjalë të veçanta për këtë apo atë dialekt arab.

Së fundmi, mund të konstatojmë se zhvillimi leksikor dhe tefsiror i natyrës së divergjencave të kiraeteve në shumëçka mbështetet në bazë të studimeve dialektologjike të gjuhës arabe nga periudha të hershme.

*Nga gjuha boshnjake*
*përktheu e përshtati:*
***Dr. Azmir JUSUFI***

**Ramadan SHKODRA**

# TË PËRÇASH DHE TË HASMËROSH POPULLIN TËND - MALLKIM QË PRORE KA PËR TË TË PËRCJELLË

Opinioni publik në Kosovë, tashmë prej një kohe, po përballet me një fushatë të paarsyeshme dhe refuzuese kundër fesë, kulturës, traditës dhe trashëgimisë islame në vendin tonë. Këtë fushatë, bartësit e saj e kanë nisur gjoja në emër të ruajtjes së vlerave kombëtare, të kthimit në fenë e të parëve dhe të ruajtjes dhe identifikimit me vlerat qytetëruese evropiane-oksidentale! Ky projekt para popullit shqiptar, i cili tashmë për gjashtë shekuj ka bashkëjetuar dhe bashkëvepruar me besimin, kulturën dhe qytetërimin islam, po mundohet të përvijohet nga një grup qytetarësh, që e kanë quajtur veten "Lëvizja e Deçanit".

Që një grup individësh të marrin përsipër që haptazi ta sfidojnë shumicën e popullatës së Kosovës, pra, t'i sfidojnë dhe t'ua mohojnë besimin e tyre islam shqiptarëve të Kosovës, të cilët përbëjnë hiq më pak se mbi 90% të popullatës së përgjithshme të Kosovës, kjo përveçse nuk është dëgjuar dhe as parë gjëkundi, tingëllon shumë absurde, e parealizueshme, mirëpo edhe me pasoja dhe dëme afatgjate për vendin dhe popullin tonë.

Kjo farë e ashtuquajtura “Lëvizja e Deçanit” trumbeton deislamizimin e popullatës së Kosovës për gjoja, gjithnjë sipas tyre, tri arsye madhore: 1. Ruajtjen e kombit shqiptar nga feja islame; 2. Kthimin e shqiptarëve kolektivisht në fenë e të parëve; 3. Ruajtjen e vlerave oksidentale përballë atyre orientale!

Këto pretendime, mbi të cilat edhe përpiqet të veprojë kjo farë lëvizjeje, përveçse janë të paqëndrueshme, antihistorike e antishkencore, gjithsesi edhe antishqiptare, mbi të gjitha janë edhe antinjerëzore, të tejkaluara dhe të cilat nuk kanë asgjë të përbashkët as me të kaluarën, as me të tashmen dhe as me përcaktimet e popullatës sonë për të ardhmen.

Pretendimi i tyre për braktisjen e fesë islame më shumë se antikombëtar, antihuman e antiqytetërues, është edhe antihistorik, sepse, siç na mëson historia, bartës të rendeve shoqërore, të feve, qytetërimeve dhe kulturave që kanë lënë gjurmë, emër e vulë të tyre përgjatë historisë kanë qenë perandoritë e mëdha dhe të fuqishme, të cilat aty ku kanë depërtuar, gjithmonë edhe kanë sjellë në kohë e rrethana të caktuar tipare e aspekte të reja te popujt dhe shoqëritë e kohës, e që do të thotë se, përveç shtrirjes së pushtetit dhe administrimit, ato me vete kanë sjellë edhe një rregullim të ri shoqëror, një kulturë të re, një qytetërim të ri dhe, mbi të gjitha, kanë sjellë edhe fenë zyrtare të cilës edhe do t’i kenë takuar ato.

Kështu dhe në këso rrethanash janë krijuar kushtet për pranimin e një kulturë tjetër, për ndërtimin e një qytetërimi të ri dhe përqafimin apo kalimin nga një besim në tjetrin. Kështu ka qenë përgjatë historisë, por se sot, në kohën në të cilën po jetojmë, kalimi masiv nga një besim në tjetrin dhe me

metoda të mesjetës nuk është i mundshëm, aq më pak kur shqiptarët dhe as popujt e tjerë përreth nuk i kanë kapacitet e perandorive të dikurshme, e lërë më ca individë të papërfillshëm që jetojnë në të kaluarën.

Kur kësaj i shtojmë faktin se populli shqiptar e ka tejkaluar fazën e mendësisë kolektive dhe, në rrugëtimin e tij për krijimin e identitetit kombëtar dhe themelimin e shtetësisë, ka kultivuar dhe përqafuar vlerat pozitive dhe humane me elemente dalluese që e bëjnë të veçantë: një popull i vogël me një histori të lashtë, me një qytetërim të shtresuar që nga antikiteti deri në ditët e sotme, me tri besime që bashkëjetojnë në harmoni dhe me një ndjesi të përbashkët për etninë, gjuhën, territorin (atdheun) dhe flamurin.

Kthimi në fenë e të parëve, si një nga pretendimet pohuese të kësaj lëvizjeje, që gjoja na qenkësh shpëtim për shqiptarët, është një nga manipulimet dhe spekulimet e dëgjuara herë pas here edhe më parë. Dihet se bartëse e fesë, kulturës dhe qytetërimit islam te ne është Perandoria Osmane, ashtu siç dihet se më parë bartëse të fesë së krishterë me dy ritet e saj kanë qenë perandoritë pararendëse, ajo Bizantine dhe, para saj, ajo Romake.

Për dallim nga dy perandoritë e para që në vendosjen e rendit shoqëror dhe përhapjen e fesë kanë qenë shumë më të ashpra dhe shumë më imponuese, zgjatimi i Perandorisë Bizantine përmes asaj që njihet si miniperandoria e Dushanit, me kodin famëkeq “Kodi i Car Dushanit”, për trojet tona ka qenë veçanërisht i tmerrshëm.

Krahasuar me këto, për shkak të zhvillimeve, rrethanave, po edhe parimeve mbi të cilat është ngritur e zhvilluar Perandoria Osmane, ajo ka qenë shumë më e hapur, shumë më

tolerante, ka njohur diversitetin kulturor, religjioz e etnik (ky i fundit, aq sa ishte i kultivuar). Natyrisht, sikurse edhe perandoritë dhe fuqitë e tjera, edhe kjo ka mbështetur, ka përkrahur e zhvilluar qytetërimin dhe besimin zyrtar të saj. Që nga koha kur shqiptarët nisën kontaktin e drejtpërdrejtë me Perandorinë Osmane, ajo ishte shumë më gjeneroze dhe më e avancuar se rendet shoqërore të perëndimit të asaj kohe, të cilat vuanin pasojat e inkuizicionit dhe mendësisë mesjetare.

Prandaj, të kërkosh konvertim kolektiv në emër të rigjetjes së vlerave të të parëve të hershëm, duke mohuar kulturën, qytetërimin dhe trashëgiminë e gjashtë shekujve të fundit, është mendësi e inkuizicionit në shekullin XXI. Kjo është hipokrizi e shoqëruar me injorancë, është shkurtëpamësi dhe agjendë antikombëtare e antifetare, është nxitje e urrejtjes dhe mosdurimit, një përpjekje për të krijuar një rend dhe një njeri të ri, një shoqëri të re dhe një komb të ri. Kur këto ideohen nga qarqe ideologjike, antifetare dhe antihumane, dhe bëhen në emër të gjoja pararojës dhe mbrojtjes së kombit dhe shqiptarësisë nga shqiptarët myslimanë, të cilët përbëjnë shumicën absolute të popullatës, atëherë kjo nuk mund të quhet ndryshe përveçse një mendësi djallëzore dhe dashakeqe për popullin dhe vendin tonë.

Kur jemi këtu, duhet theksuar edhe faktin se te ne, deri vonë, pushtimi osman dhe prania e ndikimit të tij jo vetëm në mënyrën e jetesës, por edhe në kulturën materiale e shpirtërore të shqiptarëve, është shpjeguar, fatkeqësisht, sipas narratives serbosllave dhe asaj komuniste (gjithnjë për interesa të tyre), duke përjashtuar kështu praninë, interesin dhe faktorin shqiptar në kuadër të këtyre rrjedhave, ngjarjeve e proceseve. Në këtë drejtim, një pjesë e katolikëve ekstremistë, përkrahës

të Propagandës Fide dhe të mbështetur në dogma fetare kishtare dhe jo në fakte historike dhe argumente shkencore, kanë kontribuuar në përforcimin e kësaj narrative.

Megjithatë, sot, për procesin e islamizimit dhe praninë e tij ndër shqiptarët, me akribi shkencore, me fakte dhe argumente, paanshmëri dhe larg ndikimeve ideologjike, dogmatike dhe interesave të ndryshme, janë botuar një sërë veprash dhe studime serioze nga autorë perëndimorë, pa përmendur edhe ata vendorë.

Dhe, pikërisht duke iu referuar rezultateve të këtyre autorëve, mësojmë se paraardhësit tanë, të cilët të parët e kanë pranuar fenë islame, kanë qenë pikërisht ata që e kanë përbërë elitën dhe fisnikërinë e kohës. Pranimi i fesë islame prej shqiptarëve nuk ishte një akt i përnjëhershëm, por një proces shekullor, përgjatë të cilit kontributin dhe mundin e tyre e dhanë vetë shqiptarët, dhe më veçantë elita dhe prijësit e kohës, të cilët edhe sot e kësaj dite identifikohen dhe personifikohen me themelimin, ngritjen dhe financimin e një sërë objektesh me karakter fetar dhe profan.

Pikërisht nga kjo elitë islame e krijuar ndër shekuj dolën personalitete të shquara që qenë në ballë të platformave e aktiviteteve kombëtare, po edhe u prinë atyre edhe përgjatë shekujve osmanë, e sidomos në Rilindjen Kombëtare dhe më pas; kontributi i tyre në ngjizjen, bartjen dhe kultivimin e nacionalizmit shqiptar dhe në ngritjen e vetëdijes kombëtare e atdhetare ka qenë i jashtëzakonshëm, dhe përmendja e tyre, po që se do t'ia fillonim, do të shkonte shumë gjatë. Për këtë arsye, klithjet propaganduese për kthim në fenë e të parëve janë fare të paarsyeshme, të paqëndrueshme, po edhe të parealizueshme, për të mos e thënë (vetëm nga mirësjellja) se një

thirrje e tillë është ahmakllëk i llojit të vet. E vërteta historike, edhe sikur të duam ne, nuk abortohet. Gjashtë shekuj të pranisë dhe të shtresimit të kulturës dhe të trashëgimisë islame ndër shqiptarë, sado që të përpiqemi, nuk mund të mohohen dhe as të tjetërsohen. Para se të vihemi në shërbim të së keqes, duhet ditur e kuptuar drejt se shqiptarët myslimanë, së bashku me vëllezërit e tyre të krishterë, janë themelues të vetëdijes kombëtare, janë bartës e projektues të lirisë dhe të pavarësisë së shqiptarëve dhe të trojeve të tyre. Prandaj, kërkesat, argumentet dhe pretendimit e kësaj lëvizjeje, për ta braktisur kolektivisht fenë islame, janë një ndërmarrje shumë e dëmshme për popullin tonë. Kur kësaj t'ia shtojmë edhe faktin se iniciatorët e kësaj lëvizjeje, edhe pse vetë nuk kanë bindje e as kulturë të asnjë feje, pra nuk janë praktikues e as njohës të asnjë feje dhe as nuk janë prijës fetarë, por që ftojnë që të braktiset një fe e të pranohet një tjetër, atëherë s'kemi se si mos të vijmë në përfundim se këta paraqesin një lëvizje me qëllime djallëzore, të atillë që synon ta dëmtojë thellë në palcë kombin shqiptar.

Me jetën fetare si gjithkund në botën e qytetëruar merren bashkësitë fetare, kanë institucionet e tyre kompetente, kuadër të përgatitur dhe objekte të kultit për secilin besim. Te ne, bashkësitë fetare janë të konsoliduara dhe kanë krijuar një traditë të shkëlqyer të bashkëjetesës dhe harmonisë ndërfetare, si një vlerë e popullit shqiptar. Të ngrihesh kundër një besimi, cilido qoftë ai, dhe ta fyesh atë, është veprim krejtësisht i papranueshëm dhe i dëmshëm, i cili politizon dhe polarizon shoqërinë, nxit urrejtje ndër vëllazërore, fut huti dhe hap debate të kota, që vetëm shqiptarët i pësojnë.

Të propagandosh sot një lloj rreziku për Evropën prej shqiptarëve të besimit islam është e paqëndrueshme, është idiotësi dhe përpjekje për t'i manipuluar ata që në kohën në të cilën po jetojmë nuk mund të manipulohen dot, sepse sot nuk ka kush që nuk e di se një popull i vogël me një mirëkuptim e harmoni të kultivuar ndërfetare, siç jemi ne, po rrezikuaka popujt dhe shoqëritë e konsoliduara evropiane! Këta manipulues sikur nuk e shohin se Islami si fe, si kulturë, po edhe si trashëgimi, tashmë është pjesë e Evropës. Dhe, për ta parë këtë, mjafton që të qëndrosh në Londër, Paris, Berlin, Bruksel e Oslo, apo edhe në qendra të tjera, për të parë myslimanë të etnive të ndryshme që jetojnë, punojnë e manifestojnë besimin, kulturën e traditën e tyre bashkë me popujt vendës, në paqe e harmoni, si dhe të integruar në shoqërinë evropiane.

Koha ka për ta dëshmuar se kjo e ashtuquajtura "Lëvizja e Deçanit" është një nismë e dëmshme, me apo pa vetëdije, plotësisht antikombëtare, një orvatje për t'ia ngulitur kazmën në themel identitetit, vlerave dhe traditës pozitive të shqiptarëve të këtij nënqielli, sikundër që është edhe një përpjekje e dështuar, e që shumë shpejt do të shkojë në pakthim, po edhe një njollë e rëndë për bartësit e saj, të cilët s'kanë për t'u harruar për shumë kohë; kjo njollë do t'u varet në qafë të gjithë atyre, kushdo qofshin ata, dhe kujtdo që i përkasin ata që synojnë ta dëmtojnë, ta përçajnë dhe ta hasmërojnë popullin shqiptar.

بسم الله الرحمن الرحيم

# TAKVIM
# 1446-1447

# KALENDAR
# 2025

| JANAR I / 2025 | | | |
|---|---|---|---|
| Data sipas kal. botëror | Ditët e javës | Data sipas Takvimit | Festat fetare dhe shënime të tjera astronomike |
| **VII - Rexheb 1446 V.H.*** | | | |
| 1 | e mërkurë | 1 | Viti i Ri 2025, Hëna e re |
| 2 | e enjte | 2 | Nata e Regaibit |
| 3 | e premte | 3 | e Xhuma |
| 4 | e shtunë | 4 | |
| 5 | e diel | 5 | |
| 6 | e hënë | 6 | |
| 7 | e martë | 7 | |
| 8 | e mërkurë | 8 | |
| 9 | e enjte | 9 | |
| 10 | e premte | 10 | e Xhuma |
| 11 | e shtunë | 11 | |
| 12 | e diel | 12 | |
| 13 | e hënë | 13 | |
| 14 | e martë | 14 | Hëna e plotë |
| 15 | e mërkurë | 15 | |
| 16 | e enjte | 16 | |
| 17 | e premte | 17 | e Xhuma |
| 18 | e shtunë | 18 | |
| 19 | e diel | 19 | |
| 20 | e hënë | 20 | |
| 21 | e martë | 21 | |
| 22 | e mërkurë | 22 | |
| 23 | e enjte | 23 | |
| 24 | e premte | 24 | e Xhuma |
| 25 | e shtunë | 25 | |
| 26 | e diel | 26 | Nata e Miraxhit |
| 27 | e hënë | 27 | |
| 28 | e martë | 28 | |
| 29 | e mërkurë | 29 | |
| 30 | e enjte | 30 | |
| **VIII - Sha'ban 1446 V.H.** | | | |
| 31 | e premte | 1 | Hëna e re, Hamsini |

* Fillimi i tre muajve të mëdhenj

| JANAR I / 2025 | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Data | Ditët e javës | Imsaku dhe kohët e namazit | | | | | | | |
| | | Imsaku | Sabahu | Lindja e diellit | Dreka | Ikindia | Akshami | Jacia | Gjatësia e ditës |
| | | o.m. | o.m. | o.m. | o.m. | o.m. | o.m. | o.m. | o.m. |
| **VII - Rexheb 1446 V.H.** | | | | | | | | | |
| 1 | e mërkurë | 5:21 | 5:41 | 7:03 | 11:44 | 14:05 | 16:21 | 18:00 | 9:18 |
| 2 | e enjte | 5:21 | 5:41 | 7:03 | 11:45 | 14:06 | 16:21 | 18:00 | 9:18 |
| 3 | e premte | 5:20 | 5:40 | 7:02 | 11:45 | 14:06 | 16:22 | 18:00 | 9:20 |
| 4 | e shtunë | 5:20 | 5:40 | 7:02 | 11:45 | 14:06 | 16:23 | 18:01 | 9:21 |
| 5 | e diel | 5:20 | 5:40 | 7:02 | 11:45 | 14:07 | 16:24 | 18:02 | 9:22 |
| 6 | e hënë | 5:20 | 5:40 | 7:02 | 11:46 | 14:08 | 16:25 | 18:03 | 9:23 |
| 7 | e martë | 5:20 | 5:40 | 7:01 | 11:46 | 14:08 | 16:26 | 18:04 | 9:25 |
| 8 | e mërkurë | 5:20 | 5:40 | 7:01 | 11:46 | 14:09 | 16:27 | 18:05 | 9:26 |
| 9 | e enjte | 5:20 | 5:40 | 7:01 | 11:47 | 14:10 | 16:28 | 18:06 | 9:27 |
